Në situatat ekstreme të faktorëve natyrorë policisë i shumëfishohet ngarkesa. Krahas zbulimit dhe goditjes së rreziqeve që i vijnë shoqërisë nga brenda si rezultat i veprimit të dorës së krimit, mbrojtjes të së drejtave të qytetarëve në kohë paqe, shmangies dhe parandalimit të veprave që cenojnë rendin publik dhe individin, brenda kufijve të ligjit, duhet të përballlet edhe me sfidat e shtruara të emergjencave të përmbytjeve dhe sinkronizimin dhe sinergjizimin e shumë faktorëve për të vendosur qetësinë e prishur dhe ruajtjen e sigurisë publike në kohë përmbytje dhe jo vetëm. Polici profesionist, është inteligjenti me kulturë të re komunikuese, psikolog, edukues, por kur situata e detyron edhe përdorues i forcës brenda kufijve të ligjit.⁴¹

Policia e Shtetit veprimtarinë në kuadër të ligjit “Për mbrojtjen civile”, e zgjidh bazuar në “nenin 35” Policia e Shtetit, ku detajohen detyrimet ligjore institucionale. Policia e Shtetit si një ndër pesë strukturat që përfshihen në kushtet ku ndodhin fenomenet ekstreme të natyrës zgjidhin këto probleme: “Pika 2”, “mbrojtjen e zonës së emergjencës civile, ruajtjen e rendit publik, procesin e identifikimit dhe të informimit rreth të dëmtuarve dhe viktimave, largimin e tyre nga zona e emergjencës, si dhe detyra të tjera që dalin në zbatim të legjislacionit në fuqi për Policinë e Shtetit e më gjerë.”⁴²

Dritëshkurtësia dhe sjelljet pa vizion e lidërve botërorë paguhen shtrenjtë për ardhmërinë e njerëzimit përballë fenomeneve të pamëshirshme të kohës, natyrës që nuk di të paralajmërojë, por ju jep njerëzimit në dorë “armët”, që do të ndeshen me këto fenomene dhe sigurisht në ballë të tyre në Shqipëri dhe jo vetëm janë strukturat ruajtëse të sigurisë publike, policia dhe policimi.⁴³ Për Gardnerin, si komentuesit e tjerë bashkëkohorë, burra të tillë si Hitleri dhe Stalini mund të konsiderohen sundues, por jo liderë.⁴⁴

Organizata e Policisë, duke pasur në thelb, “që prej lashtësisë misionin e administrimit civil, janë ruajtës rendi, ruajtës qytetërimi, ruajtës të ligjit”⁴⁵. Prandaj, edhe nga pikëpamja legjislative, “siguria publike”, edhe pse është pjesë e sigurisë kombëtare, ajo është e materializuar në formacione ligjore e administrative si ligji për Policinë e Shtetit, “Kreu X, bashkëpunimi me komunitetin dhe subjekte të tjera”, neni 76, “Bashkëpunimi me

³⁹ Prof. Asc. Dr. Zaho Golemi, Revista “Policimi dhe Siguria, fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë”, Maj 2021, Botim i Akademisë së Sigurisë, Tiranë 2021, faqe 48.

⁴⁰ Po aty, faqe 52.

⁴¹ Po aty.

⁴² Po aty, faqe 58.

⁴³ Po aty, faqe 51.

⁴⁴ Gardner, the Moral Aspect of Leadership, 3. See also Adel Safty, “Moral Leadership: Beyond Management and Governance,” Harvard International Review 25, 3 (2003): 84, 85. (Deborah L. Rhode, “Moral Leadership: The Theory and Practice of Power, Judgment, and Policy”, Foreword by Warren Bennis, San Francisco, 2006, page 6).

⁴⁵ Dr. Bilbil Memaj, Revista, “Policimi dhe Siguria”, nr.4/2016.: “Siguria publike arrihet me specialist të shkolluar dhe inteligjent”, Tiranë 2016, faqe 12.

komunitetin” në pikën 1 thuhet se: “Policia bashkëpunon me komunitetin për garantimin e rendit dhe sigurisë publike për ushtrimin e plotë të lirive dhe të së drejtave të personave, për rreziqet që mund t’u kanosen nga situatat e fatkeqësive natyrore e atyre aksidentale”⁴⁶.

9. Lidershipi dhe fenomenet ekstreme të natyrës/fatkeqësitë natyrore

Koncepti “siguri” është i vjetër që nga “*Westfalia*”, por dhe një koncept i ri, që rrënjët i ka tek “shkaqet e pasigurisë” që fillojnë me tezat e kërcënimeve në shoqëri, shtete, rajone, sistemin global ndërkombëtar, analizuar nga hartuesit e parimeve në qeveri, parlamente, analiza akademike, OJQ, korporata transnacionale dhe organizata ndërkombëtare; ku përgjigjet e tyre përcaktojnë cilësinë e paqes dhe stabilitetit në shek. XXI.⁴⁷

Vështirësitë lindin kur një vend, i ballafaquar me pasojat e një katastrofe natyrore, nuk është në gjendje të përgjigjet në ndonjë mënyrë të kuptimtë, qoftë nga mungesa e aftësive, në *kapacitete logjistike* ose për shkak se katastrofa i ka bërë autoritetet të paafte të veprojnë.⁴⁸ Fenomenet ekstreme të natyrës/fatkeqësitë natyrore përbëjnë rrezik dhe kërcënim për sigurinë kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare. Fatkeqësitë natyrore paraqesin disa nga problemet më të vështira të sigurisë,⁴⁹ sepse ato janë të paktën po aq destabilizuese sa konfliktet politike, ekonomike, etnike ose fetare të krijuara nga njeriu dhe vrasin më shumë njerëz në mesatare sesa konfliktet. Fatkeqësi të tilla shpesh krijojnë një numër të madh refugjatësh ose zhvendosje të popullsisë që kanë nevojë për ndihmë të menjëhershme, me qëllim parandalimin e katastrofave të tjera më të mëdha të tilla si uria, epidemitë ose kolapsi i plotë⁵⁰. Me fjalë të tjera, bota politikëbërëse ‘policy-making’ e qeverisë dhe subjektet ndërqeveritare ende nuk kanë qenë të gatshme apo në gjendje të diagnostikojnë kriza në mënyrë korrekte, dhe për këtë arsye nuk ka pothuajse asnjë perspektivë për të hartuar një përgjigje të qëndrueshme efektive (Gill 2008; Mittelman 2010).⁵¹

Emergjencat civile krijojnë humbje jetësh njerëzore, dëme të mëdha ekonomike, shoqërore, sociale, etj. Le të bëjmë një paralelizëm midis fushës së mjekësisë dhe kodit penal për veprat penale kundër emergjencave civile.” Vetëm parakushtet e mjekësisë dhe kodi penal e pengojnë mjekun që të heqë dorë nga trajtimi. Mjekësia nuk pyet nëse jeta ia vlen. Të gjitha shkencat e natyrës na japin përgjigje për pyetjen: çfarë duhet të

⁴⁶ https://mb.gov.al/ligji_i_Policise_së_Shtetit, faqe 30.

⁴⁷ Graeme P.Herd, “Siguria”, kapitulli 1, “Çështjet politike në botën e sotme”, publikuar nga “S.N, MacIver”, Manchester: Shtypi i Universitetit të Manchester, Britani e Madhe, 2004, faqe 17.

⁴⁸ Seybolt, Taylor B. 2007. *Humanitarian military intervention: the conditions for success and failure*. Stockholm: SIPRI.

⁴⁹ Mandel, R. (2002), Security and Natural Disasters. *Journal of Conflict Studies*, 22(2). Retrieved from <https://journals.lib.unb.ca/index.php/JCS/article/view/396>. (Marrë nga Dr. Xhavit Shala, “Fatkeqësitë natyrore dhe çështjet e sigurisë, mes realitetit dhe perceptimit (gjetjet dhe rekomandimet për përmirësimin e politikave)”, Revista “Policimi dhe Siguria, fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë”, Maj 2021, Botim i Akademisë së Sigurisë, Tiranë 2021, faqe 24.)

⁵⁰ Ted Constantine, Intelligence Support to Humanitarian -Disaster Relief Operations (Washington, DC: Central Intelligence Agency Center for the Study of Intelligence, December 1995), p.3-4. (Marrë nga Dr. Xhavit Shala, “Fatkeqësitë natyrore dhe çështjet e sigurisë, mes realitetit dhe perceptimit (gjetjet dhe rekomandimet për përmirësimin e politikave)”, Revista “Policimi dhe Siguria, fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë”, vëllimi i parë, Maj 2021, Botim i Akademisë së Sigurisë, Tiranë 2021, faqe 24.)

⁵¹ Stephen Gill, “Global Crises and the Crisis of Global Leadership”, Cambridge University Press, 2012, page 91.

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

bëjnë, *në qoftë se* duam të zotërojmë *teknikisht* jetën. Por a duhet dhe a duam ta zotërojmë atë teknikisht, dhe a ka kjo, në fund të fundit, faktikisht sens.”⁵²

Digat së në gjithë botën, janë nga pjesët më të rëndësishme dhe më vitale të infrastrukturës kombëtare, me të njëjtën rëndësi si urat, autostradat, aeroportet, etj.⁵³ “Shqipëria ka mbi 300 diga të larta të regjistruara në regjistrin botëror të digave të larta. Jemi vendi i parë në botë për numrin e digave të larta për banor. Një rekord botëror është edhe diga e Bovillës, e cila është ende diga më e lartë në botë me gjeomembranë. ...Këto diga janë shumë të qëndrueshme dhe më ekonomike në ndërtim. Sidoqoftë, digat kërkojnë inspektime dhe mirëmbajtje të vazhdueshme.”⁵⁴ Ndërsa sipas Kryetarit të Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha, në vendin tonë janë 650 diga të total, nga të cilat 362 janë diga të mëdha me lartësi mbi 15 metra, ... por shumica e digave janë mbi 30-40 vjeçare, të cilat kërkojnë patjetër mirëmbajtje, monitorim dhe një shfrytëzim me kujdes”⁵⁵.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ka në dhe varësinë e saj Komitetin Kombëtar të Digave të Mëdha (KKDM). Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë Belinda Balluku në shtator të vitit 2020 nënvizoi: “Në Republikën e Shqipërisë kemi diga të volumeve të mëdha, siç janë digat e kaskadës së Drinit, apo kemi diga, të cilat ndodhen me shumicë në zona të banuara, siç është qyteti i Tiranës, i cili është një nga qytetet me numrin më të madh të digave, mbi 40 diga. Siguria e digave për ne është prioritet dhe misioni i komitetit tuaj është që kjo siguri të garantohet në çdo hap të administratës”.⁵⁶

Megjithatë, në këto kushte rreziku në territor është i lartë. Ndërtimet e bëra në anën e poshtme të digave në periudhën e informalitetit e çojnë këtë rrezik në një zmadhim të deformuar.

Garantimi i sigurisë së digave, është një kërkesë e dispozitave të ligjit nr. 8681, datë 2.11.2000, “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”, dhe VKM nr. 147, datë 18.3.2004, “Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe të dambave”, por me numrin aktual të punonjësve të angazhuar për këtë qëllim, është i pamundur jo vetëm monitorimi i sigurisë së digave, neni 5, por edhe plotësimi i kërkesave për ruajtjen e digave, sipas pikës 5 të rregullores për sigurinë e digave dhe të dambave i miratuar me VKM nr. 147, datë 18.3.2004. Sipas vlerësimeve paraprake, kostot e ndërhyrjeve rehabilituese, me kritere projektimi të pranueshme për rritjen e sigurisë së digave, janë vlerësuar në rreth 100 milionë USD, për vetëm 200 diga, që kanë studime fisibiliteti, pa konsideruar rreth 240 diga të tjera, që kanë nevojë për rehabilitimin, por, që nuk kanë studime fizibiliteti.”⁵⁷

⁵² Max Weber, “Politika si profesion, shkenca si profesion, tre tipat e pastër të sundimit legjitim”, Shtëpia botuese “Fan Noli”, Tiranë 2006, faqe 124-125. (Marrë nga Dr. Bajram Ibraj “Fenomenet ekstreme të natyrës dhe siguria kombëtare”, Revista “Policimi dhe Siguria, fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë”, vëllimi i parë, Maj 2021, Botim i Akademisë së Sigurisë, Tiranë 2021, faqe 199.)

⁵³ Dr. Bajram Ibraj, “Fenomenet ekstreme të natyrës dhe siguria kombëtare” Revista “Policimi dhe Siguria, fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë”, vëllimi i parë, Maj 2021, Botim i Akademisë së Sigurisë, Tiranë 2021, faqe 202.

⁵⁴ Erjon Kalaja, “Tërmetet duhet të na bëjnë të shikojmë menjëherë sigurinë e digave”, (Tiranë: Exit.al, 26.9..2019). Burimi elektronik:

<https://exit.al/termetet-duhet-te-na-bejne-te-shikojme-menjehere-sigurine-e-digave/>

⁵⁵ Ibid.

⁵⁶ Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e Republikës së Shqipërisë, prezantohet Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha dhe Këshilli Teknik, Tiranë me 22.09.2020.

Burimi elektronik:

<https://www.infrastruktura.gov.al/prezantohet-komiteti-kombetar-i-digave-te-medha-dhe-keshilli-teknik>

⁵⁷ Dr. Bajram Ibraj, “Fenomenet ekstreme të natyrës dhe siguria kombëtare” Revista “Policimi dhe Siguria, fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë”, vëllimi i parë, Maj 2021, Botim i Akademisë së Sigurisë, Tiranë 2021, faqe 201.

Unë vetëm pyes: a mund të ketë pasoja në jetët njerëzore dhe ekonominë private e publike në vendin tonë, nëse ndodhin përmbajtje dhe katastrofa për shkak të gjendjes aktuale të digave dhe dambave? Vazhdoj akoma të pyes: kush do të mbajë përgjegjësi për pasojat që mund të ndodhin? Përsëri më duhet të pyes: a mendoni se është e mjaftueshme ndaj autorëve dhe shkaktarëve të pasojave të rënda që mund të krijohen nga mosfunksionimi, apo dëmtimi i digave dhe dambave. Dhe, në fund, përsëri më duhet të pyes: a përmban përgjegjësi penale, mos ushtrimi i detyrave nga lidershpi i ministrive përkatëse, KKDM dhe Inspektoriati teknik i digave dhe dambave?

Unë vetëm pyes: si është e mundur që *Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë* nuk ka dispozita të veçanta penale në lidhje me emergjencat civile dhe mbrojtjen civile, fatkeqësitë natyrore, dhe ligji “Për mbrojtjen civile” ka parashikuar vetëm dispozita për kundërvajtjet administrative? Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen Civile, mbi bazën e eksperiencës dhe përvojave të krijuara nga viti 2001 deri aktualisht, ku gjatë këtyre 20 viteve ka pasur disa lloje emergjencash, si tërmete, përmbajtje, zjarre, pandemi, ... dhe të gjitha rastet kur institucionet shtetërore, drejtuesit e personat përgjegjës, individët, drejtuesit e shërbimeve dhe bizneseve private, etj, kryetarit të bashkisë dhe institucioneve dhe personave përgjegjës në varësi të tyre⁵⁸. Marrëdhënia midis mjedisit dhe sigurisë ka qenë në shqyrtim gati dy dekada si në komunitetin shkencor edhe në atë politik. Çështjet mjedisore dhe të sigurisë janë shumëplanëshe dhe komplekse, në kuptimin kulturor, politik dhe shkencor⁵⁹.

Shteti mund të gjykohej për gatishmërinë e strukturave, për shpejtësinë e organizimit, për gatishmërinë për të dërguar forca, mjekë apo edhe vullnetarë. Por “të jesh i përgatitur” do të thotë edhe më shumë se kaq. Ne na mungojnë jo vetëm njohuritë, por edhe shprehjet e përgatitjes së individit dhe komunitetit për një situatë krize. Nëse njerëzit nuk dinë saktësisht se çfarë të bëjnë në raste emergjence, nuk lëvizin në drejtime të njohura më parë, nuk kryejnë veprime të organizuara, atëherë ne nuk jemi të gatshëm për të kuptuar fenomenin e aq më pak për të vepruar në raste emergjente.⁶⁰ Dhe asnjë emergjencë nuk mund të përballohet kur nuk përgatitesh. Për këtë, nuk e ka fajin çka ishim para 30 viteve, por ajo që jemi tani.⁶¹

*Kombi nuk shuhet, por elitat që nuk arrijnë nivelin e popullit, - shprehej Dritëroi i Madh, - shpejt ose vonë mbarojnë.*⁶² Prandaj, siç është shprehur Dr. Albert Schweitzer “Shembulli nuk është gjëja kryesore për të influencuar të tjerët. Është e vetmja gjë.” Shfrytëzoje rastin! E gjithë jeta është një rast. Ai njeri që shkon më larg, zakonisht është ai që është i gatshëm të bëjë dhe të guxojë. Barka e sigurt kurrë nuk lundron shumë

⁵⁸ Max Weber, “Politika si profesion, shkenca si profesion, tre tipat e pastër të sundimit legjitim”, Shtëpia botuese “Fan Noli”, Tiranë 2006, faqe 124-125. (Marrë nga Dr. Bajram Ibraj “Fenomenet ekstreme të natyrës dhe siguria kombëtare”, Revista “Policimi dhe Siguria, fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë”, vëllimi i parë, Maj 2021, Botim i Akademisë së Sigurisë, Tiranë 2021, faqe 199.)

⁵⁹ J. Barnett, in International Encyclopedia of Human Geography, 2009. (Marrë nga Prof. Dr. Kristaq Xharo, “Në dilemat e manaxhimit të katastrofave natyrore” Revista “Policimi dhe Siguria, fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë”, vëllimi i dytë, Maj 2021, Botim i Akademisë së Sigurisë, Tiranë 2021, faqe 18.)

⁶⁰ Stephen Green, International Disaster relief (New York: McGraw-Hill, 1997), p.36. (Marrë nga Prof. Dr. Kristaq Xharo, “Në dilemat e manaxhimit të katastrofave natyrore” Revista “Policimi dhe Siguria, fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë”, vëllimi i dytë, Maj 2021, Botim i Akademisë së Sigurisë, Tiranë 2021, faqe 22.)

⁶¹ Prof. Dr. Kristaq Xharo, “Në dilemat e manaxhimit të katastrofave natyrore” Revista “Policimi dhe Siguria, fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë”, vëllimi i dytë, Maj 2021, Botim i Akademisë së Sigurisë, Tiranë 2021, faqe 22.

⁶² Prof. Dr. Kristaq Xharo, “Në dilemat e manaxhimit të katastrofave natyrore” Revista “Policimi dhe Siguria, fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë”, vëllimi i dytë, Maj 2021, Botim i Akademisë së Sigurisë, Tiranë 2021, faqe 24.

larg bregut, ka thënë, Dale Carnegie. Më jep njerëzit e duhur dhe nuk më intereson se çfarë organizate do më japësh. Gjëra të mira do të ndodhin. Më jep njerëzit e gabuar dhe nuk ka rëndësi se çfarë do të bësh me organizatën. Gjëra të këqija do të ndodhin (Colin Powell). Mos drejtoni duke i goditur të tjerët në kokë, ky është sulm, jo leadership (Dwight D. Eisenhower). Komuniteti është si një anije; të gjithë duhet të jenë të përgatitur të marrin timonin (Henrik Ibsen) dhe, e vetmja anije e sigurt në një stuhë është leadershipi (Faye Wattleton). Liderët që punojnë më me efektivitet janë ata që kurrë nuk thonë “unë”. Dhe kjo jo sepse e kanë stërvitur veten të mos thonë “unë”. Ata nuk mendojnë me “unë”. Ata mendojnë “ne”, ata mendojnë “skuadër”. Ata e kuptojnë se puna e tyre është ta bëjnë skuadrën të funksionojë. Ata pranojnë përgjegjësi dhe nuk i shmangen asaj, por “ne”-ja i merr meritat. Kjo gjë krijon besim, dhe ju aftëson që puna të përfundohej (Peter Drucker). Arti i leadershipit është të thuash “jo”, jo “po”. Është shumë e lehtë të thuash “po” (Tony Blair). Ekzistojnë shumë elemente tek një fushatë. Leadershipi është numri një. Gjithë të tjerat janë numri dy (Bernd Breche), dhe çmimi i madhësisë është përgjegjësia (Winston Churchill).

10. Përfundime dhe rekomandime

Në këtë punim “Leadershipi dhe siguria në komunitet në kontekstin e fenomeneve ekstreme të natyrës dhe emergjencave civile”, shpjeguar se historia e leadershipit si fushë studimi, situata e liderit; sjellja e liderit në situata të caktuara, leadershipi si shërbim, leadershipi i “dritës” dhe leadershipi “i errët”, cila është historia e programeve të policimit në komunitet? Siguria dhe policimi në komunitet, leadershipi dhe krizat e ndryshme dhe leadershipi dhe fenomenet ekstreme të natyrës/fatkeqësitë natyrore. Gjatë këtij punimi pyetja kryesore që lindi: Si ndikojnë leadershipi dhe siguria e policimi në komunitet në rastet e fenomeneve ekstreme të natyrës? U testua se roli, rëndësia dhe përgjegjësia që ka nga njëra anë leadershipi dhe sigurimi i komunitetit dhe nga ana tjetër, rolin, problematikat që krijojnë fatkeqësitë e natyrës e menaxhimi i leadershipit dhe mbështetja e komunitetit ndikojnë ndjeshëm për përballimin me sukses të tyre. Prandaj, nga ky punim, si zgjidhja më e suksesshme për të ardhmen, do të arrinim në këto përfundime dhe rekomandime.

1. Leadershipi është jo vetëm i rëndësishëm, i domosdoshëm por edhe jetik si dhe “një ndër shqetësimet më të vjetra të botës dhe aq më tepër që ky term nuk trajtohet pothuajse fare në bazën ligjore, normative, menaxheriale dhe strategjike në vendin tonë. Dhe siguria dhe policimi në komunitet në kontekstin e fenomeneve ekstreme të natyrës dhe emergjencave civile jo vetëm për shoqërinë, shtetin, komunitetin dhe individin por edhe më gjerë, leadershipi luan një rol madhor dhe të padiskutueshëm për parandalimin, menaxhimin dhe minimizimin e pasojave anësore që shkaktojnë ato. Prandaj, gjetja e leadershipit të aftë dhe kompetent është suksesi i organizatës, punonjësve dhe i komunitetit.

2. Leadershipi, personeli i organizatave publike e private dhe komuniteti për përballimin e situatave të vështira, lypet që të jenë të përgatitur dhe të aftë për mënyrën e veprimit të tyre në praktikë, në situatat e të papriturave që krijojnë fatkeqësitë natyrore. Ndërsa, leadershipi shërbyes i cili e vendos liderin në rolin e shërbëtorit dhe me aftësitë e larta që mund të tregojë në situatat e jashtëzakonshme, është jo vetëm i mirëpritur dhe me besim të lartë të komunitetit, por edhe u ngjall shpresë, kurajë e besim komunitetit dhe qytetarëve. Prandaj, kërkohet shkathtësi, bindje, praktikitet, vendosmëri, veprime

me emergjencë, vendimmarrje të shpejtë në mbështetjen e komunitetit për të bërë të mundur arritjen e qëllimeve të strukturave shtetërore, publike, private dhe organizatës policore.

3. Policia e Shtetit si pjesë e administratës shtetërore dhe punonjësi i policisë është nëpunës civil, si dhe në bazë të ligjit për Policinë e Shtetit 2014, Policia e Shtetit *de jure* është e depolitizuar, ndërkohë që me politikat që kanë ndjekur shumicat qeverisëse në vitet 1991-2022, kanë treguar që *de facto* Politika për “nevojat” e saj e ka politizuar ndjeshëm Policinë e Shtetit, veçanërisht drejtuesit e saj të niveleve të ndryshme të drejtimit në strukturat qendrore dhe vendore të policisë.

4. Dy shtyllat themelore të policimit demokratik janë “Policimi në komunitet” dhe policimi i udhëhequr nga intelijenca. Këto janë dy shqetësime të policisë dhe komunitetit, prandaj lypet edhe konfigurimi i policisë duhet bërë në një metodë të re të udhëhequr nga fryma e policimit në komunitet dhe udhëheqjes nga intelijenca. Pra, lypet një etikë e re, duke e bërë sfidë menaxherizmin e ri ashtu si në vendet perëndimore që ka filluar të karakterizojë policimin e shekullit të 21-të.

5. Në Policinë e Shtetit gjykohet se është e nevojshme orientimi ndaj konsumatorëve, klientëve e qytetarëve si taksapagues dhe të ofrojnë shërbim cilësor ndaj tyre, si dhe ndaj punonjesve për të shërbyer dhe punuar me standarde më të larta etike e profesionale në detyrë. Nevojitet ti jepet fund prezantimit tradicional të punonjesve të policisë për veten e tyre si “dominues”, “pronar”, dhe duhen shndërruar punonjësit e policisë në shërbëtorë të qytetarëve të cilët duhet të vlerësohen si të barabartë, pra të shfaqet një frymë dhe etikë e re e policisë. Gjithashtu, edhe drejtuesit, mbikëqyrësit, menaxherët dhe lidërsipin në polici të jetë lidërsip shërbyes dhe të zbatojnë “policimin në komunitet” si një model dhe kjo frymë të shpërndahet që nga studentët në auditor dhe deri tek punonjësit që ditën e parë të punës pas urdhrit të emërimit në detyrë.

6. Lidërsipin i Policisë së Shtetit, lidërsipin i lartë drejtues në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, lidërsipin i nivelit vendor i drejtorëve të policive në qarqe dhe komisariateve të policisë, lypet të fillojnë punën nga njohja e gjendjes së qytetarëve, nga kërkesat e tyre jetësore, siguria e jetës, mirëqënies, problematikave të tyre dhe mbi këtë bazë të ndërtojnë strategjitë dhe programet e punës së tyre dhe duhet të rikthehen tek qytetarët, duke gjetur mënyra për të “shikuar si qytetar”, “see like a citizen”, dhe për të përmbushur misionin e “shenjtë” të Policisë së Shtetit. Ashtu sic shprehet Max DePree, “Përgjegjësia e parë e një lideri është të përcaktojë realitetin. E fundit është për të thënë faleminderit. Në mes, lidërsipin është një shërbëtor. Këtë lypet të bëjë edhe lidërsipin në Policinë Shqiptare.

7. Lidërsipin, por jo vetëm nuk duhet të nënvlerësojnë apo të mbivlerësojnë detyrën e marrë, duke vënë në rrezik të gjithë procesin në shërbimet që ata drejtojnë, nuk duhet të tregojnë arrogancë, mendjemadhësi dhe as të mohojnë dështimet e tyre sepse këto sjellje nuk janë sjellje zyrtari dhe as sjellje lidërsipin pasi këta individë nuk marrin përgjegjësi ose nuk dëgjojnë; ata e konsiderojnë veten mbi rregullat, prandaj lypet që nderimi dhe respekti i të tjerëve duhet të jetë pjesë thelbësore e praktikës, e mësimit dhe zhvillimit të lidërsipin në radhë të parë nga Akademia e Sigurisë.

8. Megjithatë policia po bëhet më e larmishme dhe më përfaqësuese e komuniteteve të cilave u shërbejnë, konstatohet se preferencat e sigurisë të publikut mund të mos jenë prezent gjithmonë sepse nuk njihet dhe nuk përcaktohet se çfarë janë nevojat e tyre reale të sigurisë. Ashtu, si edhe kjo mund të jetë problematike, sepse proceset e konsultimit mund të privilegjojnë anëtarët me burime më të mira dhe më të artikuluar të

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

komunitetit, në kurriz të të pafavorizuarve dhe të marginalizuarve. Prandaj, lypet të ndryshojë praktika e policimit, nëse ekziston një praktikë e tillë, në komunitetet ku gjendja e sigurisë dhe ajo policore është e vështirë, ose jo e mirë, ku “komuniteti” përjeton kriminalitet të shtuar, ngjarje kriminale të rënda, ngjarje të jashtëzakonshme, fatkeqësi natyrore dhe emergjenca civile, si në Vlorë, Shkodër, Elbasan, në disa lagje ku kanë ndodhur krime për hakmarrje e gjakmarrje, në disa zona të tjera ku grupet kriminale i kanë ri “sigurizuar” këto zona me kamera, roje dhe anëtarë të tyre për “sigurizimin” e tyre dhe banorët gjenden në panik, ankth dhe frikë.

9. Gjithashtu, lypet dhe të fillohet të shihet në të ardhmen se edhe policimi në komunitet është jashtëzakonisht i vështirë për t’u zbatuar, pasi pengesat për policimin në komunitet janë të shumta dhe të ndryshme, një pjesë e madhe e policimit është rutinë dhe e zakonshme, shpesh perceptimet publike për policimin shfaqen të ngjyrosura nga përshkrimet mediatike, të trilluara ose faktike, të cilat përpunohen sipas rregullit për të emocionuar lexuesin, shikuesin ose dëgjuesin, por edhe se në kulturën tradicionale të policimit, disa detyra policore fatkeqësisht hidhen poshtë si “punë sociale”/“social work”, kur në fakt janë punë policore dhe policim demokratik.

10. Gjithashtu, nevojitet të rishikohen mënyrat, format dhe metodat për ta kthyer vështirësinë në mobilizimin e publikut, në një lehtësi dhe në një bashkëpunim të ri, mjediset e qeta dhe të kulturuara dhe me kriminalitet të ulët duhet të merren si model dhe duhen bërë studime dhe programe konkrete që në zonat, krahinat, lagjet e segmentet e pafavorizuara dhe përndryshe të marginalizuara të komunitetit që ushqejnë sado pak mosbesim ndaj policisë, apo thjesht mund t’u mungojnë aftësitë për t’u angazhuar me ta. Kjo është e domosdoshme për ta bërë në mënyrë të vazhdueshme sepse në rastet e emergjencave civile, policisë mund t’i vështirësohet në mënyrë të ndjeshme puna e saj me komunitetin.

11. Shteti mund të gjykohet për gatishmërinë e strukturave, për shpejtësinë e organizimit, për gatishmërinë për të dërguar forca, mjekë apo edhe vullnetarë. Por “të jesh i përgatitur” do të thotë edhe më shumë se kaq. Prandaj, është e domosdoshme që të realizohet përgatitja e duhur e qytetarëve dhe komunitetit për krizat dhe situatat emergjente.

12. Në situatat ekstreme të faktorëve natyrorë policisë i shumëfishohet ngarkesa, ato paraqesin disa nga problemet më të vështira të sigurisë deri në situata destabilizuese si konfliktet politike, ekonomike, etnike ose fetare të krijuara nga njeriu dhe vrasin më shumë njerëz në mesatare sesa konfliktet, etj, ku krahas sigurimit të rendit e qetësisë publike dhe kriminalitetit që i vijnë shoqërisë nga brenda si rezultat i veprimit të dorës së krimit, etj, duhet të përballet edhe me sfidat e shtruuara të fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile dhe jo vetëm. Fatkeqësitë natyrore dhe emergjencat civile krijojnë humbje jetësh njerëzore, dëme të mëdha ekonomike, shoqërore, sociale, prandaj Policia e Shtetit në kuadër të ligjit “Për mbrojtjen civile”, dhe ligjit “Për Policinë e Shtetit” si një ndër pesë strukturat që përfshihen në kushtet ku ndodhin fenomenet ekstreme të natyrës lypet të veprojnë në këtë mënyrë:

- të identifikojnë problematikat përpara ndodhjes së fatkeqësive natyrore dhe shkelësit e ligjeve që kanë qenë shkaku i këtyre fatkeqësive që lidhen me ndërtimet pa leje, abuzime, etj, por jo vetëm t’i vendosin përpara përgjegjësisë ligjore përpara se të ndodhin fatkeqësitë natyrore dhe emergjencat civile dhe dokumentet dhe provat ligjore t’ua dërgojnë prokurorisë për ndjekje penale;

- Policia e Shtetit të jetë prezent gjatë gjithë bashkëpunimit dhe koordinimit

ndërinstitucional struktural për planifikimin, menaxhimin dhe përballimin e emergjencave civile në çdo lloj fenomeni të ekstremitet natyror;

- marrja e masave për zbatimin rigoroz të afateve dhe procedurave ligjore për dhënien e ndihmës së menjëhershme me synim konsolidim të strukturave për mbrojtjen dhe sigurinë publike;

- vendosja në dispozicion të një bazë të dhënash për burimet dhe mjetet e gatshme në rast emergjence dhe vlerësimet qendrore dhe lokale për rreziqet në të gjithë shtrirjen territoriale shqiptare;

- mundësimin e strukturave të vullnetarëve civilë dhe të stafëve të trajnuar për të qenë të përgatitur ndaj rreziqeve të dimrit dhe shtim i kapaciteteve njerëzore e logjistike në funksion të përballimit të emergjencave civile në të gjithë territorin.

Gjithashtu, lypet të zgjidhin këto probleme:

- Mbrojtja e zonës së emergjencës civile, ruajtja e rendit publik, procesi i identifikimit dhe i informimit rreth të dëmtuarve dhe viktimave, largimi i tyre nga zona e emergjencës, si dhe detyra të tjera që dalin në zbatim të legjislacionit në fuqi për Policinë e Shtetit e më gjërë;

- ruajtjen e banorëve në zonat e emergjencës nga kriminaliteti i përditshëm, dhe nga kriminaliteti i “ri” që shfrytëzojnë e synojnë këto momente keqëbërës dhe grupet kriminale t’u vjedhin, plaçkitin e dëmtojnë banorët dhe pasurinë e tyre;

- bashkëpunon me komunitetin për garantimin e rendit dhe sigurisë publike për ushtrimin e plotë të lirive dhe të së drejtave të personave, për rreziqet që mund t’u kanosen nga situatat e fatkeqësive natyrore e atyre aksidentale.

13. Garantimi i sigurisë së digave, është një kërkesë e dispozitave të ligjit nr. 8681, datë 2.11.2000, “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”, dhe VKM nr. 147, datë 18.3.2004, “Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe të dambave”, prandaj Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) dhe Inspektorati teknik i digave dhe dambave, lypet që të bëhet plotësimi i kërkesave për ruajtjen dhe monitorimin e sigurisë së digave, të rriten kostot e ndërhyrjeve rehabilituese dhe për rreth 240 diga që kanë nevojë për rehabilitimin, por, që nuk kanë studime fizibiliteti të bëhet edhe studimi i fizibilitetit dhe rehabilitimi i tyre.

14. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë nuk ka dispozita të veçanta penale në lidhje me emergjencat civile dhe mbrojtjen civile, fatkeqësitë natyrore, dhe ligji “Për mbrojtjen civile”, prandaj propozohet që Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen Civile, por jo vetëm, të parashikojnë e propozojnë këto ndryshime dhe Kuvendi të miratojë dispozitat shtesë për sa më sipër.

15. Të ngrihen njësitë e drejtimit teknik në çdo bashki në plotësim të kërkesave të nenit 5 të VKM nr. 147, datë 18.3.2004. Këto njësi do mbajnë nën kontroll gjendjen e degës dhe sigurinë e saj.

16. Ministrinë dhe bashkitë, që kanë në administrim diga, duhet që në programet buxhetore të përvitshme të parashikojnë, investime dhe shpenzime si zë i veçantë, për rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e digave, duke i paraprirë këtij procesi me studime të plota të fizibilitetit dhe hartimin e projekteve të zbatimit.

17. Të ngrihet Instituti Kombëtar i Ujit, i cili duhet të administrojë të gjithë arkivin teknik të veprave të ndërtuara në vendin tonë (diga, argjinatura, vepra marrje, hidrovore, kanale të ujërave të larta, etj, sepse këto janë pasuri e vërtetë e krijuar në vite dhe që po humbet nga mungesa e vlerësimit.

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

Bibliografia

1. Hilarie Owen, "New Thinking on Leadership- A global Perspective", United States, 2012.
2. Dakota Schmitt, "The Art and Science of Leadership "Library Press, 5 Penn Plaza, 2017, New York, NY 10001, USA, 2017.
3. Nitin Nohria & Rakesh Khurana, "Manual i teorisë dhe praktikës së Lidershipit"-Udhëzime dhe referenca, Një bashkëbisedim njëqindvjeçar për lidershipin e avancuar në Shkollën e Harvardit për biznesin, botuar nga Shtëpia Botuese Universitare UFO, Press, qershor, 2011.
4. Dov Frohman and Robert Howard "Leadership the Hard Way"- Why Leadership Can't Be Taught and How You Can Learn It Anyway- United States of America, 2008.
5. Blank Warren "108 aftësitë natyrale të lindura të liderëve", Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Nju Jork, 2001. 2001. Për më shumë lexo: Shtojca "108 aftësitë natyrale të lindura të liderëve".
6. Peter g. Northouse;"Leadership Theory and Practice", Seventh Edition Western Michigan University, United States of America, 2016.
7. Enver Krasniqi, Vasilika Kume, Nazmi Mustafa, "Lidershipi, teori, koncepte, praktika", Botimi i dytë i plotësuar, 2019.
8. Richard L. Morrill "Lidershipi Strategjik", Shtetet e Bashkuara të Amerikës, 2007.
9. Mark C. Bojeun, Ph. D. "Programi i Menaxhimit të Lidershipit", London, New York, 2014.
10. James McGregor Burns, Leadership (New York: HarperCollins, 1978), 19.
11. John Gardner, The Moral Aspect of Leadership (Washington, D.C.: Independent Sector, 1987), 9, 10, 13.
12. Gardner, The Moral Aspect of Leadership, 3. See also Adel Safty, "Moral Leadership: Beyond Management and Governance," Harvard International Review 25, 3 (2003): 84, 85. (Deborah L. Rhode, "Moral Leadership The Theory and Practice of Power, Judgment, and Policy", Foreword by Warren Bennis, San Francisco, 2006).
13. Peter Grabosky "Community Policing and Peacekeeping", Edited by with the assistance of Christine Nam CRC Press, Taylor & Francis Group, 2009.
14. Paul Ekblom, "Crime Prevention, Security and Community Safety Using the 5Is Framework" *Central Saint Martins College of Art & Design, University of the Arts London, UK*, First published 2011 by Palgrave Macmillan.
15. Amy L. Fraher "Thinking through Crisis Improving Teamwork and Leadership in High-Risk Fields, Cambridge University Press, United States of America, first published 2011.
16. Prof. Asc. Dr. Zaho Golemi, Revista "Policimi dhe Siguria, fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë", Maj 2021, Botim i Akademisë së Sigurisë, Tiranë 2021.
17. Dr. Bilbil Memaj, Revista, "Policimi dhe Siguria", nr.4/2016.; "Siguria publike arrihet me specialist të shkolluar dhe inteligjentë", Tiranë 2016.
18. Graeme P.Herd, "Siguria", kapitulli 1, "Çështjet politike në botën e sotme", publikuar nga "S,N, MacIver", Manchester: Shtypi i Universitetit të Manchester, Britani e Madhe, 2004.
19. Seybolt, Taylor B. 2007.*Humanitarian military intervention: the conditions for success and failure*. Stockholm: SIPRI.
20. Dr. Xhavit Shala, "Fatkeqësitë natyrore dhe çështjet e sigurisë, mes realitetit dhe perceptimit (gejtjet dhe rekomandimet për përmirësimin e politikave)", Revista "Policimi dhe Siguria, fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë", Maj 2021, Botim i Akademisë së Sigurisë, Tiranë 2021).
21. Ted Constantine, Intelligence Support to Humanitarian -Disaster Relief Operations (Washington, DC: Central Intelligence Agency Center for the Study of Intelligence, December 1995).
22. Stephen Gill, "Global Crises and the Crisis of Global Leadership", Cambridge University Press, 2012.
23. Max Weber, "Politika si profesion, shkenca si profesion, tre tipat e pastër të sundimit legjitim", Shtëpia botuese "Fan Noli", Tiranë 2006.
24. Dr.Bajram Ibraj "Fenomenet ekstreme të natyrës dhe siguria kombëtare", Revista "Policimi dhe Siguria, fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë", vëllimi i parë, Maj 2021, Botim i Akademisë së Sigurisë, Tiranë 2021.
25. Erjon Kalaja, "Tërmetet duhet të na bëjnë të shikojmë menjëherë sigurinë e digave", (Tiranë: Exit.al, 2019).
26. Ministria e Infrastrukturrës dhe Energjisë e Republikës së Shqipërisë, prezantohet Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha dhe Këshilli Teknik, Tiranë me 22.09.2020.
27. Max Weber, "Politika si profesion, shkenca si profesion, tre tipat e pastër të sundimit legjitim", Shtëpia botuese "Fan Noli", Tiranë 2006.
28. J. Barnett, in International Encyclopedia of Human Geography, 2009.
29. Prof. Dr. Kristaq Xharo, "Në dilemat e manaxhimit të katastrofave natyrore" Revista "Policimi dhe Siguria, fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë", vëllimi i dytë, Maj 2021, Botim i Akademisë së Sigurisë, Tiranë 2021.)
30. Stephen Green, International Disaster relief (New York: McGraw-Hill, 1997).

31. Afsaneh Nahavandi, "The Art and Science of Leadership" second edition, *Arizona State University West*, by Prentice-Hall, Inc. Upper Saddle River, New Jersey, 2000.
32. Dakota Schmitt, "The Art and Science of Leadership" Library Press, 5 Penn Plaza, 2017, New York, NY 10001, USA, 2017.
33. Ligj nr. 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile".
34. Ligj nr.108/2014 "Për Policinë e Shtetit".
35. Ligj nr.152/2013"Për nëpunësin civil", (ndryshuar me ligjin nr.178/2014 dhe ligjin 41/2017).
36. Ligj nr. 8681, datë 2.11.2000, "Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave".
37. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 147, datë 18.03.2004, "Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe të dambave".
38. Leadership Lending Library. <https://www.usgs.gov/about/organization/science-support/human-capital/leadership-lending-library>
39. <https://mb.gov.al>, ligji i Policisë së Shtetit.
40. <https://journals.lib.unb.ca/index.php/JCS/article/view/396>.
41. <https://exit.al/termetet-duhet-te-na-bejne-te-shikojme-menjehere-sigurine-e-digave/>

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

Siguria energjetike: legjislacioni dhe energjitë e rinovueshme



■ **Prof. dr. Petrit ZORBA**
Departamenti i Meteorologjisë,
IGEO, UPT, Tiranë



■ **Dr. Nike SHANKU**
Departamenti i Sist.Elektrike
të Fuqisë, FIE , UPT, Tiranë



■ **Ing. Elsuida HOXHA**
PhD (c), Grove School of
Engineering CCNY, NY, USA

Abstrakt

Siguria energjetike kombëtare, por dhe individuale përmirësohet dhe garantohe në se paraprihet dhe mbështetet nga një legjislacion, që ndjek ecurinë e teknologjive të reja si dhe mban në konsideratë mendimin shkencor institucional. Kjo analizë bazuar në këtë studim dhe dedikuar energjive të rinovueshme (E.R.) kryesisht për konvertimin e rrezatimit diellor (RR.D.) në energji elektrike (E.E.) për vetëkonsum synon të përcjellë dhe mundësojë evidentimin e problematikave dhe nxjerrë në pah se çfarë duhet bërë për të përmirësuar situatën nga pikëpamja ligjore. Përkundër një potenciali të lartë sa i takon E.R. të RR.D., që ofron natyra e klima e Shqipërisë gjatë këtyre 30 viteve të humbura nga mungesa e një legjislacioni apo ende të jo të arrirë, në këtë artikull synohet të trajtohen ato elementë juridike (ligj, udhëzues, etj..) që duhen përmirësuar me qëllim që mos humben edhe 30 vite të tjera. Kjo do të ndihmonte një prodhim më të lartë nga E.R. në shkallë kombëtare ashtu siç prej dekadash ndodh në disa vende të BE, ndonëse kanë vetëm gjysmën e potencialit tonë; të uleshin shpenzimet për (E.E.) të familjarëve, bizneseve të ndryshme apo institucioneve të shtetit; të kishim politika më nxitëse për implementimin e teknologjive të reja për përdorimin e këtyre resurseve energjetike dhe natyrisht një përgjegjësi më të lartë dhe mbrojtje më të mirë të mjedisit.

Fjalëkyçe:

siguri energjetike, energji e rinovueshme, energji elektrike, legjislacion

AKADEMIA
E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

1. Hyrje

Në vendin tonë ekziston një legjislacion i shoqëruar dhe me akte nën ligjore si dhe udhëzime të ndryshme, që në pamje të parë mundësojnë lejimin e ndërtimit të sistemeve apo implementimit të teknologjive që mundësojnë konvertimin e energjisë që mbart RR.D. në E.E. Ndonëse me shumë vonesë kundrejt vendeve të tjera europiane dhe ndonëse ka vite që është i njohur potenciali për këtë lloj burimi E.R. që ka në Shqipëri (deri në 3000 orë me diell në vit), më së fundi në 2-3 vitet e fundit janë miratuar aktet e duhura juridike. Pikërisht kjo bazë ligjore analizohet në këtë studim, më specifikisht duke trajtuar krahas anës pozitive dhe ato anë që duhen përmirësuar, pasi në se një gjë e tillë nuk ndodh në fakt ndodhemi përballë një pakete ligjore, që nuk bën nxitjen e duhur në këtë drejtim, nëse nuk ndërmerren shpejt dhe në kohë vendimmarrjet e duhura përmirësuese ligjore. Gjithashtu synohet të integrohet mendimi shkencor profesional për sa i takon elementit meteorologjik rrezatim diellor, si një faktor i rëndësishëm klimë formues dhe ndërkohë të jepet një përgjigje në lidhje me atë çka mungon dhe duhet përmirësuar në ligjin aktual dhe udhëzimet përkatëse në të ardhmen, që aktualisht konsiderohen si mungesë informacioni.

2. Metodika e përdorur

Analiza e paketës ligjore në fuqi në vendin tonë dhe në vendet europiane si dhe marrja në konsideratë e studimeve shkencore për vlerësimin e RR.D. në Shqipëri apo vendet e tjera të BE dhe USA e trajtuar nga pikëpamja shkencore për të pasur më të mirën për përdoruesin individual ose vetë shtetin në tërësi synon të nxjerrë në pah problematikat dhe orientojë se ç'duhet bërë dhe si duhet vepruar apo bazuar në

**AKADEMIA
E SIGURISË**

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

përmirësimet që synohen, qoftë nga ajo që nënkupton vetë legjislacioni VKM nr. 718, datë 12.10.2016 si dhe udhëzimi nr. 3 datë 20.6.2019, apo ajo që do e kërkojë koha shumë shpejt. Situata aktuale e legjislacionit dhe akteve të tjera shoqëruese për sa i takon vetëm pjesës që ka lidhje me shfrytëzimin e RR.D. si burim alternativ E.E. në Shqipëri është paraqitur në vijim me pikërisht ato paragrafë që kanë interes dhe kanë nevojë për tu ndalur dhe analizuar seriozisht me qëllim që të synohet dhe ndërhyhet sa më shpejt për t'i përmirësuar.

3. Analiza e problemit të parashtruar

Në fakt kjo analizë nxitjen e parë e mori nga reagimi jo pozitiv që ndesh nga përdoruesit apo bizneset si dhe këdo të interesuar për të përhapur apo implementuar këtë lloj burimi E.R., që bazohet në konvertimin e energjisë së RR.D nëpërmjet paneleve fotovoltaike në E.E.

Le të shikojmë fillimisht anën ligjore, ku në vijim përcillen vetëm ato paragrafë që janë përzgjedhur dhe paraqesin interes më specifik dhe që në momente të caktuara janë në «kundërshtim me vetveten». Natyrisht vendimi bazë është ai nr. 822 i datës 1.10.2015, i ndryshuar me VKM nr. 718, datë 12.10.2016, nr. 633, datë 27.10.2021, (i përditësuar)⁽¹⁾. Një pjesë e kësaj VKM-je paraqitet në vijim:

VENDIM

Nr. 822, datë 7.10.2015

Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncensionit (ndryshuar me VKM nr.718, datë 12.10.2016, nr.633, datë 27.10.2021) (i përditësuar)

.....
Neni 9.

Të dhënat, informacionet dhe kriteret specifike, sipas tipit të burimit gjenerues të energjisë elektrike.

Ç. Për një sistem fotovoltaike:

- karakteristikat teknike të sistemit fotovoltaike;
 - rrezatimin diellor mesatar vjetor, të vendit ku do të ndërtohet sistemi, [kJ/m² në vit];
 - këndin optimal të përthyerjes, të panelit diellor;
 - sipërfaqen, në metra katrorë, të panelit të instaluar;
 - respektimin e normave mjedisore për shkarkimet në ajër, ujë dhe tokë, si dhe për çdo komponent mjedisor, sipas legjislacioneve në fuqi në fushën e mjedisit.
- Gjithashtu duhet përmëndur dhe udhëzimi Nr.3 i datës 20.6.2019⁽²⁾, ku në vijim përcillen disa paragrafë që do të analizohen më në detaje dhe janë subjekti kryesor i këtij studimi dhe artikulli.

Udhëzim Nr. 3, datë 20.6.2019.

Për miratimin e procedurës së lehtësuar të autorizimit për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të projekteve të vogla të rinovueshme për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga dielli. Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë. Tiranë – 17 korrik 2019 nr. 103 (f. 7558).

1. Një shoqëri e vogël ose e mesme, apo një klient familjar mund të instalojë një

kapacitet total deri në 500 kWp për vetëprodhimin e energjisë elektrike nga dielli në përputhje me nenin 15, të ligjit nr. 7/2017.

3. Injektimi në rrjet do të lejohet për kategorinë e konsumatorëve të përcaktuar sipas pikës 1 të këtij udhëzimi, të cilët mund të prodhojnë një pjesë ose të gjithë energjinë elektrike që konsumojnë nga impianti PV diellore. Bilanci dhe faturimi neto, të bëhen nga OSHEE-ja në baza mujore për secilën pikë matjeje të autorizuar të klientit.

Teprica e energjisë, më e madhe se konsumi mujor, do t'i shitet Furnizuesit të Shërbimit Universal pas miratimit të Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar për vetëkonsum nga kjo kategori konsumatorësh.

6. Fuqia e instaluar e impiantit PV, për prodhimin e energjisë elektrike nga dielli, për çdo pikë lidhjeje ose/apo konsumator, do të llogaritet mbi bazën e orëve të punës në pikë të prodhimit të energjisë elektrike nga ky impiant, por në asnjë rast nuk duhet të kalojë fuqinë e kërkuar. Deri në miratimin e një harte të rrezatimit në varësi të pozicionit gjeografik, kjo fuqi do të llogaritet për rrezatimin e mesatarizuar 1,400 kWh/kWp, pavarësisht faktit se në cilin rajon të Shqipërisë vendoset impianti.

7. Aplikimi për lidhjen e impiantit PV dhe matësit me dy drejtime në rrjetin e shpërndarjes, do të fillojë të bëhet menjëherë sipas procedurave të ngjashme për lidhjet e reja pranë zyrave të kujdesit të klientit të OSHEE-së.

7/d) propozimin mbi modelin e matësit dhe karakteristikat teknike të tij. Subjekti është i detyruar, sipas nenit 15 "Skemat e matjes neto të energjisë", të ligjit nr. 7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme të energjisë", të instalojë me shpenzimet e veta një matës inteligjent me dy drejtime, sipas kërkesave të përcaktuara nga OSHEE-ja në përputhje me *Kodin e matjes*. Matësi, duhet të matë energjinë elektrike që subjekti merr nga rrjeti i OSHEE-së dhe energjinë elektrike që subjekti (impianti PV) fut në rrjetin e OSHEE. Për të njohur konsumin e përgjithshëm të energjisë elektrike të klientit vetëprodhues, vendoset një matës inteligjent me një drejtim të prodhimit pas inventarit kryesor, sipas kërkesave të përcaktuara nga OSHEE-ja në përputhje me *Kodin e matjes*.

17. Deri në miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar, teprica e energjisë, që tejkalon konsumin mujor, do t'i kalojë Furnizuesit të Shërbimit Universal pa kundërshtpërbllim për vetëprodhuesit.

Bazuar në këtë bazë ligjore të gjithë përdoruesit, bizneset e interesuar për të investuar në këtë sektor, institucionet e interesuar për të zbatuar teknologji të tilla, individë shtëpiakë apo grupe komunitare, etj, e po ashtu dhe institucione të ndryshme që indirekt përfshihen në të, siç janë ato shkencore, arsimore, mediatike, etj., duhet të kenë në konsideratë dhe një sërë kufizimesh që rrjedhin po nga kjo bazë ligjore, siç ato janë analizuar në vijim dhe arsyet pse ato duhen përmirësuar. Ndonëse për çdo pikë të këtij udhëzimi nr. 3 datë 20.6.2019 në momentin e përgatitjes së tij hartuesit mund të kenë pasur arsyet dhe argumente të caktuar, gjithsesi ka ardhur koha se duhet ndalur me vëmendjen dhe seriozitetin e duhur për të parë se kur dhe si mund të përmirësohet më tej kjo situatë ligjore, e cila sa në fillim duket pozitive në fakt është dhe frenuese për iniciativa në këtë sektor.

Në lidhje me pikat përkatëse me interes të këtij udhëzimi nr. 3 në vijim bëhet një analizë e detajuar dhe jepen argumentet e duhur jo vetëm shkencorë, që ato të mund të përmirësohen dhe rregullohen.

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

1-Kufizim në fuqinë që mund të prodhohet: “Deri në 500 kW/p fuqia maksimale e lejuar” (pika 1 e udhëzimit nr. 3, datë 20.6.2019).

Ky kufizim i shtyn të interesuarit të bëjnë artifica dhe të gjejnë rrugëdalje ligjore, kur është fjala që kjo vlerë mund të duhet apo të kërkohet të jetë më e lartë; duke tentuar për ta ndarë në projekte (pra një kërkesë për 650 kW/p të ndahet në dy pjesë 500 + 150) duke krijuar pa dashje, por të detyruar jo vetëm për shpenzime shtesë, por dhe për burokraci të panevojshme dhe vonesa. Ndaj ky kufizim duhet të jetë më elastik ose gjetur një argumentim më kuptimplotë e domethënës dhe vlera të jetë e ndryshueshme në vartësi të faktorëve të caktuar siç mund të jenë rëndësia e veçantë e projektit për ku do të mundësohet një implementim i tillë, rëndësia për komunitetin lokal, kërkesat teknike të argumentuara për nevojën për një fuqi të caktuar si dhe duke e vënë vlerën në fjalë jo si një madhësi fikse, por të shoqëruar me një luhatje të lejueshme prej $\pm 50\%$, gjithnjë në përputhje dhe me kapacitetet pranuese teknike të OSHEE.

2- Në pikën nr.3 të po këtij udhëzimi, thuhet se “*Teprica e energjisë, më e madhe se konsumi mujor, do t’i shitet*”.

Në fakt po qe se zbatohet ky udhëzim Nr. 3, ajo nuk shitet, por falet referuar pikës nr. 17 të po këtij udhëzimi. Dhe kjo jo për faj të prodhuesit të energjisë (vetëprodhuesit), por për vetë mungesat që rrjedhin nga udhëzuesi, i cili kur është formuluar nuk del të ketë marrë në konsideratë mendimin shkencor institucional. Gjithsesi kjo sqarohet më tej në pikat në vijim nr. 4 dhe nr. 8.

3 - Po në këtë pikë nr. 3 të udhëzuesit nr. 3 thuhet “pas miratimit të metodologjisë së përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike”; ku ky prodhues (vetëprodhues) shihet më shumë si konsumator dhe jo si prodhues, ndonëse flitet për çmim blerjeje prej këtij “de-facto” prodhuesi.

Për këtë ka praktika të njohura jashtë, të cilat trajtojnë me vëmendjen e duhur dhe rreziket që lidhen dhe duhet të përballohen në politikat energjetike, të çdo vendi dhe të BE-së në tërësi.

Referuar “Solar energy policy in the EU and the Member States⁽¹⁰⁾, from the perspective of the petitions received study” - EU, 2016 duke pasur në konsideratë dhe se:

a - “Rreziku i politikës në sistemet mbështetëse” mund të përkufizohet si rreziku i lidhur me një ndryshim të mundshëm në të ardhmen në politikat mbështetëse të vendosura nga administratat për të nxitur prodhimin e energjisë nga burimet e rinovueshme dhe për të kompensuar kostot e tyre më të larta të prodhimit”.

b - “Rrjeti i energjisë elektrike duhet të ndërtohet në atë mënyrë që të gjitha ngarkesat të mund të shërbehen dhe të paktën pjesa më e madhe e energjisë elektrike të gjeneruar të futet në rrjet. Kur një familje konsumon energjinë e saj të prodhuar vetë nga një impiant PV, zakonisht ka ende nevojë për energji elektrike nga rrjeti në raste të tjera. Të paktën në vendet ku konsumi i energjisë elektrike është më i lartë në mbrëmje, energjia elektrike e prodhuar vetë nuk e zvogëlon nevojën për zgjerim dhe mirëmbajtje të rrjetit”.


Me këto konsiderata dhe shumë aspekte të tjera të trajtuara në këtë dokument siç citohen në vijim:

“Vetëkonsumimi mund të jetë një mjet për të mundësuar financimin për zgjerimin e burimeve të rinovueshme dhe për të rritur pranimin për energjitë e reja. Megjithatë, përfitimet në të gjithë sistemin nga rritja e aksioneve të vetëkonsumit janë të kufizuara” [...] “Megjithatë, ka dallime midis vendeve. Ndërsa rregullorja spanjolle e bën

vetëkonsumin krejtësisht jo tërheqës, ky nuk është rasti për ligjin gjerman ose Wallon” [...] “Për sa i përket vetëkonsumimit, rekomandojmë Parlamentin që të kërkojë rregulla të qarta dhe për shmangien e ndryshimeve retroaktive në çdo sistem. Megjithatë, ne gjithashtu theksojmë nevojën për një shtrirje të rregulluar të vetëkonsumit duke pasur parasysh se energjia elektrike diellore ka arritur barazinë e rrjetit në shumë vende të BE-së dhe kostot e magazinimit të decentralizuar janë gjithashtu në rënie”.

Gjithsesi deri sa ka praktika të ngjashme për blerjen e energjisë nga prodhues të tjerë vendas, me logjikën më të thjeshtë do të mund të sugjerohej që për këtë pikë nr. 3 të udhëzuesit të hynte menjëherë në fuqi çmimi i blerjes, siç është dhe për të tjerët, së paku si fillim, ndonëse duhet thënë se këta janë “prodhues” (vetëprodhues) të vegjël dhe koston e prodhimit duhet ta kenë më të lartë teorikisht kundrejt prodhuesve të mëdhenj, ashtu siç u citua dhe më lart^(10a). Pra, indirekt s’ka se si ta kenë çmimin e blerjes më të ulët, së paku në parim.

3 - Mungesa e një harte për Shqipërinë sipas hartuesve të këtij udhëzimi nr. 3 pika nr. 6, i ka shtyrë të shkruajnë paragrafin në vijim: “Deri në miratimin e një harte të rrezatimit në varësi të pozicionit gjeografik”.



Sa i takon këtij paragrafi duhet ndalur në disa këndvështrime dhe konsiderata;

- E para, për të pasur një hartë të rrezatimit në përputhje me standardet meteorologjike të OBM do të duhej të kishte të instaluar së paku për çdo zonë dhe nën zonë klimatike të vendit nga 2 deri 3 vendmatje meteorologjike me pajisje që shërbejnë për monitorimin e treguesve të rrezatimit diellor direkt, difuz, diellëzimit, etj. Por, duke qenë se kjo nuk ekziston në ato nivele dhe nuk pritet të realizohet as në një periudhë të afërt, kryesisht nga mungesa e një mbështetje financiare për fushën e monitorimit

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

meteorologjik të territorit, ky informacion do të jetë në mungesë, ndoshta edhe për mjaft vite.

- Së dyti, edhe sikur këto pajisje të instaloheshin nesër, do të duhet referuar standardeve të OBM, që të kishte seri së paku 30 vjeçare si kohëzgjatje me të dhëna për të marrë dhe një përgjigje dhe vlerësim të saktë shkencor.

- Së treti, në këto kushte jo vetëm në Shqipëri, por dhe kudo në vende të tjera në mungesë të një informacioni të tillë të specializuar, përgjithësisht shfrytëzohen produktet satelitore si dhe ato të qendrave shkencore ndërkombëtare, të cilat mundësojnë vlerësime me një shkallë besueshmërie të pranueshme për synimin në fjalë. Gjithsesi edhe nga IGEO institucioni përkatës, ku Departamenti i Meteorologjisë ka për detyrë monitorimin meteorologjik në shkallë kombëtare publikohen herë pas here, por dhe periodikisht informacione mbi rrezatimin diellor dhe potencialin që ofron ky element klimatik për çdo muaj për Shqipërinë (Buletini Mujor Klimatik 2017÷2022) si dhe çka është më e rëndësishme të përmendet ka dhe ekspertizën e duhur shkencore për të dhënë kontributin përkatës në këtë drejtim.

- Ndërkohë dhe nga institucioni i mëparshëm që paraprin formësimin e IGEO (2021) nga IGJEUM (2012) dhe më parë tij INEUM (2008), si dhe më parë tij Instituti Hidrometeorologjik i Akademisë së Shkencave (1972); duhet thënë se janë publikuar e botuar vepra fundamentale mbi klimën e Shqipërisë siç janë “Klima e Shqipërisë” (1976) dhe “Atlasi Klimatik i Shqipërisë” (1988). Këto publikime, ndonëse botuar shumë vite më parë japin një tablo të rëndësishme të situatës dhe bazohen në seri kohore 30 a më shumë vjeçare vrojtimesh të periudhave të mëparshme, të cilat janë realizuar nga institucione që kanë paraprirë IHM siç është Shërbimi Meteorologjik në vartësi të institucioneve kryesore të vendit pas LDB, që në fakt ishte vijimësi e Shërbimit Meteorologjik të Mbretërisë Shqiptare (1928÷1939). Ndërkohë që dhe ky institucion paraprihet gjithashtu nga një sistem monitorimi meteorologjik që i shërbente aviacionit vendas dhe ndërkombëtar të inauguruar me 1 qershor 1925, pjesë e institucioneve të qeverive të para, pas Shpalljes së Pavarësisë, më 1912. Por, duhet thënë se kjo veprimtari monitorimi ka vijuar në kohë dhe më parë me vendmatjet meteorologjike të vitit 1888 në Shkodër, etj, të vendosura në qendrat kryesore të banuara të kohës në hapësirën shqiptare si dhe vlen për të përmendur atë më të parën me vrojtime meteorologjike të 2 tetorit 1886 në Durrës, që ishin pjesë të Perandorisë Osmane.

Për më tepër duhet thënë që rrezatimi diellor nuk varet nga faktorët tokësorë, por është një nga 4 faktorët kozmikë të formimit të klimës kudo në botë. Ndaj dhe ndryshimet në hapësirën e Shqipërisë janë të vogla ose të pa përfillshme pasi nga Vermoshi në Konispol kemi vetëm 3 gradë gjerësi gjeografike diferencë, ndërkohë që rolin kryesor në vlerat e RR.D., e luan orografia e vendit. Harta me treguesin e vlerave vjetore të diellëzimit, të “Atlasit Klimatik të Shqipërisë” paraqitet në figurën nr. 1.


- Përveç kësaj nga qendrat kryesore të kërkimit shkencor në Europë dhe në botë janë të publikuara dhe në mjaft raste janë “on line” hartat me tregues të ndryshëm të rrezatimit për çdo shtet, përfshi dhe Shqipërinë, siç është “SOLARGIS”. Në vijim në figurën nr. 2 paraqitet harta e rrezatimit diellor sipas këtij burimi. Një ilustrim me hartën e dhënë në figurën nr. 2 pasqyron këtë tregues. “Baza e të dhënave për vlerësimin e burimeve diellore është llogaritur nga të dhënat atmosferike dhe satelitore me një hap kohor 15-minutësh dhe 30-minutësh dhe një rezolucion hapësinor prej 1000 m, [...] dhe është përlllogaritur [...] për një periudhë të 25 viteve të fundit (1994÷2018).”⁽⁶⁾.



Figura Nr.2 – Harta e potencialit të fuqisë fotovoltaike për Shqipërinë.

Gjithashtu duhet thënë se: “Llogaritjet marrin parasysh rrezatimin diellor, temperaturën e ajrit dhe terrenin, për të simuluar konvertimin e energjisë dhe humbjet në modulet FV dhe komponentët e tjerë të një centrali të tillë FV⁽⁶⁾. Ky produkt është shumë më i vlefshëm se sa thjesht një hartë e rrezatimit diellor. Ky produkt është realizuar për shumë vende të botës nga BB në bashkëpunim me një sërë institucionesh të njohura. Harta përkatëse për Shqipërinë me një madhësi optimale dhe të shtypur në format 800x1200mm ose në versionin TIF 51.62 MB ofron një burim të rëndësishëm informacioni⁽²⁶⁾ në lidhje me këtë problematikë dhe natyrisht rezolucionin dhe besueshmërinë e duhur.

- Një burim tjetër i rëndësishëm është dhe *Atlasi Global i Rrezatimit* me mundësi dhe të dhëna mjaft të rëndësishme dhe të dobishme për vlerësimin e treguesve të rrezatimit diellor në territorin e Shqipërisë. Për ilustrim në figurën nr. 3 paraqitet një




(<https://globalsolaratlas.info/map?c=41.188989,21.077271,8&s=40.726446,19.544678&m=site>)


AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

vlerësim për një pikë të caktuar të vendit - Fier, dhe nga ku merren vlerësimet përkatëse për RR.D. direkt, të përgjithshëm, në sipërfaqe horizontale apo për këndin optimal si dhe tregues të tjerë si në vlera ditore ashtu dhe vjetore.




- Në kuadrin e projekteve të BE para pak vitesh është realizuar një projekt për vendet e Ballkanit Perëndimor (B.P.), ku me rezolucion të lartë jepen të dhëna mbi baza mujore dhe vjetore për vlerat e rrezatimit diellor sipërfaqësor, realizuar nga kompania “Sander & Partner” 2014 dhe harta për Shqipërinë paraqitet në figurën nr. 4. Për të ilustruar nivelin e lartë të rezolucionit nga ky produkt në vijim jepet një hartë për një sipërfaqe pranë Tiranës (20 x 30 km), e cila paraqitet në figurën nr. 5 ku evidentohen dhe qendrat më të vogla të banuara, ndonëse niveli i rezolucionit shkon dhe dy herë më i lartë se pamja e kësaj harte.



AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »




Bazuar në publikimin e titulluar “Wind Atlas Balkan”, i cili ka dhe një kapitull për RR.D., që me resolution: 3km ofron të dhëna për këtë tregues (rrezatimin global) dhe i referohet periudhës 1981÷2012 mund të sigurohet jo vetëm harta vjetore, por dhe ato me vlera mujore. Njësia matëse e RR.D. është dhënë në kiloWat orë për metër katror për vit [kWh/m²/vit]. Ky produkt në formën e një platforme digjitale (software 3 TB) mundëson vlerësime me rezolucion të lartë dhe besueshmërinë e duhur, jo vetëm për energjinë e erës, por dhe për RR.D., i cili në mbarim të këtij projekti është dorëzuar në ministrinë përkatëse, të çdo vendi të B.P.

Gjithashtu duhet cituar dhe një burim zyrtar i BE, i cili ka të bëjë me produktet që qendra kërkimore europiane JRC prej disa vitesh për të gjitha vendet e kontinentit tonë duke përfshirë dhe Shqipërinë ka vlerësuar mbi bazën e metodologjive shkencore treguesit e ndryshëm që kanë të bëjnë me RR.D. dhe potencialin për prodhimin E.E. Në vijim në figurën nr.6 paraqitet një nga këto harta me RR.D. global dhe potencialin për të prodhuar E.E.

- Në kontekstin kontinental Shqipëria ashtu siç tregohet dhe në figurën nr.7 bazuar në të dhënat e periudhës 1986÷2005 rezulton ndër vendet me potencial të lartë dhe mundësi të larta për përdorimin e këtij burimi alternativ energjie. Pavarësisht nga zonat ku ky potencial është më i lartë duhet thënë se gjithë vendit natyra dhe klima i ofron një RR.D., në vlera që janë më shumë se dyfishi i pjesës veriore të kontinentit, ku prej vitesh me sukses shfrytëzohet kjo lloj energjie.

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »



Natyrisht e parë dhe e gërshetuar dhe me faktorë të tjerë social ekonomik politikat e strategjisë së zhvillimit të këtij sektori mund të evidentojnë zona prioritare në aspektin e shfrytëzimit si burim energjie alternative për impiante me fuqi të lartë, por për nevoja të kufizuara të grupuara në kategorinë e vetëprodhuesve i gjithë vendi duhet të jetë një prioritet.

Këto gjashtë burime informacioni dhe vlerësimesh shkencore të ofruara me besueshmërinë e duhur plotësojnë më së miri pikërisht atë informacion të munguar që mendohet se nuk ekziston apo pritët të dalë (se nga kush e kur nuk saktësohet në udhëzuesin nr.3 datë 20.6.2019); ndonëse këto produkte kanë qenë me kohë të publikuara dhe në se nga hartuesit e udhëzimit do të ishte bërë interesimi i duhur minimalisht pranë institucioneve përkatëse shkencore të vendit (IGEO) në këtë rast, kjo mungesë do të ishte tejkaluar.

Tabela Nr.1 – Vlerat sipas stinëve të këndit optimal në gradë për panelet diellore për disa vendndodhje.

Vendi	Stina			
	Dimër	Pranverë	Verë	Vjeshtë
Vermosh	57	24	29	61
Konispol	54	21	26	58
Tiranë	56	23	27	60
New York	55	22	27	59

Tabela Nr.2 – Vlerat mujore të këndit optimal në gradë për panelet diellore për disa vendndodhje.

Vendi	Muaji											
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Vermosh	65	57	46	34	24	20	21	29	39	51	61	66
Konsipol	62	54	43	31	21	17	18	26	36	49	58	63
Tiranë	63	56	44	33	23	19	20	27	38	50	60	65
New York	63	55	44	32	22	18	19	27	38	50	59	64

5- Vlerësimi për fuqinë e prodhuar do të përllogaritet i njëjtë kudo në vend sipas këtij udhëzuesi nr. 3 pika nr. 6, ku thuhet: “kjo fuqi do të llogaritet për rrezatimin e mesatarizuar 1,400 kWh/kWp, pavarësisht faktit se në cilin rajon të Shqipërisë vendoset impianti”.

Ky paragraf ka nevojë për korrekim dhe ndryshim në se mbajmë në konsideratë të gjitha vlerësimet dhe burimet e informacionit, që janë cituar më lart në lidhje me pikën

4 të këtij artikulli, pasi hartat me rezolucion të lartë mundësojnë vlera të rrezatimit diellor për çdo skaj të vendit tonë.

6 - Sipas këtij udhëzimi nr. 3 datë 20.6.2019 pika nr. 7 zbatuesi i kësaj teknologjie duhet: “të instalojë me shpenzimet e veta një matës inteligjent me dy drejtime, sipas kërkesave të përcaktuara nga OSHEE-ja në përputhje me *Kodin e matjes*”.

Duke qenë se këta prodhues energjie referuar pikës nr. 17 të këtij udhëzuesi nr. 3; janë të detyruar që tepricën e energjisë do ta kalojnë në rrjetin kombëtar pa kundërshtpërblim, pra do ta falin, atëherë minimumi etik, por dhe nga pikëpamja ekonomike është që kjo pajisje matëse duhet të jetë detyrim i institucionit OSHEE, edhe për faktin tjetër teknik që kjo pajisje të jetë e unifikuar në mbarë sistemin e po ashtu e kontrolluar po nga ky institucion. Për më tepër po ky institucion po ashtu instalon dhe një matës tjetër me një drejtim siç thuhet në pikën nr. 7 të po këtij udhëzuesi: “vendoset një matës inteligjent me një drejtim të prodhimit pas inventarit kryesor”.

7 - Dhe së fundmi në pikën nr. 17 të këtij udhëzimi thuhet se deri sa të miratohet se si e sa do blihet energjia e prodhuar kjo nuk do shitet, por do falet: “teprica e energjisë, që tejkalon konsumin mujor, do t’i kalojë Furnizuesit të Shërbimit Universal pa kundërshtpërblim për vetëprodhuesit”.

Ky paragraf duhet i pari që të ndryshohet pasi në një ekonomi tregu nuk është normalitet që ai që investon për më tepër dhe për energjitë e rinovueshme, të penalizohet që për këtë energji që prodhon ta falë dhe mos kundërshtpërblehet. Aq më tepër kjo, për arsye që totalisht nuk lidhen me atë si prodhues, por me vetë formulimin jo të përshtatshëm të këtij udhëzuesi, i cili do të ishte dashur të kish marrë në konsideratë mendimin shkencor institucional për sa i takon hartës së RR.D. për Shqipërinë, e cila siç duket në filozofinë e hartimit të këtij udhëzuesi e çon në një zvarritje kohore pa limit, pasi siç thuhet në pikën 6 të udhëzuesit nr. 3, i mungon harta e rrezatimit (*Deri në miratimin e një harte të rrezatimit*). Ndërkohë me të drejtë lind pyetja këtë produkt që e merr falas me ç’të drejtë ligjore ky institucion (*Furnizuesi i Shërbimit Universal*) e shet në tregun e brendshëm dhe të huaj apo dhe vetë prodhuesit në një moment të caktuar.

Në lidhje me këtë çështje duhet përmendur se për kategorinë e vetëkonsumatorëve të burimeve të rinovueshme sipas “European Union (Renewable Energy) Regulations 2022” S.I. No. 76/2022 (21) referuar pikës 4/1(a) thuhet se: “Vetëkonsumatorët e burimeve të rinovueshme, individualisht ose përmes grumbulluesve - (a) mund të gjenerojnë energji të rinovueshme, duke përfshirë për konsumin e tyre, të ruajnë dhe shesin prodhimin e tepërt të energjisë elektrike të rinovueshme, duke përfshirë përmes marrëveshjeve të blerjes së energjisë elektrike, furnizuesve të energjisë elektrike dhe marrëveshjeve të tregtimit “peer-to-peer” (*Shkëmbim të energjisë me të drejta të njëjta, pa ndërmjetës të tretë*), pa iu nënshtruar:

(i) në lidhje me energjinë elektrike që ata konsumojnë nga, ose ushqehen në rrjet, me procedurat dhe tarifat diskriminuese ose joproporcionale dhe me tarifat e rrjetit që nuk reflektojnë koston, dhe

(ii) në lidhje me energjinë e tyre të rinovueshme të prodhuar vetë, e cila mbetet brenda ambienteve të tyre, me procedurat diskriminuese ose joproporcionale dhe çdo tarifë ose taksë,

(b) mund të instalojë dhe operojnë sisteme magazinimi të energjisë elektrike të kombinuara me instalime që prodhojnë energji elektrike të rinovueshme për vetëkonsum pa përgjegjësi për ndonjë tarifë të dyfishtë, duke përfshirë tarifat e rrjetit për energjinë elektrike të ruajtur që mbetet brenda ambienteve të tyre.”⁽²²⁾.

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

8. - Periudha kohore e faturimit është një element tjetër i “fshehur” i diskriminimit për grupin e vetëprodhuesve të energjisë për vetëkonsum. Sipas pikës nr. 3 të udhëzimit nr. 3 datë 20.6.2019 thuhet se “*Bilanci dhe faturimi neto, të bëhen nga OSHEE-ja në baza mujore*”, ndërkohë që po të bëheshin këto bilance në baza vjetore dhe jo mujore, atëhere nuk do të kishte marrje të energjisë pa kundërshpërblim prej kategorisë së vetëprodhuesve dhe do të ishte një bashkëpunim më korrekt dhe jo denigrues, por mjaft stimulues dhe për shumë të tjerë. Kjo situatë paradoksale “merr pa lekë në një anë” e “shit me lekë në anën tjetër” mund të ndikojë në vlerësimin e koeficientit të humbjeve në rrjet duke e përmirësuar këtë tregues artificialisht.

Gjithsesi e parë në shkallë makro ekonomike, bilanci dhe faturimi mujor si dhe respektimi i të drejtave të vetëprodhuesve duke bërë kundërshpërblimin për ata, kur kjo është e nevojshme, duke shfuqizuar pikën Nr. 17 se do merret pa kundërshpërblim; do të ishte mënyra më e mirë dhe më e drejtë e me interes të përbashkët si për politikat dhe strategjitë energjetike në shkallë vendi ashtu dhe interesat e vetëprodhuesve për organizmin e veprimtarisë dhe punës së tyre.

Këndi Optimal. Sa i takon “*këndin optimal të përthyerjes, të panelit diellor*”; të kërkuar nga VKM nr. 822, datë 7.10.2015, neni 9 pika Ç, duhet thënë se sipas platformës *Global Solar Atlas*⁽⁷⁾, ky kënd (t) figurë nr. 8(a), llogaritet të jetë për panele fikse në skajet ekstreme të vendit: Vermosh 35° dhe Konispol 33°, ndërsa në Tiranë 34° (gradë). Por, nëse kalohet në një nivel tjetër me ndryshim të këndit optimal sipas stinëve atëherë vlerat e përlogaritura sipas *software*-it “Solar Panels Optimal Tilt” do të ishin siç paraqiten në tabelën nr. 1. Natyrisht për një kënd optimal sipas muajve rendimenti i këtyre paneleve tenton edhe më tej drejt një vlere maksimale. Të dhënat për këndin e pjerrësisë maksimale sipas muajve jepen në tabelën nr. 2 në vijim për dy skajet e vendit tonë Vermosh dhe Konsipol si dhe për Tiranën dhe New York që ndodhen në gjerësi gjeografike të ngjashme; e gjithë kjo për të treguar se sa i rëndësishëm paraqitet ndryshimi i këtij treguesi me ndryshimet në gjerësi gjeografike: Vermosh – Konispol H° 3 gradë, (Vermosh ö: 42°39’30" N & ë: 19°43’39" E, ndërsa Konispol ö: 39°38’39" N & ë: 20°11’37" E) se sa në gjatësi gjeografike: Tiranë – New York H° 94 gradë, (Tirana ö: 41°19’41"N & ë: 19°49’06" E, ndërsa New York ö: 40°42’45" N & ë: 74°00’22" W). Për këtë qëllim për vendet europiane mund të konsultohet dhe platforma *on-line* “Photo-voltaic Geographical Information System”⁽¹⁷⁾.

Tabela Nr.3 – Vlerat ditore të këndit optimal në gradë për panelet diellore për Tiranën për muajin gusht.


	Muaji gusht															
Data	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	
Këndi (t)	23	24	24	24	24	25	25	25	26	26	26	26	26	27	27	
Data	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31
Këndi (t)	28	28	28	28	29	29	29	30	30	30	31	31	32	32	32	33

Ndërkohë kur synohet një rendiment më i lartë këndi optimal sigurisht ndryshon teorikisht çdo ditë dhe praktikisht do të duhej të kishte një rregullim çdo 3-4 ditë. Në vijim në tabelën nr. 3 jepen të dhënat e këtij këndi për Tiranën vetëm për muajin gusht.

Teknologjitë e reja që ofrojnë ndjekjen e lëvizjes së diellit nga lindja në perëndim vetëm në një aks për panelet konvencionale përcjellin një rritje të prodhimit të energjisë elektrike nga 25% deri në 35%⁽¹⁸⁾. Në këtë sektor janë të njohura dhe sistemet që shfrytëzojnë energjinë gravitacionale dhe nuk përdorin energjinë elektrike për të ndjekur lëvizjen e diellit në një aks⁽²⁰⁾.

Ndërkohë duhet thënë se me implementimin e teknologjive të përparuara që ndjekin

lëvizjen rrotulluese të diellit në të dy akset si në figurën nr.8(b) duke mundësuar një potencial mjaft më të lartë deri në +40%⁽¹⁸⁾ nga ai që paraqitet në hartat e mësipërme për panele diellore fikse, ndonëse të vendosura me këndin optimal; atëherë duhen parë më me kujdes vlerësimet për potencialet e mundshme që ofron klima në vendin tonë në lidhje me RR.D. dhe potencialin për E.E.



Studimet kanë treguar gjithashtu se “panelet diellore të vendosura në mënyrë optimale me kapacitet p.sh. 5 kW mund të ndihmojnë në reduktimin e emetimit të CO_2 në intervalin prej 27.55 kg në 32.8 kg në vit. Nëse ka një impiant të madh diellor PV të instaluar me kënde optimale të pjerrësisë, atëherë kursimet e kompensimit të karbonit janë shumë të mëdha, gjë që do të jetë e dobishme si nga pikëpamja ekonomike ashtu edhe nga ajo mjedisore”⁽¹⁵⁾.

Në lidhje me përmirësimet teknologjike të materialeve bazë, ku nga një koeficient konvertimi 15÷22% të energjisë që arrin nga RR.D. në E.E që është në ditët e sotme⁽¹¹⁾; po të mbahet në konsideratë se çka tentohet në qendrat shkencore më të njohura në botë ku po synohet në vlerat e 80%, atëherë është më se e qartë që këto potenciale prodhuese mund të jenë një burim i rëndësishëm energjetik gjithnjë e më shumë në të ardhmen.

Kërkimet e kryera nga Instituti Kërkimor për Energjinë Diellore në Singapor kanë nxjerrë përfundimin se “instalimet me panele diellore me dy faqe fotovoltaike dhe me ndjekjen vetëm në një aks të lëvizjes së diellit kanë shënuar një rritje të rendimentit të energjisë me 35%”⁽¹⁹⁾. Në ditët e sotme teknologjitë e fundit tregojnë se paraqiten me një efektivitet të rritur panelet që shfrytëzojnë të dy anët (figura nr. 9) dhe ndjekin lëvizjen e diellit në të dy akset, të cilët mundësojnë për po të njëjtën sipërfaqe toke të zënë, një rendimet që arrin mbi 40% më të lartë kundrejt atyre vetëm me një anë⁽¹²⁾.

Gjithashtu duhet evidentuar fakti që dhe kostot e moduleve dyfaqëshe (në \$/W) kundrejt viteve më parë tashmë janë pothuajse barazuar me ato të paneleve konvencionale⁽¹⁹⁾.



Figura Nr.9. - Panele diellore që shfrytëzojnë rrezatimin diellor në të dy anët.

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »




Figure Nr.10 – Anomalitë e mbulesës me re për vitin 2020 dhe 2021 të shprehura në [%].

Duke mbajtur parasysh dhe disa konsiderata teknike meteorologjike këto sisteme që shfrytëzojnë të dy anët e tyre e përmirësojnë më tej performancën, në se synohet të rritet albedo e sipërfaqes së tokës pranë vendosjes së paneleve. Kjo ndihmon në rritjen e rrezatimit difuz, i cili mund të sigurohet si në rastin kur përzgjidhen toka me ngjyrë të hapur, ranore, etj, apo kur sipërfaqja e tokës shtrohet me materiale me ngjyrë të hapur si gurë (çakëll i bardhë) ashtu dhe kur kjo gjë sigurohet nga natyra me shtresën e dëborës në periudha të caktuara të vitit.

Ndryshimet klimatike. Disa konsiderata të tjera mbi perspektivën e këtij sektori në vendin tonë lidhen jo vetëm me potencialin që ofron klima e vendit tonë, por dhe se si shihet perspektiva në këtë fushë. Në kontekstin e ndryshimeve klimatike si pasojë e faktit që është shënuar një zvogëlim në mbulesën me re dhe një numër ditësh me vranësira më i ulët kundrejt normës, ku natyrisht kjo dukuri është shënuar në një hapësirë mjaft më të madhe se vendi ynë ilustruar me pamjet e vitit 2020 dhe 2021 (EUMETSAT) në figurën nr. 10; duhet thënë se sa i takon treguesit të RR.D., vlerat e tij (orëve me diell) për territorin e Shqipërisë në vitet e fundit kanë shënuar në mbarë vendin një rritje të lehtë me $+5\% \div +10\%$ (figurë nr. 11), duke e evidentuar si një aspekt me ndikim pozitiv të këtyre ndryshimeve mbi hapësirën e vendit tonë, si dhe duke mundësuar një potencial relativisht më të lartë të E.E⁽⁵⁾.

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »




Figure Nr.11 – Anomalitë e diellëzimit për vitin 2020 dhe 2021 të shprehura në [orë]

Duke pasur në konsideratë se çfarë ndodh në vendet e përparuara në lidhje me politikat për energjitë e rinovueshme siç citohet dhe në materialin “U.S. Laws and Regulations for Renewable Energy Grid’ Interconnections”: “Rënia e shpejtë e kostove të teknologjive të energjisë së erës dhe diellit, shqetësimet në rritje në lidhje me ndikimet mjedisore dhe ndryshimet klimatike të lëndëve djegëse fosile, dhe investimet e qëndrueshme në projektet e energjisë së rinovueshme, të gjitha tregojnë për një të ardhme jo shumë të largët në të cilën energjia e rinovueshme luan një rol kryesor në sistemi i energjisë elektrike të shekullit të 21-të”⁽¹³⁾ këto tendenca të së ardhmes duhet të paraprihen dhe nga ana ligjore në mënyrë sa më të përshtatshme dhe lehtësuese. Po në këtë dokument⁽¹³⁾ ku thuhet se: “Ligjet dhe rregulloret [...] mund të shërbejnë si shembuj ilustrues për rregullatorët dhe pushtetin, praktikuesit e sistemit që kërkojnë të përditësojnë politikat dhe procedurat e ndërlidhjes për të mundësuar rritjen e energjisë së rinovueshme, përfshirë burimet e rinovueshme të ndryshueshme si era dhe dielli, në sistemin e energjisë elektrike”; do të duhet që dhe hartuesit e ligjeve dhe rregulloreve në këtë sektor në vendin tonë të mbajnë në konsideratë dhe përfundimet dhe sugjerimet e këtij studimi, me qëllim për të përmirësuar dhe lehtësuar sadopak situatën energjetike në vend.

Duke pasur në konsideratë sa më sipër u argumentua mbi hartën e rrezatimit diellor për Shqipërinë dhe burimet e tjera shkencore të informacionit, prirjet klimatike në këndvështrimin e ndryshimeve klimatike dhe potencialin e pritshëm për RR.D.; përmirësimet teknologjike, etj, trajtimet ligjore në vendet e tjera si dhe argumentimet përkatëse mund të nxirren dhe përmbledhen disa përfundime dhe sugjerime që të mundësojnë sa më shpejt përmirësimin e kësaj baze ligjore.

4. Përfundime

1- Mbajtja në konsideratë parësore e marrjes së mendimit shkencor institucional duhet të jetë gjëja më e rëndësishme në përmirësimin e legjislacionit në këtë drejtim, në se do të kërkohej që vërtet ky burim energjie alternative të rinovueshme të shfrytëzohet me sukses.

2- Shfrytëzimi i hartave të sugjeruara në këtë artikull dhe burimeve përkatëse të tyre mundëson me një rezolucion të lartë hapësinor jo vetëm vlerësimin e RR.D. për çdo skaj të vendit, por dhe informacione të tjera me rëndësi profesionale.

3- E.E. e prodhuar të blihet dhe mos të falet, duke përmirësuar tekstin e udhëzimit nr. 3 datë 20.6.2019 si dhe mënjanoj ato paragrafë që e kufizojnë një gjë të tillë.

4- Matësit me dy drejtime ashtu si ato me një drejtim duhet të jenë pjesë e punës si për sa i takon zgjedhjes së tyre, instalimit, kontrollit e po ashtu dhe kostove të tyre duhet të mbulohen nga institucioni i Furnizuesit të Shërbimit Universal.

5- Zona në pjesën jugore të Ultësirës Perëndimore, me toka të kripura apo degraduara⁽²²⁾ dhe jo me interes bujqësor, larg vijës bregdetare dhe jo me interes turistik, larg qendrave arkeologjike dhe atyre të burimeve të naftës e gazit, duhet të jenë prioritet në shkallë vendi për implementimin e teknologjive të konvertimit të RR.D. në E.E, për shkak të potencialit më të lartë që arrihet në këto hapësira, ndërkohë që për vetëplotësim nevojash për energji elektrike shfrytëzimi i RR.D duhet të jetë prioritet në mbarë vendin.

6- Duke qenë se kostot e sistemeve të paneleve që shfrytëzojnë në të dy anët RR.D. janë të ngjashme me ato konvencionale dhe mundësojnë një rendiment jo vetëm më të lartë, por dhe kursim të sipërfaqes së tokës së zënë (e blerë ose me qira) që gjithashtu

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

është një kosto në vetvete, do të ishte shumë e këshillueshme që teknologji të tilla të kishin prioritet për vendin tonë me një sipërfaqe toke bujqësore të kufizuar.

7- Eksperiencat ligjore të vendeve të tjera duhen marrë në konsideratë, por duke pasur paratë parasysh dhe problematikat që ato kanë përcjellë në vendet përkatëse duhet operuar me kujdesin e duhur dhe mënjeluar mangësitë e vërejtura.

8- Sa më i madh të jetë numri i “operatorëve” vetë prodhues për vet konsum aq më i vogël do të ishte dëmi në shkallë kombëtare ose rajonale; nëse sistemet kombëtare të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë si për shkaqe natyrore ose arsyesh që mund të lidhen me sulme kibernetike, të modifikimit të motit, etj., etj, do të ishin jofunksionale pjesërisht ose tërësisht në një kohë dhe për një hapësirë territoriale të caktuar.

5. Sugjerime

1- Paragrafë të caktuar në udhëzuesin nr.3 datë 20.6.2019, si ai: “Për miratimin e procedurës së lehtësuar të autorizimit për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të projekteve të vogla të rinovueshme për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga dielli”, duhet të kenë një shprehje gjuhësore më korrekte në gjuhën shqipe në lidhje me mendimin që synon të përcjellë. Në këtë rast paragrafi në fjalë duhet të shprehet si vijon: “Për miratimin e procedurës së lehtësuar të autorizimit për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të projekteve të vogla të energjive të rinovueshme për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga rrezatimi diellor”.

2- Ndërkohë një unifikim në termat e përdorur në përputhje me IS do të duhet të ketë midis njësive matëse të shprehura në VKM nr. 822, datë 7.10.2015, neni 9 pika Ç ku thuhet “rrezatimin diellor mesatar vjetor, të vendit ku do të ndërtohet sistemi, [k]/m² në vit” dhe pikës 6 të udhëzimit nr. 3, datë 20.6.2019 ku thuhet “kjo fuqi do të llogaritet për rrezatimin e mesatarizuar 1,400 kWh/kWp”^(1,2).

3- Në paragrafët e pikës nr. 6 dhe nr. 7 e nr.7 D të udhëzimit nr. 3, datë 20.6.2019 citohet shprehja “impianetet PV”, e cila duhet shqipëruar më mirë nga anglishtja “photo-voltaic” dhe mos huazohej në mënyrë jo korrekte (pajisjet fotovoltaike - FV).

4- Nga legjislacioni i vendeve të BE vlen të mbahet në konsideratë një kufizim që ka të bëjë me zënien e tokës bujqësore, siç është ai i dekret-ligjit të datës 1 mars 2022 nr.17 në Itali që e kufizon zënien e tokës bujqësore deri në jo më shumë se 10% të sipërfaqes së fermave (ndërmarrjeve) bujqësore⁽¹⁶⁾, apo lejime siç është rasti i ligjit “Loi Climat et Résilience & photovoltaïque” të datës 21 gusht 2021, pika 3 në Francë ku sipërfaqet e parkimeve mund të mbulohen deri në 100% me panele diellore⁽²⁴⁾, etj.

5- Çmimi i blerjes së energjisë nga ky grup i emërtuar “vetëprodhues energjie” të jetë sa është çmimi i blerjes nga prodhuesit e mëdhenj, ndonëse kjo nuk është favorizuese në momentin e parë, por së paku jo të merret falas; deri në atë moment kur të miratohet një vlerë e arsyetuar dhe e bazuar në mendimin ekonomik dhe kostot përkatëse.

Bibliografia

1. “VKM - Vendim Nr.822, datë 7.10.2015 Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”. (ndryshuar me VKM nr.718, datë12.10.2016, nr.633, datë 27.10.2021) (i përditësuar). Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë. Tiranë – 14 Tetor 2015 Nr. 177 (f.12060) si dhe Fletore Zyrtare Nr:168 Tiranë, 29/10/2021.
2. “Udhëzim Nr. 3, datë 20.6.2019. Për miratimin e procedurës së lehtësuar të autorizimit për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të projekteve të vogla të rinovueshme për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga dielli”. Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë. Tiranë – 17 korrik 2019 Nr. 103 (f.7558).
3. “Klima e Shqipërisë”, ASH – IHM, Tiranë, 1976.

4. "Atlasi Klimatik i Shqipërisë", ASH – IHM, Tiranë, 1988.
5. "Buletini Mijor Klimatik / Monthly Climate Bulletin" 2017~2022, ISSN: 2521-831X, IGE0, UPT, Tiranë, Albania.
6. "Photovoltaic Electricity Potential" (<https://solargis.com/maps-and-gis-data/download/albania>)
7. "Global Solar Atlas" (<https://globalsolaratlas.info>)
8. "Pvgis-photovoltaic-geographical-information-system" (https://joint-research-centre.ec.europa.eu/pvgis-photovoltaic-geographical-information-system/getting-started-pvgis/pvgis-data-sources-calculation-methods_en#ref-5-calculation-of-pv-power-output)
9. "Wind Balkan Atlas" - 2014 (www.SANDER-PARTNER.com)
10. "Solar energy policy in the EU and the Member States, from the perspective of the petitions received study". EU, 2016.
11. "The effect of environmental changes on the efficiency of the PV system" - Adeel S., etc. - Indonesian Journal of Electrical Engineering and Computer Science; Vol. 18, No. 1, 2020, pp. 558~564 ISSN: 2502-4752.
12. "Motorless Solar Tracking System", Prabhakar R. Holambe, etc., Electrical Engineering Dept., College Of Engineering Pune, International Conference on Energy Systems and Applications (ICESA 2015) Dr. D. Y. Patil Institute of Engineering and Technology, Pune, India, 2015. (<https://www.researchgate.net/publication/306370591>)
13. "U.S. Laws and Regulations for Renewable Energy Grid Interconnections", Ilya Chernyakhovskiy, Tian Tian, Joyce McLaren, Mackay Miller, and Nina Geller National Renewable Energy Laboratory, Technical Report NREL/TP-6A20-66724 September 2016, USA. <https://www.nrel.gov/docs/fy16osti/66724.pdf>
14. "Economic Analysis of Grid-Connected PV System Regulations: A Hungarian Case", Study Henrik Zsiborács, etc. 2019. (<https://www.mdpi.com/2079-9292/8/2/149/htm>)
15. "Optimal Tilt Angle Determination for PV Panels Using Real Time Data Acquisition" Manoj Kumar Sharma, etc., 2020. (<https://onlinelibrary.wiley.com/doi/epdf/10.1002/gch2.201900109>)
16. "Misure urgenti per il contenimento dei costi dell'energia elettrica e del gas naturale, per lo sviluppo delle energie rinnovabili e per il rilancio delle politiche industriali". Art.Nr.1. - GU n.50 del 1-3-2022, Decreto-Legge 1 marzo 2022, n. 17.
17. "An approach for the estimation of the aggregated photovoltaic power generated in several European countries from meteorological data" May 2018, https://re.jrc.ec.europa.eu/pvg_tools/en/
18. "What is a solar tracker and is it worth the investment?" March 2022, (<https://www.solarreviews.com/blog/are-solar-axis-trackers-worth-the-additional-investment>)
19. "Bifacial Solar Panel Double Sided Solar Panels" June 2021, (<https://couleenergy.net/bifacial-solar-panel-double-sided-solar-panels/>)
20. "Double-Sided Solar Panels That Track The Sun Could Produce 35% More Energy" June 2020, (<https://www.forbes.com/sites/scottsnowden/2020/06/29/double-sided-solar-panels-that-track-the-sun-could-produce-35-more-energy/?sh=276c36ce1fc4>)
21. "European Union (Renewable Energy) Regulations 2022" S.I. No. 76/2022 - <https://www.irishstatutebook.ie/eli/2022/si/76/made/en/print>
22. "Permettre l'implantation de panneaux photovoltaïques sur des sites dégradés", 8.09.2022, Senati Francez, http://www.senat.fr/espace_presse/actualites/202202/
23. "Landmark EU Solar Strategy: SolarPower Europe Response", May 18, 2022, EU, <https://www.solarpowereurope.org/press-releases/landmark-eu-solar-strategy-solar-power-europe-response>
24. "Loi Climat et Résilience" publiée au Journal officiel le 24 Août 2021. Loi Climat et Résilience & photovoltaïque : la réglementation en 3 points. <https://terresolaire.com/Blog/reglementation-solaire/loi-climat-et-resilience-photovoltaique/>
25. "EU DIRECTIVES, NATIONAL REGULATIONS AND INCENTIVES FOR PHOTOVOLTAIC SOLAR ENERGY" - A. Jäger-Waldau, etj., Ispra, Italy; *European Commission, DG TREN, 1049 Brussels, Belgium - 19th European Photovoltaic Solar Energy Conference and Exhibition, Paris 2004. <https://www.researchgate.net/publication/264052713>
26. "Renewable Energy in Albania" National Agency of Natural Resources, A. Leskoviku, Head of RES, Workshop: "Renewable Energy UNDA project conclusions and way forward", 13-14 December 2017, Lancaster Plaza Hotel, Raouche Beirut, Lebanon.

Shkurtime dhe akronime:

- BB – Banka Botërore
- BE – Bashkimi Europian
- B.P. – Ballkani Perëndimor
- E.E. – Energji Elektrike
- E.R. – Energji të Rinovueshme
- EUMETSAT - The European Organization for the Exploitation of Meteorological Satellites
- FV (PV) – fotovoltaiik
- IS – International Standard
- JRC – Joint Research Center
- OBM – Organizata Botërore e Meteorologjisë
- RR.D. – Rrezatimi Diellor
- VKM – Vendim i Këshillit të Ministrave

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

Siguria në komunitet, me fokus të veçantë, ndikimin e pandemisë COVID 19, në Kosovë



■MSc. Daut ZENELI

Instituti kërkimor për Siguri Publike
në Kosovë.

E-mail daut.zeneli@gmail.com

Abstrakt

Sikurse e gjithë bota e cila u ballafaqua me një fenomen i cili ishte një kërcënim jashtëzakonisht i madh për jetën e njeriut, pra e kemi fjalën për pandeminë COVID 19, edhe Kosova nuk mbeti pa u përfshirë nga ky fenomen dhe madje edhe me pasoja mjaft serioze.

Shfaqja e rasteve të para me COVID 19, ishte mjaft shqetësuese pasi ne ishim të vetëdijshëm për sistemin tonë shëndetësorë dhe gjithashtu për kapacitetet tona, si në aspektin e infrastrukturës shëndetësorë, po ashtu edhe në aspektin profesional. Një tjetër shqetësim ishte edhe zhvillimi ekonomik duke pasur parasysh që kemi një përqindje mjaft të madhe të popullsisë të cilët kanë një ekonomi mjaft të ultë dhe nga ana e kundërt kostoja e përballimit të trajtimit të personave me COVID 19 ishte mjaft e lartë.

Si rezultat i kësaj, në Kosovë prej shfaqjes së pandemisë janë marrë një sërë masash në kuadër të përpjekjeve për një menaxhim të mirëfilltë të saj. Janë nxjerr politika dhe strategji të ndryshme të cilat në forma të ndryshme kanë ndikuar në menaxhimin e pandemisë, por të njëjtat nganjëherë kanë shfaqur ndikim negativ në mirëqenien, por edhe në sigurinë e qytetarëve. Gjithashtu janë marrë edhe vendime të cilat kishin efektin e tyre në parandalimin e rritjes së numrit të së infektuarve, por që në anën tjetër ato nganjëherë edhe vështirësonin jetën e qytetarëve.

Duke u bazuar në të gjitha këto të dhëna dhe ngjarje të cilat ndodhen qysh nga fillimi i pandemisë, në këtë punim do të mundohem të analizoj ndikimin e pandemisë në sigurinë në komunitet, ku do të mundohem të interpretoj në formë analitike rezultatet e një hulumtimi i cili është realizuar në vitin 2020, pra në fillim të pandemisë, dhe gjithashtu, do të mundohem të analizoj politikat e ndryshme, si dhe Strategjinë shtetërore për parandalim, menaxhim dhe kontrollim të pandemisë COVID-19.

Fjalëkyçe:

COVID 19, Kosova, siguria, menaxhimi, politikat.

1. Hyrje

Fillimi i vitit 2020 ishte një fillim jo i zakonshëm sikurse vitet e tjera, do e kujtojmë si vit nga i cili bota ishte para një kërcënimi shumë të madh epidemiologjike. Shfaqja e rasteve të para me një sëmundje të panjohur në Republikën Popullore të Kinës dhe pastaj konfirmimi në një pandemi globale ishte një shqetësim për gjithë globin. Në këtë kuadër ky shqetësim nuk na kursente as neve, pasi as ne nuk mund të ishim imunë ndaj këtij kërcënimi i cili po i kanosej gjithë botës. Duke qenë se jemi një shtet mjaft i ri dhe në fazën e transicionit është e natyrshme që kjo do të ishte një shqetësim shtesë, pasi ne i njohim kapacitetet tona ligjore, humane dhe infrastrukturore për t'u përballë me një kërcënim të këtij lloji, i cili tashmë po sfidonte edhe shtetet me një konsolidim dhe ekonomi mjaft të zhvilluar. Pastaj, duke i parë pasojat të cilat i krijonte kjo situatë ishim mjaft skeptikë se mund t'ia dilnim të përballeshim me këtë pandemi.

Fakti që ne kishim një brishtësi në institucione tona të cilat tashmë ishin në fazën e ndërtimit dhe afirmimit të tyre, mungesa e përvojave me situata të tilla e nganjëherë edhe mungesa e kadrove profesionale, e bënte edhe më sfidauese përballjen me Covid 19. Ne ishim në një pozitë të vështirë pasi ishte një situatë ku duhet të veprohej shpejt në këtë përballje. Mirëpo përkundër këtij niveli të institucioneve ne kishim arritur të përballeshim me situatën e krijuar edhe pse me disa vështirësi dhe sfida.

Institucionet tona kishin ndërmarr masat e nevojshme në baze të atyre kapaciteteve të cilat ata i posedonin dhe fal ndihmesës se partnerëve strategjik, Kosova ia kishte dalë të përballej me fluksin e të infektuarve edhe pse me vështirësi. Institucionet shëndetësore ishin mobilizuar dhe po e bënë punën e vet me shumë përgjegjësi të lartë, madje kjo shpërfaqje e përgjegjësisë shkonte edhe deri tek niveli vetëmohues. Në këtë kuadër edhe institucionet tjera të cilat në një mënyrë apo në një tjetër ishin në krye të detyrës.

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

Institucionet e nivelit qendror ishin mobilizuar dhe punon në funksion të ndërmarrjes së masave adekuate për një parandalim dhe menaxhim sa më të mirë të situatës së krijuar nga pandemia Covid 19. Për një përballje të suksesshme me pandeminë, qeveria kishte marr masa të ndryshme nga masat ekonomike deri tek kufizimi e disa të drejtave, si kufizimi i lirisë së lëvizjes etj. Këto masa nuk ishin gjithëherë të pëlqyera nga qytetaret mirëpo kjo ishte forma më e mirë për ta kontrolluar infeksionin.

Menaxhimi i pandemisë Covid 19 ishte vërtet një sfidë e madhe për institucionet, në të gjitha nivelet; kjo situatë e shpërfaqti gjendjen tonë reale për sa i përket kapaciteteve, dhe nxori në sipërfaqe mangësitë tona. Ky ishte një mësim jashtëzakonisht i mirë për ne, në mënyrë që në të ardhmen të jemi më të përgatitur dhe të punojmë gjithmonë për ngritjen e kapaciteteve tona e t'i afirmojmë ato gjatë gjithë kohës.

2. Një historik i shkurtër i pandemisë Covid 19

Më 31 dhjetor 2019, Republika Popullore e Kinës njoftoi një grup rastesh të pneumonisë me shkak të panjohur e cila u paraqit për herë të parë në qytetin Wuhan të provincës Hubei të Kinës. Nga data 31 dhjetor 2019 deri me 3 janar 2020 ishin raportuar në OBSH dyzet e katër (44) raste me këtë pneumoni.¹

Ndërsa më vonë më 9 janar 2020 nga Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve u identifikua si një korona virus i ri.²

Më 30 janar 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) shpalli shpërthimin e një emergjence të shëndetit publik që ishte e shqetësimit ndërkombëtar.³ Dhe pastaj disa ditë më vonë, respektivisht me 11 shkurt 2020, OBSH e quajti sëmundjen “COVID-19” si shkurtes e “sëmundja korona virus 2019”.⁴ Kjo sëmundje vazhdoi të studiohet nga shumë organizata profesionale madje edhe u quajt me emra të ndryshëm si “severe acute respiratory syndrome coronavirus 2 (SARS-CoV-2)” pasi që kishte ngjashmëri gjenetike me koronavirusin SARS të vitit 2003, mirëpo edhe pse kishte ngjashmëri ishin dy viruse të ndryshme.⁵ Kjo situatë vazhdoi deri sa përfundimisht iu dha një drejtim kësaj sëmundje të pa njohur. Ndërkaq më 11 mars 2020 gjatë një konference Drejtori gjeneral i OBSH-së tha se duke pasur parasysh që në këtë moment kemi 118 000 raste me të infektuar në 114 shtete si dhe 4 291 humbje jetësh, kjo sëmundje mund të karakterizohet si Pandemi Globale.^{6,7}

¹ Uebi i Organizatës Botërore e Shëndetësisë, Novel Coronavirus (2019-nCoV) Situation report - 1. Marrë nga https://www.who.int/docs/default-source/coronaviruse/situation-reports/20200121-sitrep-1-2019-ncov.pdf?sfvrsn=20a99c10_4

² Uebi Reliefweb. Marrë nga https://reliefweb.int/report/world/epidemiological-update-coronavirus-disease-covid-19-15-october-2020?gclid=Cj0KCQjwkOqZBhDNARIsAACsbfKxcifZAb2sE7_RcCZgTOujf7MvX55hyjhjMS3n3FNUTSYsMeBeDTcaAnYFEALw_wcB

³ Uebi i Organizatës Botërore e Shëndetësisë, Novel Coronavirus (2019-nCoV) Situation Report - 11. Marrë nga https://www.who.int/docs/default-source/coronaviruse/situation-reports/20200131-sitrep-11-ncov.pdf?sfvrsn=de7c0f7_4

⁴ Uebi i Organizatës Botërore e Shëndetësisë, Novel Coronavirus (2019-nCoV) Situation Report - 22. Marrë nga https://www.who.int/docs/default-source/coronaviruse/situation-reports/20200211-sitrep-22-ncov.pdf?sfvrsn=fb6d49b1_2

⁵ Uebi i Organizatës Botërore e Shëndetësisë. Marrë nga [https://www.who.int/emergencies/diseases/novel-coronavirus-2019/technical-guidance/naming-the-coronavirus-disease-\(covid-2019\)-and-the-virus-that-causes-it](https://www.who.int/emergencies/diseases/novel-coronavirus-2019/technical-guidance/naming-the-coronavirus-disease-(covid-2019)-and-the-virus-that-causes-it)

⁶ Uebi i Organizatës Botërore e Shëndetësisë. Marrë nga <https://www.who.int/director-general/speeches/detail/who-director-general-s-opening-remarks-at-the-media-briefing-on-covid-19-11-march-2020>

⁷ Uebi i Organizatës Botërore e Shëndetësisë, Novel Coronavirus (2019-nCoV) Situation report - 51. Marrë nga https://www.who.int/docs/default-source/coronaviruse/situation-reports/20200311-sitrep-51-covid-19.pdf?sfvrsn=1ba62e57_10

Më 9 korrik 2020, drejtori i përgjithshëm i OBSH-së njoftoi fillimin e Panelit të Pavarur për Përgatitjen Pandemike dhe Reagimi (IPPR), i cili do të vlerësonte në mënyrë të pavarur dhe gjithëpërfshirëse mësimet e nxjerra nga reagimi ndërkombëtar shëndetësor ndaj COVID-19.⁸

Diku nga fundi i janarit 2020, përveç rasteve me Covid 19, në Republikën Popullore të Kinës dhe rajonet përreth, nisi shfaqja e rasteve të para edhe në Evropë; këto ishin shenjat e para se Evropa tashmë ishte futur në zonën e kërcënuar nga ky virus.⁹ Rastet e para të konfirmuara në Evropë ishin raportuar me 24 janar 2020, në Francë dhe kjo në fakt shënon datën e konfirmimit të rasteve të para; më 15 shkurt 2020 shënohet edhe viktima e parë, po ashtu në Francë.¹⁰ Duke qenë se Evropa tashmë po përballej me fluksin e të infektuarve, po ashtu edhe në disa vende të rajonit, në Kosovë ende nuk kishim të konfirmuar ndonjë rast me Covid 19. Mirëpo përkundër disa masave të cilat i ndërmori shteti për ta parandaluar përhapjen e korona virusit, lëvizjet e shumta të qytetarëve jashtë Kosovës bëri që edhe në vendin tonë të shfaqeshin rastet e para.

Kjo ndodhi më 13 mars 2020 ku dy raste me virusin Covid-19 u konfirmuan edhe në Kosovë dhe kjo u bë e ditur në një konferencë të jashtëzakonshme nga ministri i shëndetësisë, Arben Vitia. Të prekurit nga Covid-19 janë “një 20vjeçare, shtetase italiane dhe një shtetas i Kosovës i moshës 77 vjeçare”.¹¹ Me shfaqjen e këtyre dy rasteve Kosova u fut në hartën e vendeve të cilat tashmë kishin shënuar rastet e para. Ndërsa Kosova po përjetonte këtë situatë të shfaqjes se rasteve të para, disa vende të Evropës tashmë po përballeshin me një fluks të madh të së infektuarve ku disa prej tyre si: Italia, Spanja, Franca dhe Gjermania tashmë kishin arritur numrin e të infektuarve mbi katër (4) shifror, si dhe kishin shënuar edhe viktima, ku numri i tyre ishte tashmë nga një (1) deri në katër (4) shifror.¹² Duke qenë se ishin konfirmuar rastet e para dhe gjithashtu nëpër klinikat tona ishin shtruar pacient të cilët po trajtoheshin me Covid 19, më 22 mars 2020 kemi edhe rastin e parë të vdekjes si pasojë e Korona virusit: një 82-vjeçar nga Dumnica e Podujevës.¹³

3. Politikat, strategjitë dhe legjislacioni në funksion të menaxhimit të Covid 19

Pas shfaqjes së rasteve të para me Covid 19, edhe Kosova me ato kapacitete që kishte filloi ndërmarrjen e masave të nevojshme për t'u përballur me pandeminë. Ajo që duhej bërë e para, ishte domosdoshmëria e nxjerrjes së vendime legale të bazuara te legjislacioni në fuqi. Kosova si një shtet i ri qysh në fillimet e tij kishte nxjerrë ligje, duke

⁸ Uebi i Reliefweb. Marrë nga https://reliefweb.int/report/world/epidemiological-update-coronavirus-disease-covid-19-15-october-2020?gclid=Cj0KCQjwk0qZBhDNaRIsAACsbFkXciFzAb2sE7_RcCZgTOujf7MvX55hyjhjMS3n3FNUTSsMeBeDTcaAnYFEALw_wcB

⁹ Uebi i Organizatës Botërore e Shëndetësisë, Novel Coronavirus(2019-nCoV) Situation Report - 10. Marrë nga https://www.who.int/docs/default-source/coronaviruse/situation-reports/20200130-sitrep-10-ncov.pdf?sfvrsn=d0b2e480_2

¹⁰ Uebi i Eurosurveillance, First cases of coronavirus disease 2019 (COVID-19) in the WHO European Region. Marrë nga <https://www.eurosurveillance.org/content/10.2807/1560-7917.ES.2020.25.9.2000178>

¹¹ Uebi i Deutsche Welle, Marrë nga <https://www.dw.com/sq/kosov%C3%AB-konfirmohen-dy-rastet-e-para-me-virusin-corona/a-52769039>

¹² Uebi i Organizatës Botërore e Shëndetësisë, Coronavirus disease 2019 (COVID-19) Situation Report - 53. Marrë nga https://www.who.int/docs/default-source/coronaviruse/situation-reports/20200313-sitrep-53-covid-19.pdf?sfvrsn=adb3f72_2

¹³ Uebi i Anadolu Agency (AA). Marrë nga <https://www.aa.com.tr/sq/balkani/sh%C3%ABnohet-vdekja-e-par%C3%AB-nga-koronavirusi-n%C3%AB-kosov%C3%AB/1774826>

marrë shembull nga praktikat më të mira të shteteve me demokraci dhe funksionalitet të mirëfilltë të tyre; dhe si rezultat i kësaj, në vitin 2008 kishte miratuar ligjin nr. 02/L-109 “Për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse”.¹⁴ Ekzistenca e këtij ligji përbënte një bazë mjaft të fuqishme ligjore në funksion të veprimit edhe ndaj Covid 19. Në këtë ligj janë të paraqitura një mori përkufizimesh, për sa i përket sëmundjeve ngjitëse, pastaj janë të vendosura masat për parandalim dhe luftim të sëmundjeve ngjitëse duke përfshirë masat e përgjithshme dhe masat e veçanta, mënyrat e dezinfektimit të hapësirave ku dyshohet se mund të jetë infeksioni, mënyrat e karantinimit dhe shumë udhëzime të tjera.¹⁵

Përveç Ligjit të lartë përmendur i cili ka një role të jashtëzakonshëm, Kosova ka edhe ligjin nr. 04/-L-027 “Për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera”, i cili përbën një bazë të fuqishme ligjore e cila e mundëson marrjen e masave për t’u përballur me fatkeqësi natyrore.¹⁶ Në këtë ligj janë të parapara përgjegjësit sipas nivele të ndryshme, pastaj janë të përcaktuara roli dhe përgjegjësit e institucioneve, gjithashtu në bazë të këtij ligji janë të parapara edhe të drejtat dhe detyrimet e qytetareve gjatë përpalljes me ndonjë fatkeqësi natyrore.¹⁷

Si derivat apo një dokument i detajuar nga ligji i lartë përmendur është edhe *Plani i reagimit kombëtar*, i cili ofron një kornizë të detajuar duke përmbajtur një sërë planesh dhe procedurash për reagimin ndaj ndonjë fatkeqësie natyrore. Në këtë dokument janë të parapara në mënyrë të detajuar përgjegjësitë dhe roli i të gjitha institucioneve të cilat duhet të përfshihen në rast të ndonjë fatkeqësie natyrore. Janë të përcaktuara se cilët janë reaguesit e parë në rast të paraqitjes së ndonjë fatkeqësie. Pra, janë për parapara një sërë veprimesh operative të cilat janë një udhërrëfyes i qartë se si të veprohet si kundërpërgjigje ndaj një situatë të caktuar.¹⁸

Menjëherë pas paraqitjes së rasteve të para, duke marrë praktika prej vendeve që tashmë po përballeshin me këtë sëmundje, institucionet e Kosovës filluan të nxjerrin fillimisht disa vendime, me anën e të cilave kufizohej lëvizja e njerëzve dhe automjeteve në ato zona ku tashmë ishin konfirmuar rastet me Covid 19.¹⁹

Duke parë një rritje të vazhdueshme të rasteve gjithandej nëpër botë, por edhe brenda territorit të Kosovës dhe duke parë nevojën që të nxjerrën politika konkrete të cilat do të ndihmonin në funksion të parandalimit dhe menaxhimit sa më të mirë të pandemisë, në qershor të vitit 2020 u nxor një manual i cili jepte udhëzime të qarta se si të mbroheshim nga pandemia Covid 19. Në këtë manual ishin të përfshira udhëzime të ndryshme duke filluar nga simptomat, pastaj mënyrat e përhapjes së këtij infeksioni, ishin të parapara masat që duhet të ndërmerreshin në punë në mënyrë që mos të përhapet infeksioni si dhe shumë e shumë udhëzime të tjera.²⁰

Për ta plotësuar infrastrukturën ligjore në interes të menaxhimit të situatës së krijuar nga pandemia, me 14 gusht 2020 në Kuvendin e Republikës së Kosovës u miratua një

¹⁴ Uebi i Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës. Marr nga <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2587>

¹⁵ Ligji Nr. 02/L-109 Për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse

¹⁶ Ligji Nr. 04/-L-027 Për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera

¹⁷ Po aty

¹⁸ Plani i Reagimit Kombëtar

¹⁹ Uebi i Ministrisë së Shëndetësisë së Kosovës. Marr nga <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2020/04/Vendim.pdf>

²⁰ Uebi i Ministrisë së Shëndetësisë së Kosovës, Manual për mbrojtje nga përhapja e virusit covid-19. Marr nga <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2020/06/Manual-p-C3%AABr-parandalimin-dhe-luftimin-e-COVID19.pdf>

ligj i veçantë i cili rregullonte dispozitat rreth parandalimit dhe luftimit të pandemisë Covid 19 dhe kemi të bëjmë me ligjin nr. 07/L-006 “Për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19” në territorin e Republikës së Kosovës.²¹ Ky ligj tashmë kishte vënë një baze mbi të cilën mund të merreshin masa në funksion të përpalljes me pandeminë. Ligji jepte përkufizim të qartë në lidhje me Covid 19, ku në nenin 3, pika 1.1 të këtij ligji jepet përkufizimi se çfarë është COVID-10 “1.1. COVID-19 - nënkupton emërtimin për sëmundjen CO-korona, VI-virusi, D-sëmundja dhe 19- viti i shfaqjes së sëmundjes 2019”²²

Edhe pse me ekzistencë të një infrastrukture ligjore mjaft të mirë, ndihej nevoja për një dokument strategjik i cili do t'i jepte një drejtim të qartë rrugës për përballje dhe menaxhim sa më të mirë të pandemisë Covid 19; kjo në fakt u realizua në dhjetor të vitit 2021, kur nga qeveria e Republikës së Kosovës u aprovua “Strategjia shtetërore për parandalim, menaxhim dhe kontrollim të pandemisë COVID-19”.²³ Në këtë dokument janë paraqitur një sërë direktivash dhe planesh, që të gjitha në funksion të parandalimit dhe menaxhimit sa më të suksesshëm të pandemisë. Duke filluar nga themelimi i Qendrës Operative Emergjente (QOE) në Ministrinë e Shëndetësisë, pastaj ishin të shprehura kapacitet shëndetësorë, bashkëpunimi ndërinstitucional, funksionalizimi i të gjithë mekanizmave të mbikëqyrjes, sfidat e identifikuara nëpër dikastere të ndryshme qeveritare, ndikimet buxhetore, si dhe disa plane të veprimit ku ishin të parapara qartë nga procedurat e testimi deri tek vaksinimi i qytetareve.²⁴

4. Masat që kanë marrë institucionet shtetërore për menaxhimin e Covid 19

Qysh nga paraqitja e rasteve të para me Covid 19, institucionet e Kosovës kanë ndërmarrë një seri masash për menaxhimin me pandeminë. Në fillim kur Kosova po shënonte rastet e para institucionet u mobilizuan duke marrë masat për një përballje me një fluks të lartë të së infektuarve. Kjo ishte një sfidë në vete duke e ditur se çfarë niveli i kemi të ngritura institucionet shëndetësore, mirëpo kjo në fakt nuk i ndaloi institucionet tona që të ndërmarrin një sërë masash, fillimisht për ta parandaluar përhapjen e infeksionit dhe pastaj edhe në menaxhimin e situatës së krijuar.

Pas shfaqjes së rasteve të para institucionet ndërmorën veprimet fillestare duke gjurmuar gjenezën e infeksionit, kontaktet me të cilat kishin të infektuarit si dhe karantinimi i zonës nga vinte ai person.²⁵ Pastaj për ta parandaluar përhapjen e infeksionit qeveria e Kosovës mori vendim për ta ndërprerë edhe procesin arsimor²⁶ dhe pastaj më vonë u vendos që mësimi të vazhdojë në distance. Kjo ishte një sfidë jashtëzakonisht e madhe pasi që mësimi nga distanca kishte vështirësitë e veta. Pastaj për ta kontrolluar infeksionin i cili mund të importohet nga jashtë i vendos që personat të cilët vijnë nga shtetet me një numër të madh të së infektuarve të futen në karantinë, e ku u vendos që

²¹ Uebi i Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës. Marr nga <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=30819>

²² Ligjin Nr. 07/L-006 Për parandalimin dhe luftimin e Pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës Së Kosovës, Nenin 3, pika 1.1

²³ Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.11/50, i datës 23.12.2021.

²⁴ Strategjia Shtetërore për Parandalim, Menaxhim dhe Kontrollim të Pandemisë COVID-19

²⁵ Uebi i Ministrisë së Shëndetësisë së Kosovës, Vendimet. Marr nga <https://msh.rks-gov.net/sq/njoftimi-per-coronavirus/>

²⁶ Uebi i Zyrës së Kryeministrit, Vendimi nr. 01/07, datës 11.03.2020. marr nga <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/Vendimet-e-Mbledhjes-se-7-te-te-Qeverise-se-Republikes-se-Kosoves-2020.pdf>

Qendra Studentore të përdorej për këtë aktivitet.²⁷

Përveç rrezikut nga infeksioni, Covid 19 kishte edhe ndikimet e veta në ekonomi, pasi që shumë institucione pezulluan aktivitetin e tyre, çmimet filluan të rriteshin, etj. Si kundërpërgjigje ndaj kësaj, institucionet e Kosovës ndërmorën edhe masa ekonomike. Fillimisht më 30 mars 2020, qeveria e Kosovës mori vendim për aprovimin e një pakoje emergjente fiskale.²⁸ Me anën e kësaj pakoje parashihej një ndihmesë për shumicën e kategorive, duke filluar nga pensionistet, punëtorët e sektorit publik, të sektorit privat e deri tek skemat sociale. Ky ishte në fakt hapi i parë i cili kishte një ndikim të madh në përballimin e situatës. Për ta plotësuar në nivel më të mirë përballimin e situatës nga Kuvendi i Kosovës u miratua ligji nr. 07L-016 “Për rimëkëmbjen ekonomike - Covid-19”.²⁹ Me anën e këtij ligji ndërmerreshin masa konkrete për rimëkëmbje ekonomike dhe i cili rregullonte të drejtat dhe autorizimet për të gjithë sektorët e cilët ndikoheshin në këtë ligj. Vlen të theksohet se me anën e këtij ligji ishte parapare që të paguheshin edhe punëtorët e sektorit privat gjë që ishte një veprim shumë i rëndësishëm karshi përpalljes me pandeminë.³⁰

Institucionet e Kosovës gjatë gjithë kohës madje edhe tani edhe pse situata epidemiologjike ishte dukshëm më e qëndrueshme nuk pushoi së vëzhguari për së afërmi situatën dhe herë pas here ndërmerre masa konkrete në varësi nga situata epidemiologjike.

5. Analiza e hulumtimit *online* “Ndikimi i pandemisë COVID19” të realizuar gjatë vitit 2020

Duke parë situatën që mbretëronte në vendin tonë, Instituti Kërkimor për Siguri Publike, pati realizuar një hulumtim të shkurt *online*, duke marr opinionet e njerëzve pothuajse në të gjitha kategoritë, si nga aspekti social, ashtu edhe nga ai gjinor e nga mosha.

Në këtë hulumtim kryesisht janë trajtuar temat në lidhje me ndikimin e pandemisë si në aspektin psikologjik edhe në aspektin ekonomik. Jemi munduar që përmes një pyetësori të strukturuar t'i përfshijmë pothuajse të gjitha problemet të cilat ishin prezent në atë kohë. Jemi munduar të nxjerrim një pasqyrë të informacioneve të cilat qytetaret i kanë në lidhje me pandeminë. Kemi analizuar një mostër prej mbi 300 personave të cilët i janë përgjigjur hulumtimit dhe në bazë të atij numri jemi munduar ta nxjerrim një analizë.

Në hulumtim kemi pasur një përfshirje të pothuajse të së gjitha moshave dhe gjinive, ku mosha e cila ka qenë me prezentë ishte mosha 34-41 vjeç me një përqindje prej 30.5% (Grafikoni nr. 1), si dhe gjinia mashkullore me 59.2% (Grafikoni nr. 2)

Pjesa më e rëndësishme e kësaj analize është aty ku jemi mundur ta analizojmë ndikimin e pandemisë tek njerëzit dhe në çfarë forme ka ndikuar pandemia tek ata. Në kuadër të kësaj përpjekjeje ne kemi zhvilluar një sërë pyetjesh të cilat kishin për qëllim nxjerrjen e informacioneve në lidhje me ndikimin e pandemisë si nga aspekti shoqëror, psikologjik, po ashtu dhe ekonomik. Në kontekstin shoqëror të analizës kemi pasur një

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »


²⁷ Uebi i Zyrës së Kryeministrit, Vendimi nr. 01/13, datës 18.03.2020. marr nga <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/Vendim-i-Mbledhjes-se-13-te-te-Qeverise-se-Republikes-se-Kosoves-1.pdf>

²⁸ Uebi i Zyrës së Kryeministrit, Vendimi nr. 01/19, datës 30.03.2020. marr nga <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/Vendimi-i-Qeverise-nga-Mbledhja-e-19.pdf>


²⁹ Uebi i Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës. Marr nga <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=35478>

³⁰ Ligji Nr. 07L-016 Për Rimëkëmbjen Ekonomike - Covid-19.

Grafikoni Nr.1




Grafikoni Nr.2




rezultat që shumica e atyre të cilët ishin pjesëmarrës në hulumtim ishin të punësuar me rreth 79.4% (Grafikoni nr.3) dhe në vazhdim të hulumtimit vërehet se kjo kategori ishte pak më e ndikuar nga masat të cilat merreshin gjatë pandemisë.

Një pjesë shumë e rëndësishme e hulumtimit është aspekti psikologjik i përjetimit të shfaqjes së pandemisë në Kosovë. Në pyetjen të cilën e kemi shtruar se “si e keni pritur lajmin për shfaqjen e rasteve të para?”, pjesa më e madhe apo 56.3% kanë deklaruar se kanë pasur frikë për veten e tyre dhe familjen, indikacion ky i cili ka dërguar drejt një paniku (Grafikoni nr.4).

Grafikoni Nr.3



Grafikoni Nr.4




Në vazhdim të kësaj është analizuar edhe niveli i panikut që është shkaktuar nga vërshimi i marketeve për t'u furnizuar me gjëra elementare dhe kemi një rezultat shqetësues ku 85.3% e tyre janë ndikuar nga ky veprim, ndërsa 74.4% e tyre janë inspiruar që edhe ata të shkojnë dhe të furnizohen (Grafikoni nr. 5).

**AKADEMIA
E SIGURISË**


« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

Grafikoni Nr.5




Një dukuri shumë rrezikshme gjatë pandemisë kanë qenë lajmet e rrejshme (*Fake News*), të cilat kanë ndikuar në një masë të madhe në rritjen e panikut dhe kjo pastaj kaloi në një nivel tjetër ku njerëzit tashme ndikoheshin në një masë të madhe nga këto lajme. Një të dhënë të rëndësishme e ka japë edhe hulumtimi jonë ku 57.1% kanë deklaruar se këto lajme kanë ndikuar në rritjen e panikut (Grafikoni nr. 6).

Grafikoni Nr.6



Pas shtimit të rasteve me të infektuar, qeveria kishte vendosur disa masa duke kufizuar disa aktivitete ashtu siç e kemi përmendur edhe në kapitullin më lartë kishin ndikuar në masë të madhe në jetën dhe ekonomin e qytetareve, ku si pasoj e kësaj kemi pasur një rezultat me rreth 81.7% të cilët janë deklaruar se masat kanë ndikuar në jetën tonë ndërsa 47.2% janë shprehur se ka rënduar ekonomin familjare (Grafikoni nr. 7).

Grafikoni Nr.7



AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »


Duke qenë se kemi kishte një ekzistence të një paniku të madhe një numër mjaft i madh i njerëzve kanë menduar se si pasoj e pandemisë mund të përjetojmë një katastrofë humanitare, dhe në këtë kuadër ne kemi kërkuar informacion përmes hulumtimit tonë se sa ka ishte rreziku që të gjendemi para një situatë të tillë me një rezultat mjaft të lartë me rreth 85.9% janë përgjigjur se rreziku është mbi nivelin mesatar, ndërsa 37.1% prej tyre mendonin se rreziku është në një nivel shumë të lartë (Grafikoni nr. 8).

Grafikoni Nr.8



Dhe në fund fare jemi interesuar për një opinion të qytetareve se në çfarë niveli e kanë kryer punën institucionet, me theks të veçantë institucionet e sigurisë dhe ato shëndetësore. Nga ajo çfarë kemi gjetur në këtë pjesë, është se ka ekzistuar një besim jashtëzakonisht i madh në këto institucione. Nga kjo kemi marrë një rezultat mjaft të lartë, ku tek pjesa e punëtorëve shëndetësorë kishim rreth 89.4% të cilët mendonin se po kryenin punën mbi nivelin mesatar, ndërsa kishim 43.3% të cilët mendonin se janë duke e kryer punën në nivel shumë të lartë. Ndërsa për sa i përket institucioneve të sigurisë po ashtu kemi një rezultat të lartë me rreth 82.9% mendonin se ata kryenin punën mbi nivelin mesatar dhe prej tyre 33% mendonin se e kryenin në nivel shumë të lartë (Grafikoni nr.9).

Grafikoni Nr.9



Si përfundim i këtij kapitulli mund të themi se pandemia kishte ndikuar jashtëzakonisht shumë në jetën e njerëzve në forma të ndryshme dhe se niveli i panikut ishte mjaft i madh dhe kërcënues për qetësinë dhe rendin publik.

6. Përfundime dhe rekomandime

1. Duke analizuar gjithë atë që e thamë më lartë atëherë mund të themi se pandemia Covid 19 ishte një kërcënim shumë serioz për gjithë botën, nga i cili bota në fakt u fut në një krizë shëndetësore dhe pothuajse asnjë shtet nuk ishte i gatshëm mjaftueshëm që të përballlej me këtë fatkeqësi.

2. Kjo shpërfaqti një fakt që as shtetet më të fuqishme nuk mund të përballeshin si të vetme në situata të tilla dhe patjetër që duhet të kishte një bashkëekzistencë e vazhdueshme ndërmjet pothuajse të gjithë globit.

3. Covid 19 ishte një fatkeqësi e cila i sfidoi të gjitha shtetet pa dallim zhvillimi dhe u pa që pothuajse askush nuk është i përgatitur mjaftueshëm për një përballje ndaj një situatë të tillë; u pa që të gjitha shtetet e botës duhet ende të punojnë në ngritjen dhe afirmimin e kapaciteteve të tyre shëndetësore.

4. Kosova mund të themi se me ato kapacitete që kishte, arriti ta menaxhonte në masë të konsiderueshme situatën, mirëpo duke i njohur kapacitetet tona atëherë themi se Kosova kishte bërë madje edhe më shumë se sa kishte mundësi e kapacitete.

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

5. Përballja me pandeminë nxori në pah faktin se Kosova duhet të punojë më shumë në ngritjen e kapaciteteve si nga ana e politikave ashtu edhe nga ana e infrastrukturës, në mënyrë që të ketë një përballje më efikase ndaj kërcënimeve të tilla.

7. Rekomandime

1. Kosova duhet të ndërtojë kapacitete infrastrukturore dhe profesionale që në të ardhmen nëse paraqiten situata të tilla të jetë e përgatitur për një përballje të denjë.

2. Rregullimin dhe avancimin e bazës ligjore dhe krijimin e strategjive konkrete të cilat rregullojnë në detaje format e përpalljes me situata të ngjashme.

3. Krijimin e një fondi të veçantë i cili do të përdorej në rast të paraqitjes së ndonjë pandemie dhe në këtë mënyrë do të ishte më lehtë pastaj të gjenden mjetet për të siguruar materialet bazike për përballje me një situatë të tillë pandemie.

4. Ndërtimin e spitaleve dhe pajisjen me aparatura dhe materiale më të avancuara në mënyrë që kur të paraqitet një situatë e tillë të mos e gjejë të papërgatitur dhe pastaj mos të dijë se si të veprojë.

Bibliografia

Burime të përgjithshme interneti:

1. Uebi i Organizatës Botërore e Shëndetësisë. Marrë nga <https://www.who.int/emergencies/diseases/novel-coronavirus-2019/situation-reports>
2. Uebi Reliefweb, Marrë nga https://reliefweb.int/report/world/epidemiological-update-coronavirus-disease-covid-19-15-october-2020?gclid=Cj0KCQjwkOqZBhDNARIsAACsfKxciFzAb2sE7_RcCZgTOujf7MvX55hyjhjMS3_n3FNUTSYsMeBeDTcaAnYFEALw_wcB
3. Uebi i Organizatës Botërore e Shëndetësisë. Marrë nga [https://www.who.int/emergencies/diseases/novel-coronavirus-2019/technical-guidance/naming-the-coronavirus-disease-\(covid-2019\)-and-the-virus-that-causes-it](https://www.who.int/emergencies/diseases/novel-coronavirus-2019/technical-guidance/naming-the-coronavirus-disease-(covid-2019)-and-the-virus-that-causes-it)
4. Uebi i Organizatës Botërore e Shëndetësisë. Marrë nga <https://www.who.int/director-general/speeches/detail/who-director-general-s-opening-remarks-at-the-media-briefing-on-covid-19-11-march-2020>
5. Uebi i Eurosurveillance, First cases of coronavirus disease 2019 (COVID-19) in the WHO European Region. Marrë nga <https://www.eurosurveillance.org/content/10.2807/1560-7917.ES.2020.25.9.2000178>
6. Uebi i Deutsche Welle, Marrë nga <https://www.dw.com/sq/kosov%C3%AB-konfirmohen-dy-rastet-e-param-virusin-corona/a-52769039>
7. Uebi i Anadolu Agency (AA). Marrë nga <https://www.aa.com.tr/sq/ballkani/sh%C3%ABnohet-vdekja-e-par%C3%AB-nga-koronavirusi-n%C3%AB-kosov%C3%AB/1774826>
8. Uebi i Ministrisë së Shëndetësisë së Kosovës, Manual për mbrojtje nga përhapja e virusit covid-19. Marrë nga <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2020/06/Manual-p%C3%AB-parandalimin-dhe-luftimin-e-COVID19.pdf>
9. Uebi i Ministrisë së Shëndetësisë së Kosovës, Vendimet. Marrë nga <https://msh.rks-gov.net/sq/njoftimi-për-coronavirus/>
10. Uebi i Zyrës së Kryeministrit. Marrë nga <https://kryeministri.rks-gov.net/>

Politikat dhe strategjitë:

1. Ligji Nr. 02/L-109 Për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse
2. Ligji Nr. 04/L-027 Për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera
3. Plani i Reagimit Kombëtar
4. Ligji Nr. 07/L-006 Për parandalimin dhe luftimin e Pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës Së Kosovës
5. Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr. 11/50, i datës 23.12.2021.
6. Strategjia Shtetërore për Parandalim, Menaxhim dhe Kontrollim të Pandemisë COVID-19
7. Ligji Nr. 07L-016 Për Rimëkëmbjen Ekonomike - Covid-19.

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

Rëndësia e trajnimeve të efektivëve të policisë, për të rritur bashkëpunimin me komunitetin në menaxhimin e rasteve të emergjencave civile



■ **Dr. Blerta DERVISHI**

*Drejtorja Vendore e Policisë Tiranë,
Komisariati i Policisë nr.1
email: blerta.dervishi@yahoo.com*



■ **MSc. Erisa RAKIPI**

*Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtorja Antiterrorit.
email: erisa.rakipi@asp.gov.al*

Abstrakt

Rëndësia e organizimit të trajnimeve të punonjësve të policisë me komunitetin e shoqërisë civile për të ndërtuar bazat e nevojshme për përballimin e rreziqeve dhe fatkeqësive natyrore. Argumentojmë rëndësinë e trajnimeve që garantojnë këtë bashkëpunimin efektiv duke ofruar dhe rekomandime dhe si të përmirësohet. Vlerësojmë përsosjen e formave të thirrjes për të gjithë pjesëmarrësit (punonjës policie, ish-punonjës policie dhe pjesëtarëve të shoqërisë civile) për të qenë të pranishëm në kohën e duhur duke organizuar bashkëpunimin për të ndërhyrë në rastet e ngjarjeve natyrore dhe emergjencat të tilla si tërmetet dhe pandemitë. Përballë tragjedi natyrore, bashkëpunimi me komunitetin do të thotë mundësi për të ndërhyrë në kohën e duhur për të shpëtuar jetë njerëzish. Rekomandohen përvojat më të mira të shteteve të Aleancës së Atlantikut ku edhe ne bëjmë pjesë për të bërë realiste ndërhyrjet tona duke propozuar rrugët dhe mundësitë për të siguruar mjetet e ndërhyrjes efektive gjatë përballimit të emergjencave. Punimi mban parasysh organizimin e përballimit të emergjencave në rastin e tërmetit të ndodhur më 26 nëntor 2019, i cili nxori në pah problematikat dhe faktin se kur pjesëmarrja e shoqërisë civile integrohet në menaxhimin e fatkeqësive, rezultati është zbutja e qëndrueshme e rreziqeve.

Fjalëkyçe:

emrgjencat civile, trajnime, bashkëpunim, komunitet.

1. Hyrje

Policimi në komunitet është konceptim i zbatimit të ligjit që lejon policinë dhe publikun të bashkëpunojnë për zgjidhjen e problemeve të komunitetit me përfshirjen aktive të shoqërisë civile

Ka katër drejtime për siguruar suksesin e policimit në komunitet ai filozofik strategjik, taktik dhe organizativ.

a. Drejtimi filozofik.

Policimi në komunitet i referohet idesë dhe veprimeve perspektive që përfshijnë gjetjen e problemeve të komunitetit dhe kërkimin e mënyrave për t'i zgjidhur ato. Oficerët e policisë adresojnë këto shqetësime për të ndihmuar komunitetin të cilat shërbejnë për qëllimeve të mëposhtme:

- të krijojë komunikim të qëndrueshëm të komunitetit qytetar me organet e zbatimit të ligjit;

- t'i jepet vendi i duhur zgjidhjes së nevojave të qytetarëve;

- policimi mundëson zgjidhjen edhe efektive të konflikteve që qytetare të ndihen më të sigurt në bashkëjetesën komunitare.

b. Drejtimi strategjik.

Synon arrijen e një policimi të besueshëm për komunitetin, që të mundësojë zbatimin e ligjit dhe parandalimin e krimit.

c. Drejtimi taktik.

Ky drejtim i policimit në komunitet ndihmon zbatimin e ligjit dhe ndihmon forcat e rendit të arrijnë suksesin në kryerjen e detyrave specifike duke siguruar bashkëpunimin me komunitetin shoqëror.

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

d. Drejtimi organizativ.

Ky drejtim mundëson promovimin e policimit në komunitet duke u kuptuar si një vullnet logjik i palëve në zbatimin e ligjit.

Policimi në komunitet është konceptim prej të dy palëve i zbatimit të ligjit në mënyrë të vullnetshme duke bashkëpunuar natyrshëm pa imponim e pa detyrim. Nëpërmjet këtij konceptimi, problemet e komunitetit zgjidhen me ligj dhe me mirëkuptim.

2. Parimet e policimit në komunitet

Policimi në komunitet paraqet mjaftë vështirësi për t'u zbatuar. Ja disa nga parimet udhëzuese për mënyrat se si mund të funksionojë policimi në komunitet:

- Filozofia dhe strategjia organizative

Një drejtues efektiv në kryerjen me sukses të detyrës duhet të përzgjedhë anëtarë që karakterizohen nga ndjenja e sakrificës për të dhënë ndihmën e duhur dhe që përfshihen pa imponim dhe pa interes në strukturat organizative.

- *Angazhimi për fuqizimin e komunitetit.*

Ky duhet konceptuar si përfshirje qytetare të anëtarëve të komunitetit në policimin kur ata përfshihen me ndjenjë duke vlerësuar përgjegjësinë si qytetar për të qenë të sigurt në bashkëjetesën komunitare.

- *Policimi i decentralizuar dhe i personalizuar.*

Policimi ideal në komunitet nënkupton idenë që punonjësi i policisë të krijojë marrëdhënie të singerta dhe të shfaqë besueshmëri te qytetarët e komunitetit nëpërmjet takimeve të përditshme.

- *Zgjidhja e menjëhershme dhe ndjekja aktive e problemeve afatgjatë.*

Tiparet karakterizuese të punonjësit të policisë dallohen nga: etika, ligjshmëria, përgjegjësia dhe besimi; qëndrime me të cilat duhet të operojë sipas rasteve konkrete, gjithmonë, bazuar në ligj dhe duke respektuar besimin e individit.

Zgjerimi i mandatit të policisë nënkupton qëndrimin e përgjegjshëm të punonjësit të policisë në komunitet duke qenë i afërt, i afërueshëm dhe i besueshëm.

Ndihma për qytetarët me nevoja të veçanta dhe me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe minoret duke u kujdesur për t'i adresuar qytetarët si të gjejnë adresat për të marrë ndihmën e specialistëve për nevojat e tyre.

Kreativiteti dhe mbështetja në bazë dijeve dhe aftësive profesionale, për t'i zbatuar ato në mënyrë të përshtatshme dhe të dobishme në komunitet.

- Ndryshimi i sjelljes së brendshme dhe i mënyrës së të menduarit te vet punonjësit të Policisë së Shtetit.

Vetëm kështu policimi në komunitet nuk do të jetë një pengesë duke zgjidhur në mënyrë shteruese çdo çështje aktuale duke i bërë ato të menaxhueshme e më të dukshme.

3. Fatkeqësitë e paparashikuar të tërmetit me datë 26 nëntorit 2019

Shqipëria është një vend i rrezikuar nga fatkeqësi natyrore si: tërmetet, përmytjet apo përhapja e epidemive. Tërmeti me magnitudë 6.4 të shkallës Rihter, në 26 nëntor

2019, goditi Durrësin, Shijakun, Tiranën, Krujën (Thumanë), Kamzën, Kavajën, Kurbinin dhe Lezhën, duke rezultuar në 51 humbje jete dhe 913 të plagosur si dhe dëme të mëdha materiale. Në këto kushte, qeveria aktuale mori përsipër rindërtimin, strehimin e qytetareve që humbën pasuritë e tyre, ne qendrat pritëse për familjet e prekura nga tërmeti. Pas më shumë se dy vite, ritmet e rindërtimit nuk kanë efikasitetin dhe efektshmërinë e duhur dhe është shoqëruar edhe me pakënaqësi sidomos për trajtimin e ndryshëm të qytetarëve dhe mbajtjes së premtimeve për afatet e parashikuara, kjo edhe për shkak të pandemisë Covid 19 në vend.

Politika e rindërtimit dhe strategjitë e qeverisë për përballimin e krizës.

Ky aksion madhor u drejtua nga zëvendëskryeministri Arben Ahmetaj, dhe Komisioni Shqiptar i Rindërtimit, KSHR, si organ kolegjal. Aktorët e tjerë për rindërtimin dhe rivitalizimin e zonave të prekura nga tërmeti qenë Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, bashkitë, si dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit si njësi zbatuese për rindërtimin e shtëpive individuale, grupimin e rindërtimit të shtëpive individuale në zonat rurale, bashkë me ndërtimin e infrastrukturës mbështetëse, si dhe ndërtimin e lagjeve të reja urbane.

Fillimisht u inspektuan dhe u vlerësuan dëmet strukturore nga ekspertët shqiptarë, me mbështetje edhe të ekspertëve të huaj, që përcaktuan dhe kategorizuan 5080 ndërtesa (apartamente, shtëpi private, shkolla, hotele, etj) si DS4 e DS5, që u konsideruan të pabanueshme. Në vlerësimin e nevojave post-fatkeqësi, një numër total prej 11 490 njësisë të strehimit u klasifikuan si të shkatërruara tërësisht ose për t'u shembur (IFRC, 2020).

4. Roli i qeverisë në përballimin e pasojave të tërmetit dhe politika e rindërtimit

Qeverisja mori përgjegjësinë në rindërtimin post-fatkeqësi; qe ajo që angazhoi agjencitë përkatëse, si dhe vuri fondet në dispozicion, adresoi ndihmat nga agjenci apo institucione të tjera, si dhe angazhoi personelin e trajnuar për përballimin e krizave dhe shpëtimin e kapitalit human. U desh që qeveria të përcaktonte rregulla e lojës të cilat i bëri të njohura që në fillim, si dhe, një vëmendje e shtuar, iu kushtua rregullave të mbrojtjes së pronës private, si dhe të specifikonte rregullat që ndihmonin aktorët lokalë që të përfshiheshin në procesin e përballimit të krizës, kjo u mbështet në Aktin Normativ “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, programi i rindërtimit e nënprogramet përkatëse, që përcaktohen në nenin 18 (Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, 2019): planifikimi sheshndërtimeve të reja për objektet në varësi të planeve zhvillimore të zonave të prekura më rëndë, këtë herë në krye të këtij investimi madhor u përfshinë autoritetet shtetërore, donatorët. U tregua kujdes që rindërtimi i ndërtesave të shembura nga fatkeqësia natyrore të bëhej në të njëjtin truall. Por, programi i krijimit të fondit të banesave i kushtoi vëmendje edhe blerjes së banesave të reja në treg ku u përfshinë edhe banesat e dhuruara nga privatët.

Aspekti i rëndësishëm i rindërtimit ishte parashikimi në mënyrë të saktë i veprimet që duheshin ndërmarrë për t'u realizuar në kohe. Rindërtimi nxori probleme që u vlerësuan nga strukturat përkatëse për të parandaluar dhe për të lehtësuar pasojat në ngjarje të tilla dhe në përmirësimin fazën e përgatitjes dhe të mbrojtjes. Rishikimi ndoqi një format të përshtatshëm për raportim, që ishte më i kuptueshëm dhe kishte marrë parasysh këto çështje:

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

- u hartuan plane për parandalimin dhe për lehtësimin e pasojave pas ngjarjes;
- me ndihmën e partnerëve rrit shpejtësia dhe efektiviteti i operacioneve të ndërhyrjes së kërkim-shpëtim, evakuimit të viktimave në pa vonesë, u bë evakuimin, sigurimi i akseve rrugore, pastrimin e rrugëve dhe vijimi i rregullt transportin të mjeteve të emergjencës, si dhe u arrit sigurimi i shërbimeve publike bazë.

- u sigurua efektiviteti i veprimeve për dhënien e ndihmës së shpejt shëndetësore për çdo rast të emergjencave civile, qytetarët u sistemuan në qendra strehimi të përkohshme të sigurt, dhe me asistencën ushqimore dhe logjistike;

- u shpërndanë në kohë në terren njësitë e specializuara të asistencës ndërkombëtare dhe u monitoruan nga punonjësit e dikastereve qendrore marrëdhëniet me organizmat ndërkombëtarë;

- u hartuan në kohë rekord programet e trajnimit të vullnetarëve duke forcuar kapacitetet e dhënies së ndihmës së duhur rasteve të emergjencës;

- iu kushtua vëmendje informacionit si dhe sigurimit të burimeve për rikthimin në gjendje normale.

a. Trajnimet, stërvitjet e ndryshme.

Zhvillimet aktuale të fushës të trajnimit MPVD-ja, në përputhje me ligjin nr. 8756 “Për emergjencat civile” (neni 8.2, pikat e, f): “Përpunon dhe koordinon programet e arsimit dhe të trajnimit në fushën e mbrojtjes civile”.

b. Manualët e trajnimit janë :

- “Bazat e menaxhimit të fatkeqësive në Shqipëri”;
- “Planifikimi për përballimin e emergjencave”;
- “Parapërgatitja në nivel lokal për përballimin e emergjencave”;
- “Vlerësimi i dëmeve dhe i nevojave, shkaktuar nga emergjencat”;
- “Bashkërendimi i operacioneve për përballimin e emergjencave”;
- “Logjistika dhe shpërndarja e ndihmave”;
- “Udhëzuesi për trajnerët e menaxhimit të emergjencave”;
- “Udhëzuesi për parapërgatitjen për emergjencat”.

c. Dhënia e vëmendjes së duhur të strategjisë së trajnimit për të qenë të parapërgatitur për të papriturat që mund të na rezervojë natyra për të ardhmen.

Përparësitë aktuale në fushën e trajnimit janë:

- testimi dhe përmirësimi në mënyrë të vazhdueshme të kurrikulës duke përdorur mjetet dhe metodat e duhura duke u bazuar në: përparësitë, nevojat e grupeve përfituese të trajnimit dhe zhvillimet rajonale;

- trajnimi është vendimtar për promovimin e profesionalizmit të personelit operacional dhe të menaxhimit të emergjencave civile në vend;

- trajnimi duhet të promovojë aplikimin e kriterëve standarde në fushën e operacioneve dhe të ketë si qëllim përafrimin me standardet e BE-së;

- duhet të organizohen aktivitete të përbashkëta trajnimi me të gjitha strukturat policimit në gjitha nivelet.

Objekti kryesor i testimit, i rishikimit dhe i vlerësimit është mbledhja e të gjithë informacionit të nevojshëm rreth aspekteve negative dhe pozitive të veprimeve të kryera dhe masat për përmirësimin e trajtimit.

Organizimi dhe bashkërendimi i veprimeve, mund të bëjë të mundur zgjidhjet dhe përmirësimet të policimit në komunitet do të ndikojnë në rritjen e efektivitetit në të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit të emergjencave në komunitetet shoqërore.

- *Ushtrimi i veprimeve në emergjencat civile, tërmetet apo katastrofat natyrore.*

Trajnimet dhe stërvitjet konsiderohen si mjete ndihmëse të domosdoshme për të kuptuar radhën e punës nga secili që përfshihet në policimin të komunitetit, do ta lehtësonte dhe orientonte si duhet punën në terrenin konkret gjatë fazave të ciklit të menaxhimit të emergjencave.

Metodologjia e trajnimit përcaktohet në bazë të një sërë faktorësh, si: situata, niveli i audiencës, nevojat e komunitetit në zonat me rrezik të lartë, dhënia përparësi atyre vendngjarjeve ku rreziku i humbjes së jetëve është çështje kohe mos vlerësimi i të cilave çon në fatalitete të pakthyeshme. Vlerësojmë si më të domosdoshme për të minimizuar humbjet njerëzore në rast fatkeqësish natyrore të paparashikueshme këto aktiviteteve: stërvitjen në terren me pjesëmarrjen e forcave operacionale dhe të komunitetit. Në këto stërvitje bëhet testimi të aftësive vepruese të pjesëmarrësve në situatë të simuluar dhe në një mjedis tejet të rënduar. Kuptimi dhe vlerësimi logjik prej të gjithë pjesëmarrësve, përcaktimi i hierarkisë dhe vendit të secilit nga pjesëmarrësit, ngritja e grupeve solide duke zgjedhur në krye të tyre individëve, pjesëtarë të përhershëm të policimit në komunitet, që zotërojnë kapacitetet dhe aftësitë e duhura për organizimin e bashkërendimit të pjesëmarrësve në policimin e komunitetit e konsiderojmë gjënë e duhur për ngritjen e nivelit të bashkërendimit, si një nga investimet më efikase në ngritjen dhe funksionimit të planeve të minimizimit të humbjeve njerëzore në emergjencat civile.

5. Këshillime

a. Policimi në komunitet është aktivitet bashkëpunimi i domosdoshëm për të përballuar pa humbje njerëzore rreziqet dhe fatkeqësitë natyrore.

b. Policimi në komunitet është nga strategjitë efektive dhe me fuqi transformuese në se arrihen procedurat standarde të funksionimit.

c. Policimi në komunitet është ndërgjegjësim për çdo situatë hipotetike ku secili pjesëmarrës aftësohet në organizimin e mbështetjes dhe të vendimmarrjes dhe koordinimin e veprimeve për të reaguar në kohën e duhur në situata reale emergjence.

d. Në përmbledhje policimi në komunitet është një detyrë sfiduese, që vetëm me trajnime është një detyrë e arritshme nga çdo strukturë e këtij policimi.

Menaxhimi i emergjencave mban parasysh:

(1) Uljen në maksimumet e mundshme të rrezikut të fatkeqësive nëpërmjet aftësimit të pjesëmarrjes në policim për të parandaluar panikun e atij çasti të goditjes së fatkeqësisë natyrore.

(2) Në çastin e goditjes natyrore të fatkeqësisë e rëndësishme është ngritja e nivelit të gatishmërisë së njerëzve që përfshihen në strukturat e policimit nëpërmjet planifikimit dhe trajnimit prej udhëheqësve të strukturave që të sigurohet gjithëpërfshirja e të çdokujt në detyra të qarta dhe specifike.

(3) Detyra kryesore në e struktura të policimit është ajo e kërkim dhe shpëtimit;

(4) Detyra e dytë vënia në aktivitet të plotë i linjave të shpëtimit dhe shërbimeve bazë.

Si të përmirësohen në policimin e komunitetit aktivitetet bashkëpunuese:

Krijimi dhe ruajtja e lidhjeve të nevojshme është një sfidë momentale dhe një detyrë e domosdoshme për vet faktin se Shqipëria përfshihet në një zonë sizmike ku nuk kanë munguar fatkeqësitë me përfundime katastrofike. Me fjalë të tjera, kapaciteti për të bashkëpunuar në mënyrë efektive me rrjetet e vendit të fatkeqësive është thelbësore.

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

Hartimi i një plani efektiv dhe të mirëmunduar për të arritur ndërveprimin e shpeshtë, nëpërmjet aftësimin me ushtrime trajnimi ku testohen, mundësitë dhe gatishmëria reale e pjesëmarrësve në policimin e komunitetit është detyrim domosdoshmërisht i paneglizhueshëm. Reagimi emergjent kërkon organizim dhe planifikim të përpiktë, dhe nuk duhet lënë spontanitetit. Menaxherët e urgjencës duhet të rinovojnë, përshtatin dhe improvizojnë planin, duke marrë parasysh përshtatjen e tij me rrethanat.

Të vlerësohet seriozisht dhe të punohet me shumë seriozitet fryma e injorimit të rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe duhet të vlerësohet maksimalisht referencat standard me anën e të cilave është e mundur të parashikohen mbështetur në gjasat e rreziqet që kanë përjetuar paraardhësit tanë që janë trashëguar në memorien e brezave paraardhës që të rrëfyera gjatë trajnimeve rrit niveli e besueshmërisë të pjesëmarrësve që me siguri do të binden për përgjegjësitë dhe aftësitë që duhet të fitojnë gjatë trajnimeve duke pranuar me shumë dashamirësi mendimet e gjithsecilit.

Fatkeqësitë e fundit katastrofike kanë bërë shqetësimin e njerëzve shumë më qendror, dhe natyrshëm gjithsecili do t'i vlerësojnë një trajnim që ka në fokus planifikimin e emergjencave të mundshme.

Në nivel lokal, bashkëpunimi ka qenë gjithmonë më prezent për shkak të ndjenjës së mbështetjes e të vullnetarizmi që ka karakterizuar bashkëjetesën në etninë tonë.

Parandalimi si koncept që ndikon te pjesëmarrësit në trajnim i sqaruar më me imtësi do ta rriste ndjenjën e përgjegjësisë te pjesëmarrësit në policim në komunitet. Menaxhuesit e trajnimeve për emergjencat nga tërmetet duhet t'i njohur pjesëmarrësit për kodet e ndërtimit, standardet e ndërtimit dhe rregulloret e përdorimit të tokës për t'u dhënë mundësin të gjithë pjesëmarrësve në trajnime për të dhënë mendimin e tyre për rreziqet ngjarjet sizmike të tokës dhe të ndërtimeve në komunitet. Duam të besojmë se secili prej pjesëmarrësve në trajnime të tilla do të jetë në gjendje dhe të reagoje e njoftojë për rreziqet potenciale që mundet të ndodhin në shtëpinë e tyre, në lagjen dhe më gjerë. Në kësi rastesh dhe trajnerët e policimin në komunitet mund të shënojnë shqetësimet e pjesëmarrësve dhe të komunikojnë institucionalisht me strukturat përkatëse të pushtetit vendor. Përvojat nga fatkeqësitë mund të përshpejtojnë rikuperimin dhe t'i bëjë komunitetet më elastikë kur fatkeqësia të godas sërish. Kapacitetet e komunitetit nuk aktivizohen për t'u përgjigjur dhe për të rikuperuar dëmet nga fatkeqësitë neglizhohen kjo do të thotë që zyrtarët e pushtetit vendor ndalojnë ose përjashtojnë përfshirjen e komunitetit në zgjidhjen e problemeve konkrete që ata parashtrajnë.

Rrjetet bashkëpunuese janë një komponent themelor i çdo reagimi emergjent. Është gabim të supozohet se problemet mund të zgjidhen plotësisht. Atëherë, si duhet të udhëheqin menaxherët e policimit në komunitet në kohë katastrofash? Sidoqoftë, në njësi të tilla të vogla, rolet shpesh ndërthuren shefat e policisë ose vartësit e tyre që vepronin si menaxherë emergjence si dhe si reagues. Rritja e partneriteteve me organizatat, Megjithatë, zbutja e rreziqeve, gatishmëria ndaj fatkeqësive, reagimi ndaj fatkeqësive dhe rikuperimi i fatkeqësive janë të ndërthurura kjo kërkon kthimin sa më të shpejtë në funksionim të pajisjeve dhe strukturave ndërtimore, pra infrastrukturës së shkatërruar, si dhe të dëmtuar, që janë sfida të pashmangshme në fazën e rikthimit në gjendjen normale. Pas tërmetit jemi dëshmitarë që një pjesë e popullsisë nuk është bërë e mundur t'u kthehet menjëherë kushteve normale të jetës ose punës. Zonat e shkatërruara paraqesin kufizime për kthimin në normalitet dhe si rezultat nivelit të lartë të dëmtimit një numër i madh banesash dhe banorë të dëmtuar janë në varësi vetëm të asistencës shtetërore ose të asaj humanitare.

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

Kërkohet marrja e masave si më poshtë:

- *Këshillimi*. Sigurimi i informacionit të nevojshëm dhe këshilla për banorët që e kanë të pamundur kthimin në shtëpitë apo në zonat e tyre të banimit.

- *Strehimi*. Sigurimi i burimeve të nevojshme për strehimin e menjëhershëm dhe në vazhdimësi të popullsisë, derisa të gjendet një strehim i përhershëm.

- *Asistenca*. Sigurimi i asistencës së vazhdueshme derisa banorët, grupet apo komuniteti i prekur të jenë në gjendje të fitojnë një masë sigurie dhe besimi në vetvete.

- *Zhvendosja*. Atje ku kthimi nuk është i mundur të sigurohet, dhënia e të gjitha mjeteve të mundshme për të zhvendosur banorët në një vendbanim më të përshtatshëm, të sigurt, nga të njëjtat shkaqe rreziku ose rreziqe që mund të shkaktojnë emergjencat civile të ngjashme me to.

- *Kompensimi*. Sigurimi i kushteve të barabarta për qytetarët, grupet apo komunitetin e prekur, për të ndihmuar dhe për të bërë të mundur përfaqësimin me efektivitet gjatë kërkesave të tyre për ndihmë humanitare apo kompensime nga shteti, nëse një gjë e tillë aplikohet.

6. Konkluzione dhe rekomandime

Nisur nga mënyra në të cilën po realizohet politika e rindërtimit në Shqipëri, pas tërmetit të 26 nëntorit 2019, edhe në qarkun e Durrësit, mund të dilet në përfundimin se ky proces ka qenë relativisht i ngadaltë, me paqartësi dhe me vonesa të cilat kanë ndikuar në jetesën dhe mirëqenien e qytetarëve. Qeveria shqiptare, mori rolin kryesor në rindërtim. Me gjithë rolin e qeverisë në sigurimin e fondeve dhe të burimeve të tjera, janë hasur një sërë problematikash të lidhura me efikasitetin dhe efektivitetin e procesit, si: ekspertizat e ndryshme, afatet kohore, paqartësi dhe mungesë informacioni për subjektet, masat e ndihmës, disbursimin e fondeve për bonuset e qirave apo edhe për përfituesit e granteve, problemet në lidhje me ndërtesat e klasifikuara DS4, etj. Rindërtimi dhe rikthimi në normalitet duhet të përfshinte rregulla të qarta dhe të njohura për qytetarët, më shumë transparencë për sa i përket dëmeve strukturore të konstatuara në ndërtesat e inspektuara, trajtimeve me bonuse qiraje si dhe grantet e rindërtimit, në lidhje me: afatet e aplikimit, kriteret, ekspertizat e thelluara, zonat e reja të zhvillimit dhe të drejtat mbi pronësinë, si dhe lehtësirat apo ndihmat e tjera të parashikuara, nga burime të ndryshme. Për më tepër, ka mjaft paqartësi akoma edhe sot, pas 15 muajsh, në lidhje me rikonstruktimin apo konsiderimin për prishje të detyruar të ndërtesave të klasifikuara DS4, për shkak të diferencave në aktekspertiza apo problematika të tjera, duke ndikuar në perceptimet e masave si gjysmake e të pamjaftueshme dhe të lidhura me përfitime elektorale, për zgjedhjet e përgjithshme të 25 prillit 2021. Në kushtet kur qeverisja ka rolin kryesor në menaxhimin e pasojave post-fatkeqësi dhe rindërtimin, duhet të kishte koordinim më të mirë mes institucioneve, duke mbështetur aktorët lokalë, bizneset dhe qytetarët, që në një kohë më të shkurtër, ti riktheheshin jetës normale, edhe në situatën e vështirë të përhapjes së pandemisë Covid-19.

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

Bibliografia

1. Akt Normativ nr.9, dt. 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore"
2. Advisory Commission on Intergovernmental Relations. The New Grass Roots Government. Washington, D.C.: U.S. Government Printing Office. 1972.
3. Advisory Commission on Intergovernmental Relations. State-Local Relations in the Criminal Justice System. Washington, D.C.: U.S. Government Printing Office. 1971.
4. Allevato, S. Developing of a Law Enforcement Plan for California Cities Committed to Quality Service Through Community-Oriented Policing. Sacramento: California Commission on Peace Officer Standards and Training. 1989.
5. American Association of Retired Persons Criminal Justice Services Program Department. Neighborhood Watch—Communities Combat Crime. Washington, D.C.: American Association of Retired Persons. 1983.
6. Banas, Dennis, and Robert C. Trojanowicz. Uniform Crime Reporting and Community Policing—An Historical Perspective. East Lansing, Mich.: National Neighborhood Foot Patrol Center, Michigan State University, School of Criminal Justice. 1985.
7. Bayley, David H. The Best Defense. Washington, D.C.: Police Executive Research Forum. 1992.
8. Bayley, David H. Model of Community Policing: The Singapore Story. Washington, D.C.: U.S. Department of Justice, Office of Justice Programs, National Institute of Justice. 1989.
9. Behan, Cornelius J. "Responding to Change and Managing Crimewarps." American Journal of Police 9(3)(1990).
10. Belknap, J., Merry Morash, and Robert C. Trojanowicz. Implementing a Community Policing Model for Work With Juveniles—An Exploratory Study. East Lansing, Mich.: National Neighborhood Foot Patrol Center, Michigan State University, School of Criminal Justice. 1986.
11. Bittner, Egon. Aspects of Police Work. Boston: Northeastern University Press. 1990. Blumstein, Alfred, and Jacqueline Cohen. Criminal Careers and Career Criminals. Washington, D.C.: National Academy of Sciences. 1986.
12. Blumstein, Alfred, Jacqueline Cohen, and Daniel Nagin. Deterrence and Incapacitation: Estimating the Effects of Criminal Sanctions on Crime Rates. Washington, D.C.: National Academy of Sciences. 1978.
13. Bowman, Gary W., Simon Hakim, et. al., eds. Privatizing the United States Justice System: Police, Adjudication, and Corrections Services From the Private Sector. Jefferson, N.C.: McFarland Company, Inc. 1992.
14. Boydston, John E., and Michael E. Sherry. San Diego Community Profile, Final Report. Washington, D.C.: Police Foundation. 1975.
15. Brann, Joseph E., and Suzanne Whalley. "COPPS: The Transformation of Police Organizations." Community Oriented Policing and Problem Solving. Sacramento: California Attorney General's Crime Prevention Center. 1992.
16. Brown, Lee P. "Neighborhood-Oriented Policing." American Journal of Police Special Issue 9(3)(1990). Brown, Lee P. Community Policing: A Practical Guide for Police Officials. Perspectives on Policing. Washington, D.C.: U.S. Department of Justice, Office of Justice Programs, National Institute of Justice; and John F. Kennedy School of Government, Harvard University. 1989.
17. Bureau of Justice Statistics. "Prisoners in 1992." Bureau of Justice Statistics Bulletin (May#1992). Bureau of Justice Statistics. The Prosecution of Felony Arrests. Washington, D.C.: U.S. Department of Justice, Office of Justice Programs. 1992.
18. Bureau of Justice Statistics. "State and Local Police Departments, 1990." Bureau of Justice Statistics Bulletin (February 1992).
19. Bureau of Justice Statistics. Sourcebook of Criminal Justice Statistics, 1991.
20. Washington, D.C.: U.S. Department of Justice, Office of Justice Programs. 1992.
21. Bureau of Justice Statistics. Criminal Victimization in the United States, 1991. Washington, D.C.: U.S. Department of Justice, Office of Justice Programs. 1992.
22. C.F. Productions, Inc. Crime File: Drugs, Community Response. Washington, D.C.: U.S. Department of Justice, Office of Justice Programs, National Institute of Justice. 1990.
23. Chamber of Commerce of the United States. Marshaling Citizen Power Against Crime. Washington, D.C. 1970.
24. Chamber of Commerce of the United States. Forward Thrust—A Process for Mobilizing Total Community Resources. Washington, D.C. 1969.
25. Chamber of Commerce of the United States. Developing Voluntary Leadership. Washington, D.C. No Date Given. Chen, M.M. "System Approach of Needs-Oriented Police Planning: An Empirical Study." Police Studies 13(4)(Winter 1990)
26. Clarke, Ronald V. "Situational Crime Prevention: Its Theoretical Bases and Practical Scope." Crime and Justice: An Annual Review of Research 4(1983).
27. Community Patrol Officer Program: A Pilot Program in Community Oriented Policing in the 72d Precinct, Interim Progress Report. New York: Vera Institute of Justice. 1984.
28. Community Policing—Making the Case for Citizen Involvement. Rockville, Md.: Charles Stewart Mott Foundation. 1987.
29. Cordner, Gary W. "Fear of Crime and the Police—An Evaluation of a Fear Reduction Strategy." Journal of

- Police Administration 14(3)(September 1986).
30. Corder, Gary W., and Donna C. Hale, eds. *What Works in Policing: Operations and Administration Examined*. Cincinnati, Ohio: Anderson Publishing Company. 1992.
 31. Couper, David C., and Sabine H. Lobitz. *Quality Policing: The Madison Experience*. Washington, D.C.: Police Executive Research Forum. 1991.
 32. Cox, S.M. "Policing Into the 21st Century." *Police Studies* 13(4)(Winter 1990).
 33. Craven, D. *Oregon Serious Crime Survey: Attitudes About Crime*. Washington, D.C.: U.S. Department of Justice, Office of Justice Programs, National Institute of Justice. 1989.
 34. Criswell, D., and V. King. "Houston's Field Training Practicum." *Field Training Quarterly* 5(2)(Second Quarter 1988).
 35. Cumming, Elaine, Ian Cumming, and Laural Edell. "Policeman as Philosopher, Guide, and Friend." *Social Problems* 12(1965).
 36. Daly, N.C., and P.J. Morehead. *Evaluation of Community Policing: Final Report of the Community Survey and Police Department Internal Survey*. St. Petersburg, Florida: St. Petersburg Police Department. 1992.
 37. Delaware Statistical Analysis Center. *East Side Wilmington Anti-Drug Abuse Program Evaluation*. Rockville, Md.: U.S. Department of Justice, Office of Justice Programs, National Institute of Justice. 1990.
 38. Donovan, E.J., and W.F. Walsh. "Private Security and Community Policing: Evaluation and Comment." *Journal of Criminal Justice*. 17(3)(1989).
 39. Dunham, Roger G., and Geoffrey Alpert, eds. *Critical Issues in Policing: Contemporary Readings*. Prospect Heights, Ill.: Waveland Press Inc. 1989.
 40. Eck, John E., and William Spelman. *Problem Solving: Problem-Oriented Policing in Newport News*. Washington, D.C.: U.S. Department of Justice, Office of Justice Programs, National Institute of Justice; and Police Executive Research Forum. 1987.
 41. Eck, John E., and William Spelman. "Who Ya Gonna Call? The Police as Problem-Busters." *Crime and Delinquency*. 33(1987).
 42. Greene, Jack R., and Stephan D. Mastrofski. *Community Policing: Rhetoric or Reality*. New York: Praeger Publishers. 1988.
 43. Greenwood, Peter W., Jan M. Chaiken, and Joan Petersilia. *The Criminal Investigation Process*. Lexington: DC Heath. 1977
 44. Greenwood, Peter W., and Joan Petersilia. *The Criminal Investigation Process—Volume I: Summary and Policy Implications*. Santa Monica, Calif.: Rand Corporation. 1975.
 45. Gruber, C.A. "Neighborhood Policing." *Law Enforcement Technology*. 19(5)(May 1992). Hall, D.L. "Community Policing: An Overview of the Literature." *Public Policy Report*. 1(1)(June 1990)
 46. Ligj nr.45/ 2019, Për Mbrojtjen Civile, 30.7.2019
 47. Ligj Organik i Buxhetit, nr.57, 02.06.2016
 48. Ligj për Buxhetin e vitit 2020, nr.88, dt. 18.12.2019
 49. Kelling, George L. *Police and Communities: The Quiet Revolution. Perspectives on Policing*. Washington, D.C.: U.S. Department of Justice, Office of Justice Programs, National Institute of Justice; and John F. Kennedy School of Government, Harvard University. 1988.
 50. Kelling, George L. "Acquiring a Task for Order—The Community and Police." *Crime and Delinquency* 33(1) (January 1987)
 51. Tucson Police Department. *Tucson Police Department Enhanced Crime Prevention Program, Final Report*. Tucson, Ariz.: Tucson Police Department. 1991.
 52. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 878, datë 24.12.2019, "Për përbërjen, organizimin e veprimtarive dhe rregullat e funksionimit të KShR"
 53. Wycoff, Mary Ann, Wesley G. Skogan, Anthony M. Pate, and Lawrence W. Sherman. *Police as Community Organizers—The Houston Field Test, Executive Summary*. Rockville, Md.: U.S. Department of Justice, Office of Justice Programs, National Institute of Justice. 1985.
 54. Wycoff, Mary Ann, and Wesley G. Skogan. *Police as Community Organizers—The Houston Field Test, Technical Report*. Washington, D.C.: Police Foundation; and Rockville, Md.: U.S. Department of Justice, Office of Justice Programs, National Institute of Justice. 1985.

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

Ndërtimi i kapaciteteve komunitare si instrument i profilaksisë psikike në fatkeqësitë natyrore



■ **Dr. Elisabeta KAFIA**
Përgjegjëse i Departamentit të Psikologjisë, lektore,
Albanian University, Tiranë
elisabetakafia@yahoo.co.uk



■ **Dr. Silva IBRAHIMI**
Lektore dhe kërkuese shkencore, Departamenti i Psikologjisë,
Albanian University, Tiranë



■ **Dr. Ervin IBRAHIMI**
Responsabile
Sanitario Area Vasta 2
Cooss Marche, Italy

Abstrakt

Ndryshimet e mëdha mjedisore që shkaktojnë mijëra viktime mund të kenë pasojë psikologjike afatgjata. Faktorë të rrezikut të raportuar për shfaqjen e psikopatologjisë së lidhur me ndryshimet e mjedisit përfshijnë nivelin e ekspozimit ndaj ngjarjes, si ekspozimi ndaj dëmtimit aktual ose potencial, afërsia me qendrën e ngjarjes dhe dëmtimi psikologjik ose humbja materiale. Ndër subjektet e prekura nga ngjarjet e 26 Nëntorit 2019, popullata e studiuar me të mbijetuarit familjarë të tërmetit ishin më të cenueshëm se grupet e tjera për shkak të ekspozimit të tyre ndaj skenave të tmerrshme të shkatërrimit, si dhe situatave të tyre drastike të reja të jetesës që vijnë nga kjo lloj fatkeqësie. Procesi i jetës së këtyre të mbijetuarve familjarë pësoi shumë ndryshime që u ndikuan nga një gamë e gjerë faktorësh. Kuptimi i dinamikës dhe mënyrave psiko-sociale të mbështetjes mund të ndihmojë në rritjen e pritshmërive për rezultate efektive dhe planifikimin e ndërhyrjeve në të ardhmen për dukuritë e fatkeqësive natyrore. Përveç kësaj, vëzhgimi familjar pas tërmetit krijon njohuri dhe të kuptuarit e sfidave që korrespondojnë me fatkeqësitë natyrore. Krijimi i një strategjie follow-up për grupet mjedisore në rrezik mund të jetë më tej efektiv në vendimmarrje dhe vendosjen e llojeve të asistencës në rrethana të ngjashme jo vetëm për ekspertët, por edhe për ndërtimin e kapaciteteve të komunitetit, politikat lokale dhe të përshtatura më efektive që mbështesin fuqizimin në shkallë të gjerë.

Fjalëkyçe:

kapacitet komunitar, fatkeqësi natyrore, grupe vulnerabël, strategji ndërhyrjeje, profilaksi psikike

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

1. Hyrje

Ndryshimet e fuqishme natyrore që shkaktojnë mijëra viktima mund të kenë pasoja psikologjike afatgjata. Praktikisht, çdo individ mund të jetë i ekspozuar ndaj së paku një ngjarjeje traumatike në një pikë të caktuar jetësore, qoftë kjo natyrore, të luftës, dhunës, humbjes së një njeriu të dashur etj. (Bonanno, 2004). Një përvojë e tillë është vërejtur në grup-popullatat e shënuara. Faktorë të tjerë rreziku të raportuar zakonisht për psikopatologjinë e lidhur me tërmetin përfshijnë nivelin e ekspozimit ndaj tërmetit, të tilla si ekspozimi ndaj dëmtimit aktual ose të kërcënuar gjatë tërmetit, afërsia me epiqendrën e tërmetit dhe dëmtimi i shtëpisë ose humbje materiale. Ndër subjektet e prekura nga tërmeti i 26 nëntorit 2019 në Shqipëri, të mbijetuarit e tërmetit familjar janë më të prekshëm se grupet e tjera për shkak të ekspozimit të tyre ndaj skenave të tmerrshme të shkatërrimit si dhe situatave të tyre drastike të reja të jetesës që vijnë nga kjo lloj fatkeqësie.

Procesi i jetës së këtyre të mbijetuarve të familjes pëson shumë ndryshime të ndryshme që ndikohen nga një gamë e gjerë faktorësh (Kafia & Ibrahim, 2020). Kriza ndodh kur një individ nuk është në gjendje të përballojë në mënyrë efektive një ngjarjeje stresuese të jetës që perceptohet si një kërcënim (Flannery & Everly, 2000). Homeostaza psikologjike e individit ndërpritet, mekanizmat e tij të zakonshëm të përballimit nuk funksionojnë më për të rivendosur homeostazën psikologjike dhe shqetësimi i mëpasshëm i krizës rezulton në dëmtim më të madh funksional. Ngjarja stresuese e një krize referohet si një “*incident kritik*”, i cili mund të përfshijë aksidente me automjete, fatkeqësi natyrore, luftime ushtarake, sulme seksuale, etj. Thelbësore për punonjësit e shëndetit mendor në emergjencë është potencialiteti që këto incidente kritike të mund të çojnë në një përgjigje ndaj krizës. Ekzistojnë një sërë shqetësimesh psikologjike që një

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

individ mund të përjetojë në këto raste përfshirë: çrregullimin akut të stresit, çrregullimin e stresit posttraumatik, depresionin, ankthin, idetë vetëvrasëse, abuzimin me substancat dhe problemet shëndetësore fizike. Këta individë më pas duhet të kalojnë një proces rikuperimi në mënyrë që të kthehen në funksionimin normal andaj kuptimi i dinamikave dhe formave të mbështetjes psikosociale mund të ndihmojë në rritjen e pritshmërive për rezultate efektive dhe planifikimin e ndërhyrjeve të parandalim-trajtitimit në popullatë.

2. Karakteristikat e fatkeqësive natyrore dhe impakti i tyre psikik

Fatkeqësitë natyrore kanë karakteristika të ndryshme dhe mund të ndryshojnë në vartësi të variabëlve ndikues të tyre. Për shembull, fillimi dhe kohëzgjatja e një përmbytjeje është shumë e ndryshme nga ajo e një thatësire. Mjafton të kujtojmë këtu përmbytjet masive që ndodhen në Rajonin e Marcheve në Itali në fund të Shtatorit 2022 (Senigalia) ku mjaftuan vetëm 3 minuta për të përpirë çdo infrastrukturë a ndërtim të bërë në qindra vjet! Po kështu, ashpërsia e katastrofës mund të ndryshojë shumë edhe brenda të njëjtit lloj; d.m.th., një tërmet si ai që goditi Shqipërinë më 2019 është krejtësisht i ndryshëm nga tërmeti i ndodhur disa javë më parë në Tiranë. Edhe shenjat e paralajmërimit të hershëm mund të ndryshojnë gjithashtu. Fatkeqësitë natyrore përfshijnë përmbytjet masive, cunamet, uraganet, thatësitat, tërmetet, zjarret në pyje dhe shpërthimet vullkanike, rrëshqitjet e dherave etj. Pavarësisht tipologjisë së fatkeqësive, reagimet ndaj tyre priren të jenë në një linjë fazash të caktuara (*Reagimet e shëndetit mendor ndaj fatkeqësive natyrore*, 2000). Njohja e tyre është veçanërisht e rëndësishme për punonjësit e ndihmës së shpejtë të emergjencave dhe triazhistin, në mënyrë që të vlerësojë saktë dhe të ndihmojë të mbijetuarit siç duhet.

Në fazat e evolucionit të fatkeqësive natyrore përfshihen:

a. *Faza e Paralajmërimit ose kërcënuese.* Format e shenjave paralajmëruese ndryshojnë nga tipologjia e fatkeqësisë. Për shembull, tërmetet zakonisht nuk japin asnjë paralajmërim edhe pse sot pretendohet se ekzistojnë aplikacione të afta për të vënë në parapritë njerëzit. Në këto raste, të mbijetuarit mund të ndihen të pasigurt, të shqetësuar, konfuzë, të frikësuar nga tragjeditë e ardhshme dhe mbi të cilat ata nuk kanë më asnjë kontroll. Ata mund të ndihen të paaftë për të mbrojtur veten, të dashurit dhe shtëpinë e tyre. Nga ana tjetër, ata që nuk i kanë marrë seriozisht shenjat paralajmëruese mund të ndjehen përgjegjës për dëmin e shkaktuar dhe mund të përjetojnë ndjenjat të fajit dhe të turpit.

b. *Faza e impaktit.* Ngjashëm me fazën e paralajmërimit dhe kërcënimit, faza e impaktit ndryshon në varësi të vetë fatkeqësisë. Mund të variojë nga një grumbullim i ngadalshëm, gradual, me rrezik të ulët (p.sh., thatësira dhe përmbytje) në një ndryshim të papritur, të dhunshëm dhe me kërcënim të lartë (p.sh., shpërthime dhe cunami). Të mbijetuarit mund të ndihen të tronditur, të paralizuar, të pafuqishëm dhe të çorganizuar.

c. *Faza e shpëtimit ose heroike.* Menjëherë pas fazës së impaktit, një nivel i lartë energjie dhe adrenaline përdoret nga trupi ynë për mbijetesë, për shpëtim, për gjetjen e strehimit, riparimin dhe pastrimin e dëmeve. Ky aktivitet tenton të zgjasë diku nga disa orë deri në disa ditë. Kur të mbijetuarit përballen me ndarje nga familja për shkak të evakuimeve, kufizimeve të strehimit ose faktorëve të tjerë, mund të pasojnë reaksione posttraumatike qoftë akute dhe të shëndetit mendor. Megjithatë, altruizmi dhe sjellja

prosociale janë të larta ndërmjet të mbijetuarve dhe punonjësve të ndihmës së parë.

d. Faza e zgjidhjes ose e “muajit të mjalitit”. Për shkak të fluksit të ndihmës dhe burimeve nga qeveria dhe punëtorët vullnetarë, lidhja e komunitetit dhe optimizmi i të mbijetuarve është i lartë. Grupet spontane ndërtohen kur të mbijetuarit ndajnë përvojën e fatkeqësisë me njëri-tjetrin. Të mbijetuarit bëhen shumë shpresëdhënës dhe besojnë se jeta dhe komuniteti i tyre do të rikuperohen dhe do të kthehen shpejt në kohën e mëparshme. Punonjësit e ndihmës së parë dhe punonjësit e shëndetit mendor në fatkeqësi gjatë kësaj faze pranohen më lehtë kur janë të dukshëm dhe perceptohen si të dobishëm. Kjo fazë është veçanërisht e rëndësishme në krijimin e raportit dhe një themeli në të cilin mund të ndihmohet në mënyrë më efektive në fazat e vështira të rehabilitimit psikik që do të pasojnë.

e. Faza e “bërjes së inventarit”. Me kalimin e kohës, të mbijetuarit fillojnë të kuptojnë kufijtë e burimeve në dispozicion. Shpresa se shtëpitë dhe jetët e tyre do të rikthehen shpejt dhe pa komplikime zëvendësohet me rraskapitje fizike. Të mbijetuarit lodhen dhe dekurajohen nga kërkesat e mëdha të jetës, situatat financiare, rindërtimi dhe restaurimi. Kjo çon shpejt në fazën tjetër të zhgënjimit.

f. Faza e zhgënjimit. Me fillimin e lodhjes dhe njohjen e gjithçkaje që duhet bërë për restaurimin, fillon zhgënjimi. Realiteti i financave, humbjeve, politikës, zhvendosjes dhe ndihmës së disponueshme bëhen të pashmangshme. Përveç kësaj, ndjenjat e braktisjes, pakënaqësisë dhe padrejtësisë mund të lindin kur ndihma e qeverisë dhe vullnetarët tërhiqen. Në këtë kohë gjithashtu, kohezioni i komunitetit që u formua në fazën muajit të mjalitit mund të fillojë të shpërthejë pasi kompensimet monetare në dukje të pabarabarta krijojnë pakënaqësi. Po kështu mund të shfaqen pakënaqësitë për abuzimet e mundshme që mund të ndodhin nga individë të caktuar.

g. Faza e rindërtimit ose e rikuperimit. Në këtë fazë, të mbijetuarit fillojnë të kuptojnë se janë ata që do të jenë përgjegjës për rindërtimin e shtëpive dhe jetës së tyre. Në këtë kohë, ndryshimet bëhen të dukshme me zhvillimin e procesit të rindërtimit. Një pjesë e individëve janë në gjendje të rifillojnë nivelin e tyre të mëparshëm të funksionimit edhe pas një periudhe të përkohshme shqetësimi. Por, shumë të tjerë mbeten të ngecur brenda kufijve të gjykimit të lidhur me tragjedinë.

3. Ndërtimi i kapaciteteve njerëzore mbi vlerësimin e nevojave të komunitetit, kujdesit dhe mbështetjes në rastet e fatkeqësive natyrore

Ndërtimi i kapaciteteve komunitare (*community building*) është synim përfundimtar i institucioneve publike dhe jo-publike, të cilat aktivizojnë shërbime, rregulla, mekanizma rishpërndarës për t’iu përgjigjur nevojave individuale dhe kolektive, me qëllimin për të qenë në gjendje të ndërtojnë shoqërinë (Kafia & Ibrahim, 2021). Ndërtimi i kapaciteteve komunitetit pasqyron orientimin për të cilin subjektet që i përkasin një komuniteti marrin përsipër të veprojnë së bashku në procesin e evolucionit të vetë komunitetit (Blackwell & Colmenar, 2000; Ealter, 2004). Logjika e ndërtimit të komunitetit synon të eksperimentojë forma të pjesëmarrjes aktive të aktorëve të fushave të ndryshme (publike, private, qytetarë individualë, etj.), që synojnë inovacionin e politikave publike dhe favorizimin e proceseve kolektive, nëpërmjet formave aktive të pjesëmarrjes së komuniteteve lokale. Kjo pjesëmarrje lejon krijimin e shtigjeve të strukturuar të

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

fuqizimit të komunitetit, të cilat shpresojmë se synojnë të rivendosin lidhjet e besimit, ndarjes, duke supozuar një perspektivë që shkon përtej interesit individual. Në *community building*, të dy aktorët, sistemet e rregullave dhe logjika e veprimit janë të përziera (Brennan et al, 2012; Razavi 2007; Fisher & Tronto 1990).

Sipas veçorive të vendit ku formohen, parimet bazë të ndërtimit të kapitalit komunitar janë: i) forcimi i komuniteteve në mënyrë tërësore; ii) ndërtimin e kapaciteteve dhe marrëdhënieve lokale ndërmjet komuniteteve dhe institucioneve burimore; iii) promovimi i pjesëmarrjes së komunitetit në zhvillimin dhe zbatimin e politikave; iv) trajtimi i problemeve të minoriteteve të mundshme për të krijuar mundësi të barabarta për të gjitha grupet; v) përfshirja e komuniteteve të varfra; vi) përshtatja e programeve me gjendjen lokale; vii) ndërtimi i mekanizmave të llogaridhënies për të ruajtur përmirësimet dhe monitoruar progresin e komunitetit (Blackwell & Colmenar, 2000). Komunitetet dëshirohen të pasura me kapital social, në procese gjeneruese dhe gjithëpërfshirëse, në marrëdhënie, të afta për të nxitur kulturën dhe rritjen e individëve dhe të komunitetit, efektive për të ndihmuar më të dobët dhe për të promovuar ata që kanë potencial të pashprehur plotësisht, në një optikë barazie dhe për rrjedhojë të forcimit të bashkëjetesës së bashku.

Në proceset e transformimit social dhe ekonomik që po zhvillohen prej më së tri dekadash në realitetin shqiptar, ka disa përcaktues negativë (problematika të cilat duhen trajtuar nga politik-bërja) dhe disa pozitivë që kërkojnë një qendër të re të misionit të ndërtimit të komunitetit për institucionet publike dhe jo-publike. Të dhënat empirike kanë treguar prej vitesh se një shoqëri është më elastike dhe me ritme më të larta zhvillimi ekonomik dhe resilient kur rritet kapitali i saj social dhe veprues. Shumë nga vendet rreth nesh, duke përfshirë edhe vendin tonë, janë në një fazë të reduktimit progresiv të kapitalit social të disponueshëm, prandaj lind nevoja për të aktivizuar politika publike të afta për ta thyer këtë prirje dhe për rrjedhojë për të ndërtuar komunitete. Shoqëritë tona janë gjithnjë e më të paeukuilbruara, proces ky që përcakton rritjen e problemeve sociale, krimanilitetin dhe uljen e kohezionit kolektiv.

Ndërtimi i komunitetit shihet si një perspektivë e aftë për të reduktuar disa nga këto plagë, nëse shoqërohet me procese të reduktimit progresiv të pabarazive sociale. Shëndeti publik në kohën tonë vë në pah qasjet për angazhimin e komunitetit në promovimin e shëndetit dhe parandalimin e sëmundjeve. Integrimi i vullnetarëve, specialistëve dhe organizatave të financuara në mënyrë të pavarur me disa aspekte të ofrimit të shërbimeve shëndetësore ka forcuar konceptin e nismave komunitare në rastin e tërmetit të 2019 në Shqipëri. Kjo qasje dalluese pranon se shëndeti drejtohet nga faktorë të shumtë, me ndikime të ndërlydhura kulturore, ekonomike, sociale dhe mjedisore, të cilat janë të vështira për t'u kuptuar dhe trajtuar në mënyrë gjithëpërfshirëse. Ekziston një rrjedhë në rritje e kërkimeve që dokumentojnë një marrëdhënie të drejtpërdrejtë midis kapitalit social dhe iniciativave që angazhohen në komunitet (Igalla et al, 2020; Newman et al, 2008), në të cilat rrjetet sociale konceptohen si një përcaktues kryesor i mirëqenies së komunitetit.

Në këtë kuadër, angazhimi i komunitetit është një strategji thelbësore për promovimin e shëndetit dhe parandalimin e sëmundjeve në nivele të shumëfishta (në rrafsh individual, familjar, komunitar), në shumë sektorë (p.sh. shkolla, vendi i punës, lagje) dhe brenda rrjeteve shumëdimensionale (individuale, profesionale, sociale etj.). Megjithatë, aktualisht, përcaktimi i karakteristikave dhe efektivitetit të iniciativave që përfshijnë komunitetin për të arritur rezultate shëndetësore paraqet sfida si në nivelin e

kërkimit ashtu edhe për politikëbërësit.

4. Nevoja për forcimin e reziliencës komunitare: ndihma e parë psikologjike

Një pjesë e individëve në komunitete që përjetojnë ngjarje të natyrës kritike kanë qëndrueshmërinë e nevojshme për ti përballuar ato me pak ose aspak disfunktionalitet psikosocial (Bonanno, 2004). Megjithatë, të tjerë kalojnë një periudhë të vështirë ku përballen me psikopatologji të tilla si depresioni, ankthi, çrregullimi i stresit posttraumatik ose çrregullimet e kontrollit (Ruzek, et al., 2007; Bolton et al., 2004; Joshi & O'Donnell, 2003). Janë më të shpeshta rastet ku organizatat jo-qeveritare që ofrojnë shërbime mjekësore emergjente; qasje në ujë dhe ushqim të pastër; strehimoret emergjente ose strehimoret kalimtare dhe furnizime të ndryshme të materialeve bazë (Kryqi i Kuq Shqiptar, 2019). Organizma të tjerë që ofrojnë këshillim të specializuar mund të sjellin “mbështetje shpirtërore dhe emocionale”.

Individët dhe organizatat e përfshira në ndihmën ndaj fatkeqësive, punën me ndihmat në nivele lokale dhe punën me ndihmat në nivel ndërkombëtar mund të mos jenë të vetëdijshëm për efektet e traumës dhe ndërprerjet e përkohshme në funksionimin normal që mund t'i lënë vendin psikopatologjisë së vërtetë të individët e përfshirë në fatkeqësi. Kjo përbën një tematikë shqetësuese pasi ata vijnë në kontakt me individë që kanë përjetuar situata traumatike. Për t'iu përgjigjur këtyre kërkesave, në vitin 2007 Rrjeti Kombëtar i Stresit Traumatik të Fëmijëve dhe Qendra Kombëtare për PTSD në SHBA bashkëpunuan së bashku duke përdorur konsultime nga profesionistë të reagimit ndaj fatkeqësive dhe krijuan një *Udhëzues të Operacioneve në Terren për Ndhimë e Parë Psikologjike* (PFA) (Ruzek et al., 2007).

PFA shërben si një udhëzues i gërshtuar nga të dhënat studimore në terren në rastet e fatkeqësive të ndryshme natyrore dhe është azhurnuar për t'u zbatuar në mjedise në terren; ai mbulon gamën e plotë të zhvillimit dhe trajton çështjet me ndjeshmëri si nga ana kulturore dhe të vulnerabilitetit të personave. Edhe pse nuk është studiuar në mënyrë sistematike, ajo mund të shërbejë për të ndihmuar të mbijetuarit e traumës. PFA është përshkruar qoftë si ndërhyrje klinike qoftë si grup aktivitetesh që mund të kryhen nga persona joklinikistë (Reyes & Jacobs, 2006). Ky udhëzues mund të jetë një aset i vlefshëm për trajnimin e vullnetarëve dhe punëtorëve që të njihen me bazat e ofrimit të lehtësimit psikologjik.

Ruzek et al. (2007) përshkruan karakteristikat kryesore të PFA si vijon: a) kontakti dhe angazhimi; b) mbajtja e sigurisë dhe komoditeti; c) stabilizimi; d) mbledhja e informacionit mbi nevojat dhe shqetësimet aktuale; e) asistencë praktike; f) lidhja me mbështetjen sociale; g) dhënie e informacionit mbi mbështetjen dhe përballimin dhe h) lidhjen me shërbimet e tjera bashkëpunuese. Para se të ndërmerren këto drejtime veprimi, autorët kanë vënë në dukje rëndësinë e hyrjes në vendin e ngjarjes në mënyrë të qetë dhe të grumbulluar jo më vonë se 2 orë pas ngjarjes. Ofruesi i PFA duhet të mësojë sa më shumë që të jetë e mundur për vendosjen, shërbimet, burimet e disponueshme, politikat, procedurat e organizimit, natyrën e ngjarjes, etj. Më pas ai duhet të identifikojë individët që shfaqin veçanërisht shenja të turbullimit akut psikologjik si p.sh. individët që janë tejet të tërhequr, të hutuar, të zemëruar, impulsivë, me shfaqje të papërshtatshme të afektit etj. Përveç kësaj, duhet të identifikohen edhe grupet me potencial të rrezikut si fëmijët, ata me aftësi të kufizuara fizike, ata me sëmundje të

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

rënda mendore, nënat me foshnja të vogla, nënat shtatzëna dhe personat që e kanë përjetuar traumën në linjën e parë.

5. Udhëzues IASC për profilaksinë e shëndetit mendor në ndërhyrjet e targetuara Komunitare

Ky udhëzues ka për qëllim të ndihmojë ekipet e emergjencës në terren, aktorët humanitarë dhe komunitetet për të planifikuar, vendosur dhe koordinuar një sërë reagimesh ndërsektorale për të mbrojtur aspektet e shëndetit mendor dhe mirëqenien pskosociale në ngjarjet emergjente (Kafia & Ibrahim, 2021).

Implementimi i tij në terren kërkon bashkërendimin e të gjitha strukturave komunitare dhe jo vetëm, për realizimin efektiv të tyre.

IASC mbështetet në *disa parime* thelbësore:

1. *respekti* për të drejtat dhe dinjitetin e njeriut; ekipet e ndihmës respektojnë dhe promovojnë përmes psikoedukimit të drejtat themelore të njeriut për barazi, mosdiskriminim dhe të identifikojnë grupet e rrezikuara që mund të jenë vulnerabël;

2. *pjesëmarrja* e sa më shumë individëve nga komuniteti i prekur drejtpërdrejtë nga fatkeqësia;

3. *Primus, non nocere!* reduktimi i rrezikut për dëmtime përmes fokus grupeve të psikoedukimit ku të mësohen pjesëmarrësit për përgjigjet e sinqerta që duhet të raportojnë; krijimi i ndërhyrjeve sipas informacionit të mbledhur; kryerja e vlerësimit\diagnozës edhe me bashkëveprim të aktorëve të jashtëm; zhvillimi i kapaciteteve njerëzore në bazë të specifikave kulturore dhe krijimi i rrjeteve të mbështetjeve me komunitetin jashtë individëve të prekur drejtpërdrejtë nga fatkeqësia;

4. *ndërtimi i kapaciteteve njerëzore lokale*, qoftë me strukturat administrative qoftë vullnetare;

5. *krijimi i një strukture multidisiplinare* që mund të trajtojë problematika të ndryshme njëkohësisht. Fillohet me identifikimin e nevojave Bazë (fizike dhe psikologjike), Mbështetja nga komuniteti dhe familja për individët që mund ti përdorin këto burime (si p.sh. mbajtja e komunioneve fetare, mbështetja në ceremoni mortore etj.), në shtresën e tretë përfshihen ndërhyrjet jo të specializuara dhe të fokusuara (p.sh. viktimat e dhunës) dhe në fund janë *shërbimet e specializuara* kur nevojat e individëve tejkalojnë burimet e ekipeve të emergjencës.

6. Përfundime

Vëzhgimi i pasojave të ngjarjeve me karakter shkatërrues në komunitet jep padyshim dije dhe të kuptuar mbi sfidat që lidhen me fatkeqësitë natyrore dhe format e përballimit të tyre. Pasja e një strategjie të ndjekjes hap-pas-hapi (*follo2-up*) për këtë grup mund të jetë efektive në vendosjen e politikave sociale, shëndetësore dhe ekonomike më të mira dhe vendosjen e tipologjive të asistencës në të njëjtat rrethana jo vetëm për ekspertët, por edhe për ndërtimin e burimeve komunitare në terren dhe në konstruktin e politikave lokale të synuara si më efektive. Për këtë arsye, personalet e përfshira në punën e ndihmave materiale dhe ndihmës njerëzore në fatkeqësi, si vendas ashtu edhe ndërkombëtarë, duhet të trajnohen dhe të pajisen me bazat e ndihmës së parë psikologjike. Më pas ata duhet të trajnohen për të ofruar lehtësim për ata me shqetësime psikologjike dhe për të ndihmuar në procesin e rimëkëmbjes në plane të trajnimit në vazhdim.

Referenca

1. Blackwell, A.G., Colmenar, R.A. (2000). Community building: from local wisdom to public policy. *Public Health Rep.* 115:161–66
2. Bolton, D., Hill, J., O’Ryan, D., Udwin, O., Boyle, S., & Yule, W. (2004). Long-term effects of psychological trauma on psychosocial functioning. *Journal of Child Psychology and Psychiatry*, 45(5), 1007-1014. doi:10.1111/j.1469-7610.2004.t01-1-00292.x
3. Bonanno, G. (2004). Loss, Trauma, and Human Resilience: Have We Underestimated the Human Capacity to Thrive After Extremely Aversive Events?. *American Psychologist*, 59(1), 20-28. doi:10.1037/0003-066X.59.1.20
4. Brennan D, Cass B., Himmelweit S., Szebehely M. (2012). The Maketization of care: Rationales and Consequences in Nordic and liberal care regimes, *Journal of European Social Policy*, 22, 4, pp. 377–39
5. Disaster mental health response handbook. (2000) përkth. *Reagimet e shëndetit mendor ndaj fatkeqësive natyrore* Parramatta, BC: State Health.
6. Fisher, B., Tronto, J. (1990). Toward a feminist theory of caring. *Circles of Care: Work and Identity in Women's Lives*, 35-62.
7. Flannery, R. B., & Everly, G. S. (2000, Spring). Crisis intervention: A review. *International Journal of Emergency Mental Health*, 2(2), 119-125. <http://cism.cap.gov/files/articles/Crisis%20Intervention%20-%20A%20Review.pdf>
8. Igalla, M., Edelenbos, J., Van Meerkerk, I. (2020). What explains the performance of community-based initiatives? Testing the impact of leadership, social capital, organizational capacity, and government support. *Public Management Review*, 22:4, 602-632, DOI: 10.1080/14719037.2019.1604796
9. Joshi, P., & O'Donnell, D. (2003). Consequences of child exposure to war and terrorism. *Clinical Child and Family Psychology Review*, 6(4), 275-292. doi:10.1023/B:CCFP.0000006294.88201.68.
10. Kafia, E. & Ibrahim, S. (2021) Development of operational capacities and increase of competencies in assessing and managing the psychosocial needs of vulnerable communities in cases of natural disasters for Staff Managing directors at Central and Local Administrative level, *Workshop Trajnimi për Rimëkëmbjen dhe Reziliencën nga Tërmeti*
11. Kafia, E. & Ibrahim, S. (2021) Facility on developing strategies and establishing Action Plans for Local Government unit staff to assess and manage the needs of vulnerable communities in cases of natural disasters, *Workshop Trajnimi për Rimëkëmbjen dhe Reziliencën nga Tërmeti*
12. Kryqi i Kuq Shqiptar (2022) Programet e shërbimit të trajnimit të ndihmës së parë <https://www.kksh.org.al/programet/programi-i-sherbimit-te-trajnimit-te-ndihmes-se-pare/>
13. Newman, L., L. Waldron, A. Dale, K. Carriere. (2008). Sustainable Urban Community Development from the Grassroots: Challenges and Opportunities in a Pedestrian Street Initiative. *Local Environment* 13 (2): 129–139. doi:10.1080/13549830701581879.
14. Razavi, S. (2007). The political and social economy of care in a development context. Conceptual issues, research questions and policy options. *Trabajo y empleo*.
15. Reyes, G., & Jacobs, G. A. (2006). Psychological First Aid: Principles of Community Based Psychosocial Support. Në R. Gilbert, *Handbook of International Disaster Psychology: Vol. 2. Practices and Programs* (pp. 1-12). Westport, Connecticut: Praeger Perspectives
16. Ruzek, J., Brymer, M., Jacobs, A., Layne, C., Vernberg, E., & Watson, P. (2007). Psychological First Aid. *Journal of Mental Health Counseling*, 29(1), 17-49.

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

Si e forcojnë qëndrueshmërinë e komunitetit, reagimet e firmave, ndaj fatkeqësive natyrore



■ **Dr. (proc.) Anisa HYESANI**
*Qendra e Kërkimeve Shkencore,
Akademia e Sigurisë
anisa.hysesani@asp.gov.al*



■ **MSc. Erida LILE**
Psikologe klinike

Abstrakt

Fatkeqësitë natyrore sfidojnë qëndrueshmërinë e një komuniteti. Hulumtimet e mëparshme për elasticitetin e komunitetit janë fokusuar kryesisht në përgjigjet e enteve publike, si shërbimet e urgjencës dhe agjencitë qeveritare. Megjithatë, firmat fitimprurëse janë gjithashtu të angazhuara në reagimin ndaj fatkeqësive natyrore. Ky punim eksploron dy aspekte se si firmat marrin pjesë në ndërtimin e qëndrueshmërisë së komunitetit ndaj fatkeqësive natyrore: Së pari, artikulli sintetizon kërkimin mbi menaxhimin e vazhdimësisë së biznesit, filantropinë e korporatave dhe provat në zhvillim që firmat angazhohen në biznesin e reagimit ndaj fatkeqësive në një tipologji koherente për reagimet e firmave fitimprurëse ndaj fatkeqësive natyrore. Së dyti, punimi bazohet në teorinë e palëve të interesuara për të bërë dallimin midis firmave që adoptojnë qëndrime të përqendruara te firma (të fokusuara nga brenda në rezultatet e firmës) kundrejt firmave që adoptojnë qëndrime të përqendruara në komunitet (të fokusuara nga jashtë te palët e interesuara), në lidhje me reagimin ndaj fatkeqësive natyrore.

Fjalëkyçe:

fatkeqësitë, vazhdimësia e biznesit, filantropia e korporatës, fatkeqësitë natyrore, komuniteti, tipologjia, moti ekstrem, reagimi ndaj fatkeqësive

1. Hyrje

Fatkeqësitë natyrore si uraganet, stuhitë dhe përmbytjet sfidojnë gjithnjë e më shumë komunitetet. Në mbarë botën, kostoja financiare e rindërtimit pas fatkeqësive natyrore është rritur në mënyrë të qëndrueshme gjatë dy dekadave të fundit. Qëndrueshmëria e komunitetit pasqyron aftësinë e një komuniteti për t'i bërë ballë fatkeqësive dhe për të "rikthyer" funksionimin normal pas vështirësive të konsiderueshme. Në këtë kontekst, elasticiteti nuk i referohet një ekuilibri statik, por i qëndrueshmërisë së marrëdhënieve midis aktorëve kryesorë të komunitetit përballë katastrofës. Komunitetet elastike parashikojnë, përgatiten, reagojnë ndaj dhe rikuperojnë nga fatkeqësitë dhe kthehen në një trajektore pozitive pas vështirësive thelbësore. Historikisht, organizatat e sektorit publik kanë qenë përgjegjëse për t'iu përgjigjur fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera. Rezistenca e komunitetit pas fatkeqësive mbështetet në efektivitetin e këtyre organizatave të ndryshme. Megjithatë, pas fatkeqësive të ndryshme të shumta të ndodhura, shumë më tepër vëmendje i është kushtuar mënyrës sesi sektori privat reagon ndaj fatkeqësive natyrore. Për shembull, në rastin e tërmetit në Shqipëri të vitit 2019, biznese të ndryshme, ofruan ushqim, pije, strehim falas etj. Gjithnjë e më shumë, firmat private dhe sektori fitimprurës luajnë një rol të rëndësishëm në një qasje "të gjithë komunitetit" për menaxhimin e emergjencave. Përveç kësaj, ofruesit privatë të infrastrukturës kanë fituar rëndësi në reagimin ndaj fatkeqësive. Në këtë mënyrë, reagimet e sektorit privat ndaj fatkeqësive ndërthuren me qëndrueshmërinë e komunitetit. Roli i qeverisë është bërë më shumë për mbikëqyrjen dhe koordinimin e rrjeteve të shumta të infrastrukturës kritike, edhe pse roli publik-privat ka diskutime për mënyrën e ndarjes së përgjegjësisë.

Edhe pse sektori privat tani ka një rol shumë më të fortë për t'iu përgjigjur fatkeqësive,

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

kërkimi ekzistues i qëndrueshmërisë së komunitetit mbetet i fokusuar në institucionet e sektorit publik, si agjencitë qeveritare dhe shërbimet e urgjencës Shumica e kërkimeve mbi reagimet e firmave ndaj fatkeqësive natyrore priren të jenë në nivelin e firmës, pavarësisht nevojës për një qasje sistematike ndaj marrëdhënieve midis firmave dhe palëve të interesuara të komunitetit, veçanërisht në kontekstin e fatkeqësive. Megjithatë, deri më sot, literatura e palëve të interesuara i ka kushtuar pak vëmendje nivelit të analizës së komunitetit dhe pyetjes sesi firmat kontribuojnë në qëndrueshmërinë e komunitetit. Ky është një qëndrim kritik, veçanërisht në kontekstin e fatkeqësive natyrore si tërmetet dhe përmbytjet që prekin një seksion heterogjen të firmave, qeverive, organizatave jofitimprurëse dhe anëtarëve të komunitetit. Ky punim bazohet në teorinë e palëve të interesuara për të kuptuar sesi përgjigjet e qëndrueshme ndaj fatkeqësive natyrore kontribuojnë në qëndrueshmërinë e komunitetit.

Në atë që vijon, diskutohen kërkimet e mëparshme mbi (a) qëndrueshmërinë e komunitetit dhe (b) përgjigjet e vendosura ndaj fatkeqësive natyrore. Më pas, punimi mbështetet në teorinë e palëve të interesuara për të ndërtuar një kornizë që lidh përgjigjet e qëndrueshme ndaj fatkeqësive natyrore me rezultatet e elasticitetit të komunitetit. Përgjigjet e vendosura ndryshojnë midis qëndrimeve të përqendruara te firma të fokusuar nga brenda në rezultatet e firmës, dhe qëndrimet në qendër të komunitetit të fokusuar nga jashtë në një bazë më të gjerë të palëve të interesuara publike dhe private. Punimi, ofron një kornizë për të shpjeguar marrëdhënien midis këtyre llojeve të ndryshme të reagimeve të firmave ndaj fatkeqësive natyrore dhe qëndrueshmërisë në nivelin e analizës së firmës dhe komunitetit. Për më tepër, ky punim përshkruan marrëdhëniet e rëndësishme midis qëndrueshmërisë së firmës dhe komunitetit. Duke përdorur këtë kuadër, argumentohet se firmat e orientuara drejt aktorëve të komunitetit do të ndikojnë më pozitivisht dhe drejtpërdrejt në elasticitetin e komunitetit. Hulumtimi ynë kontribuon në teorinë e palëve të interesuara, veçanërisht në nivelin e analizës së komunitetit. Ne përfundojmë duke përshkruar drejtimet e kërkimit të ardhshëm.

2. Qëndrueshmëria e komunitetit

Koncepti i elasticitetit është gjithnjë e më i zakonshëm në fusha të ndryshme si psikologjia (Margolis & Stoltz, 2010), inxhinieria (Hollnagel, Woods, & Leveson, 2006) dhe menaxhimi i sistemeve social-ekologjike (Gunderson & Holling, 2002). Në mënyrën më rudimentare, elasticiteti i referohet aftësisë për t'u rikthyer nga fatkeqësia. Interesi ynë qëndron në qëndrueshmërinë e komunitetit. Komunitetet zakonisht ndajnë një gjeografi të përbashkët dhe, si rezultat, ndajnë gjithashtu një fat të përbashkët, Cutter et al. (2008) për një komunitet si "tërësia e ndërveprimeve të sistemit shoqëror brenda një hapësire të përcaktuar gjeografike" (f. 599). Elasticiteti i komunitetit, duhet konsideruar si një konstrukt të orientuar drejt procesit, i cili pasqyron mënyrën se si komunitetet trajtojnë fatkeqësitë dhe kthehen në funksionimin "normal" pas katastrofës. Ky artikull fokusohet në fatkeqësitë në formën e fatkeqësive natyrore. Krahasuar me komunitetet e tjera në rrethana të ngjashme, komunitetet më elastike janë më të afta t'i rezistojnë dhe t'i përgjigjen fatkeqësive, të matura në terma më pak humbje jete, qëndrueshmëri ekonomike dhe infrastrukturë.

Hulumtimi i qëndrueshmërisë së komunitetit ka identifikuar kapitale të ndryshme që ndihmojnë komunitetet, qoftë duke reduktuar cenueshmërinë e komunitetit ose duke rritur qëndrueshmërinë e komunitetit, duke përfshirë kapitalin social, kapitalin

ekonomik, kapitalin natyror dhe kompetencën e komunitetit (Cutter et al., 2008; Mayunga, 2007; Norris et. al., 2008). Kapitali social i referohet normave të mbështetjes sociale dhe besimit midis anëtarëve të komunitetit që nxisin një ndjenjë të komunitetit dhe lehtësojnë koordinimin dhe aksesin në burime. Kapitali ekonomik i referohet niveleve të të ardhurave, kursimeve, punësimit, si dhe shkallës në të cilën diversiteti dhe barazia ndikojnë në cenueshmërinë ndaj fatkeqësive natyrore. Kapitali natyror i referohet stokut të aseteve të ekosistemit të një komuniteti. Së fundi, kompetenca e komunitetit i referohet organizimit të komunitetit, partneriteteve politike dhe cilësisë së jetës (Cutter et al., 2008; Mayunga, 2007; Norris et al., 2008). Për rrjedhojë, qëndrueshmëria e komunitetit nuk qëndron vetëm në sistemet fizike dhe infrastrukturën, por edhe në aktorët e komunitetit, rrjetet sociale dhe institucionet publike (Zyra e Kombeve të Bashkuara për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë, 2012).

Sektori privat tani luan një rol të rëndësishëm në reagimin ndaj fatkeqësive natyrore, megjithatë literatura mbi qëndrueshmërinë e komunitetit ende fokusohet kryesisht në organizatat e sektorit publik si shërbimet e urgjencës dhe agjencitë qeveritare (p.sh., Bruneau et al., 2003; Norris et al., 2008). Literatura i ka kushtuar pak vëmendje rolit të firmave, pavarësisht se ato janë qendrore për shumë prej kapaciteteve të kërkuara nga komunitetet elastike. Termi elasticitet është përdorur në nivel firme për të përshkruar karakteristikat e atyre firmave që janë në gjendje të përgjigjen më shpejt, të rimëkëmben më shpejt ose të zhvillojnë mënyra më të mira për të bërë biznes nën detyrim se të tjerët. Megjithatë, lidhjet e qarta midis elasticitetit në nivel firme dhe qëndrueshmërisë në nivel komuniteti mbeten të paeksploruara, edhe pse firmat janë të ndërthurura me flukset e prodhimit dhe konsumit të komunitetit përmes zinxhirëve të furnizimit, funksioneve kryesore të qeverisjes, ndikimit të tyre në dinamikën sociale (p.sh., tendencat e konsumatorit). dhe rolin e tyre në ndërtimin dhe menaxhimin e shumicës së infrastrukturës kritike të shoqërisë sonë. Me rritjen e intensitetit dhe frekuencës së fatkeqësive natyrore, është koha të merret parasysh roli i firmave si në reagimin ndaj fatkeqësive ashtu edhe në ndërtimin e qëndrueshmërisë së komunitetit.

3. Përgjigjet e nivelit të firmës ndaj fatkeqësive natyrore

Një firmë vihet në rrezik të konsiderueshëm kur infrastruktura, pajisjet dhe inventarët e saj shkatërrohen dhe operacionet e saj ndërpriten. Literatura ekzistuese mbi përgjigjet e forta ndaj natyrore Prandaj fatkeqësitë prirën të adresojnë (a) menaxhimin e vazhdimësisë së biznesit, duke përfshirë menaxhimin e rrezikut dhe fatkeqësive ose (b) përgjigjet e korporatave filantropike ndaj fatkeqësive natyrore dhe përfitimet e tyre të mëvonshme në reputacion dhe ato financiare. Përveç këtyre rrjedhave kërkimore, ka prova që firmat angazhohen në biznesin e reagimit ndaj fatkeqësive (p.sh., operacionet e shpëtimit të të dhënave) dhe përfitojnë nga mundësitë e tjera për të kapur biznese të reja (p.sh., shërbimet e rimëkëmbjes pas fatkeqësive), të përmirësojnë reputacionin e korporatës dhe të forcojë marrëdhëniet ekzistuese të palëve të interesit.

3.1. Menaxhimi i vazhdimësisë së biznesit

Menaxhimi i vazhdimësisë së biznesit i referohet “aftësisë së organizatës për të vazhduar ofrimin e produkteve ose shërbimeve në nivele të pranueshme pas një incidenti përçarës”

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

.Me fjalë të tjera, një firmë demonstroi vazhdimësi biznesi nëse - gjatë gjithë ndërprerjes - ajo ruan rrjedhat e të ardhurave, siguron punësim, adreson nevojat e klientëve dhe ruan besimin e aksionarëve, klientëve, punonjësve dhe publikut në përgjithësi (Castillo, 2004). Ekziston një literaturë e konsiderueshme mbi menaxhimin e vazhdimësisë së biznesit. Temat kryesore të menaxhimit të vazhdimësisë së biznesit janë identifikimi i potencialit për ndërprerje të biznesit (p.sh., dështimet e teknologjisë, mungesat e furnizimit, gabimet e operatorëve) dhe zbutja e rreziqeve. Si identifikimi i rrezikut është edhe zbutja shihen si elementë thelbësorë për menaxhimin e vazhdimësisë së biznesit. Literatura mbi menaxhimin e vazhdimësisë së biznesit ofron njohuri se si firmat mund të zhvillojnë elasticitet në nivel firme. Studimet sugjerojnë se menaxhimi i vazhdimësisë së biznesit kontribuon në qëndrueshmërinë e nivelit të firmës sepse i ndihmon firmat të përgatiten për goditje të jashtme duke zbatuar parimet e dizajnit të tepricës dhe fleksibilitetit (Adamou, 2013; Alesi, 2008; Castillo, 2004; Herbane et al., 2010). Menaxhimi i vazhdimësisë së biznesit shihet gjithashtu si bazë për përpjekjet për menaxhimin e rrezikut dhe fatkeqësive. Megjithatë, shumë pak vëmendje i është kushtuar kërkimit se si menaxhimi i vazhdimësisë së biznesit mund të mbështesë qëndrueshmërinë e komunitetit. Studimet mbi qëndrueshmërinë e komunitetit i referohen nevojës për menaxhim të vazhdimësisë së biznesit, por rrallë eksplorojnë marrëdhëniet midis koncepteve, edhe pse menaxhimi i vazhdimësisë së biznesit dhe qëndrueshmëria e nivelit të firmës duket të jenë të rëndësishme për ndërtimin e komunitetit -Niveli i qëndrueshmërisë (p.sh., për të shmangur prishjet në sistemet e infrastrukturës kritike të menaxhuara privatisht).

3.2. Filantropia e korporatës

Filantropia e korporatave mund të përkufizohet si donacione në para, burime të ngjashme me paratë e gatshme dhe materiale në natyrë për të tjerët. Filantropia mund të jetë një aktivitet i rregullt ose një përgjigje ndaj krizës së papritur (p.sh. donacionet e korporatave për një apel për përmbytjet). Filantropia e korporatës për sa i përket fatkeqësive mund të marrë disa forma. Për shembull, disa firma dhurojnë para të gatshme drejtpërdrejt, ndërsa të tjera mbledhin fonde përmes fondacioneve të korporatave ose përmes programeve të përputhjes ose grumbullimit të punonjësve. Puna e mëparshme ka zbuluar se firmat në kontekste të ndryshme priren të angazhohen në nivele të ndryshme të filantropisë korporative të lidhur me fatkeqësitë. Për me shumë firmat fitimprurëse që operojnë në komunitetin ku ndodhi fatkeqësia dhe firmat me një histori filantropie ose një orientim më të fortë të përgjegjësisë sociale të korporatës kanë më shumë gjasa të kontribuojnë në lehtësimin e fatkeqësive. Ndoshta në mënyrë kundërintuitive, fatkeqësitë në shkallë të gjerë shpesh shoqërohen me më pak, jo më shumë filantropi korporative, krahasuar me fatkeqësitë e vogla (Tilcsik & Marquis, 2013). Kjo është për shkak se fatkeqësitë në shkallë të gjerë shpesh dëmtojnë strukturën themelore të një komuniteti duke pamundësuar organizatat jofitimprurëse rrjetet dhe zvogëlimi i kapacitetit financiar të firmave për t'u angazhuar në përpjekje shtesë për ndihmë. Deri më sot, pjesa më e madhe e literaturës së filantropisë së korporatave ka eksploruar avantazhet që i takojnë firmës nga angazhimi në filantropi, por ende nuk e ka eksploruar marrëdhënien mes filantropisë së korporatës dhe qëndrueshmërisë së komunitetit, të cilat do t'i shqyrtojmë më vonë në artikull.

3.3. Reagimi ndaj fatkeqësive

Ekziston një grup provash, që tregojnë se firmat nga industri shumë të ndryshme

hapen për të ofruar zgjidhje inovative dhe të specializuara për rikuperimin nga fatkeqësitë. Këto përfshijnë shpëtimin e të dhënave, komunikimet, ruajtjen, restaurimin e objektit, akomodimin e urgjencës dhe shërbimet e këshillimit të stafit. Firma të tilla angazhohen në biznesin e reagimit ndaj fatkeqësive, të përcaktuara si firma që ofrojnë produkte dhe/ose shërbime që ndihmojnë qytetarët dhe firmat e tjera përpara, gjatë dhe/ose pas një fatkeqësie. Në disa shtete, firma, si kompanitë e restaurimit të përmbytjeve, krijojnë marrëveshje kontraktuale me firma më të mëdha dhe më të përgatitura për të siguruar që produkte dhe shërbime të caktuara të furnizohen në rast të një fatkeqësie natyrore. Zinxhirët kombëtarë të shitjes me pakicë kontratojnë specialistë të restaurimit të objekteve ose të shpëtimit të të dhënave për të reaguar shpejt në rast të një fatkeqësie natyrore.

Ekziston një grup i vogël kërkimesh që pranojnë se, megjithëse qeveritë janë në fund të fundit përgjegjëse për reagimin ndaj fatkeqësive, atyre mund t'u mungojnë burimet dhe aftësitë e kërkuara prej tyre. Duke qenë se sektori privat zotëron një pjesë të madhe të infrastrukturës kritike, qeverive u kërkohet gjithnjë e më shumë të bashkëpunojnë me firmat për të kërkuar bashkërisht zgjidhje për problemet e paraqitura nga fatkeqësitë natyrore. Megjithatë, lidhja midis përgjigjeve të nivelit të firmës dhe qëndrueshmërisë së komunitetit ende nuk është eksploruar plotësisht.

4. Mbrojtja civile evropiane dhe operacionet e ndihmës humanitare: menaxhimi evropian i rrezikut nga fatkeqësitë

- Çfarë është ajo?¹

Bashkimi Evropian është një vend i sigurt për të jetuar, por edhe këtu, rreziqet natyrore dhe fatkeqësitë e shkaktuara nga njerëzit kërcënojnë njerëzit, pronën, mjedisin dhe trashëgiminë kulturore. Politikat e menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë synojnë t'i trajtojnë këto rreziqe përmes veprimeve parandaluese, gatishmërisë, reagimit dhe rikuperimit.

BE-ja zhvillon politika që fokusohen në parandalimin dhe reduktimin e rreziqeve nga fatkeqësitë, pasi këto veprime do të zvogëlojnë ndikimin e ngjarjeve negative. Rritja e qëndrueshmërisë së infrastrukturës, ekosistemeve, shoqërisë dhe ekonomisë së BE-së është një fushë e rëndësishme e punës së menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë.

- Pse është e rëndësishme?

Në vitet e fundit, BE-ja ka parë një gamë të gjerë ngjarjesh negative që shkaktojnë shkatërrimin e jetës njerëzore, pronës, mjedisit dhe trashëgimisë kulturore. Në BE, nga viti 1980 deri në vitin 2020, rreziqet natyrore prekën afro 50 milionë njerëz dhe u kanë kushtuar shteteve anëtare mesatarisht 12 miliardë euro në vit.

BE-ja pritet të përjetojë ngjarje më ekstreme dhe rritje të ekspozimit dhe cenueshmërisë ndaj fatkeqësive. Për shembull, ndryshimet klimatike po sjellin ngjarje më ekstreme të motit, rritje të nivelit të detit dhe ndryshime në shpërndarjen gjeografike të disa sëmundjeve infektive.

Urbanizimi dhe zhvillimi i vazhdueshëm në zonat e rrezikshme kanë vënë në rrezik më shumë njerëz dhe pasuri. Ambientet urbane përforcojnë rreziqet e fatkeqësive si përmbytjet, valët e të nxehtit ose epidemitë.

Degradimi i mjedisit në Evropë dhe globalisht po zvogëlon kapacitetin e ekosistemeve për të na mbrojtur nga ndikimi i fatkeqësive.

Vitet e fundit kanë parë gjithashtu rritje të paqëndrueshmërisë jashtë vendit,

AKADEMIA E SIGURISË

Burimet hidrike kanë rol të rëndësishëm përcaktues në proceset e përgjithshme hidrogeomorfologjike të formimit dhe të zhvillimit të hapësirës së gjerë bregdetare shqiptare. Në këtë hapësirë ndodhen grykëderdhjet e deltat e lumenjve më kryesorë të Shqipërisë. Sistemi i komplikuar lagunor me sipërfaqe të përgjithshme rreth 150 km², plazhet e gjëra ranore akumulative e abrazivë, seritë e ligatinave, kordonët litorale, sistemi i dunave ranore, pyjet, etj.

Të gjithë këta faktorë së bashku edhe me klimën tipike mesdhetare bëjnë të mundur që hapësira bregdetare shqiptare të përfaqësohet nga një ekosistem i mirëfilltë dhe i përsosur me vlera të mëdha ekologjike të nivelit ndërkombëtar.

Rrjeti hidrografik i Shqipërisë dallohet për një regjim të lartë hidrokimik. Ujërat e lumenjve të Shqipërisë karakterizohen nga një mineralizim mesatar, i cili ndryshon në kufij relativisht të gjerë, përkatësisht nga 160-180 mg/l. Për nga përmbajtja e joneve kryesore përfshihen në klasën e bikarbonateve (grupi i kalciumit). Pjesën më të madhe të mineralizimit të ujërave lumore e përbëjnë jonet bikarbonatike, ato të kalciumit, si dhe sulfatet. Jonet e tjera, që takohen më rrallë, si ato të magneziumit të natriumit të potasit dhe klorurit zënë një përqindje mjaft të vogël. Kjo përbërje kushtëzohet nga prezenca e formacioneve karbonatike (CaCO₃, MgCO₃). Ujërat e burimeve për sa i

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

përket regjimit hidrokimik, janë të natyrës oligominerale, minerale, termominerale, sulfatike dhe sulfurore.

Theksojmë se liqenet kontinentale të Shqipërisë, në përgjithësi, kanë ujra karstikë, kurse sistemi lagunor nëpërmjet procesit të ujëkëmbimit me detin, furnizohet me ujëra të mineralizuara. Kripshmëria në këtë sistem lëkundet nga 25-90%. Veprimtaria e pakontrolluar antropogjene ka dëmtuar dhe po vazhdon të dëmtojë së tepërmi ekuilibrin ekologjik të rrjetit hidrografik të Shqipërisë në shumë aspekte.

Dëme të konsiderueshme po konstatohen nga shkarkimet drejtpërsëdrejti në ujërat e rrjetit hidrografik të Shqipërisë të shkarkimeve urbane të qyteteve e plehrave të pa trajtuara paraprakisht apo shkarkimet e mbeturinave industriale, ato minerale, apo hidrokarburet, etj. Dëmtime po ndodhin edhe nga përdorimi pa kritere teknike i kimikateve në bujqësi, si pesticide, etj. Apo marrje masive e pa kritere shkencore e materialeve inerte nga shtretërit e lumenjve për qëllime ndërtimi, marrja e rërës në bregdet, duke dëmtuar plazhet apo dunat ranore, që, siç dihet, janë monumente të natyrës, duke intensifikuar procesin e dëmtshëm të abrazionit detar. Edhe prerja masive e pa kritere shkencore e pyjeve po intensifikon procesin e gërryerjes së tokës, duke formuar vatra të fuqishme erozioni.

Rrjeti hidrografik i Shqipërisë krahas vlerave të larta estetike si njëri nga elementët më të bukur dhe më piktoresk të mjedisit tonë natyror, ka dhe një rëndësi të madhe jetësore dhe ekonomike. Me ujërat e këtij rrjeti janë të lidhura ngushtë organikisht, aspekte të tilla të rëndësishme si: sigurimi i ujit të pijshëm për popullsinë e fshatit dhe të qytetit, ndërtimi i veprave hidroenergjitike, ujitje e tokave bujqësore, furnizimi me ujë i industrisë, transporti detar, peshkimi, dhe zhvillimi i turizmit. Me efikasitet po shfrytëzohen për qëllime kurative dhe ujërat termale e minerale të vendit tonë.

Në këto kushte, ujërat e rrjetit të hidrografisë të Shqipërisë janë kthyer tashmë në një element të rëndësishëm e të pandarë të jetës të zhvillimit ekonomik të vendit tonë, si për sot ashtu edhe për gjeneratat e ardhshme.

Klima varion: verë të nxehta dhe të thata dhe me stuhi me bubullima dhe nga dimra të lagët dhe të butë në zonat fushore; ndërsa zonat malore karakterizohen nga precipitimi dhe dimra më të ftohtë dhe shumë më të fortë me dëborë në male. Precipitimi mesatar është 1 485 milimetra (mm). Në bregdet reshjet vjetore arrijnë në 1 000 mm, ndërsa në male arrijnë në 3,000 mm. Shumica e precipitimit kalon në lumenj dhe rrjedh në detin Adriatik. Gjithashtu, përmes Shqipërisë kalon edhe një sasi e madhe ujërash nga vendet fqinje.

Popullsia e regjistruar e vendit në vitin 2000 ishte 3.13 milionë banorë, ndërsa në regjistrimin e këtij viti ajo është rreth 2.7 milionë banorë, nga e cila më shumë se gjysma e popullsisë (58%) jeton në zonat rurale. Burimet ujore luajnë një rol shumë të rëndësishëm në ekonominë e vendit: afërsisht 97% e gjithë prodhimit energjetik sigurohet nga hidrocentralet, kryesisht nga lumenjtë e Drinit, Matit dhe Bistricës; dhe rreth 50% e tokës bujqësore ujitet duke prodhuar afërsisht 80% të prodhimit bujqësor.

Për shkak të topografisë malore, lumenjtë rrjedhin përmes kodrave të pjerrëta. Ndryshueshmëria e tyre vit pas viti është shumë e lartë: rrjedhjet vjetore në vite të thata përbëjnë një të dhjetën e rrjedhjeve vjetore në vite të lagësht. Shumica e lumenjve paraqesin modele shumë të çrregullta të rrjedhjes sezonale. Rrjedhjet e lumenjve janë më të larta gjatë dimrit ose në fillim të pranverës. Pothuajse të gjithë kanë më pak se 10% (dhe nganjëherë zero për qind) të mesatares së tyre të dimrit në stinën e verës.

Liqenet zënë 4% të territorit të vendit. Liqenet më të mëdha janë ato të Ohrit,

Prespës dhe Shkodrës. Këto janë liqene ndërkufitare. Përveç këtyre ka edhe 247 liqene më të vogla. Aktualisht, liqenet janë në fazë oligotrofike, me përjashtim të disa zonave ku shkarkimet në lumenjtë tributorë kanë rritur përqendrimin e nitrogjenit dhe fosforit. Përgjatë lumenjve të Drinit, Matit dhe Devollit janë ndërtuar disa rezervuarë me një total 5.60 BCM kapacitet mbajtës për mbrojtje nga përmbytjet, për qëllime ujitjeje dhe për prodhim të energjisë elektrike.

Zonat e lagta. Shumica e lumenjve të Shqipërisë formojnë në gojë të tyre një sërë lagunash, kënetash dhe zona të lagta. Gjatë regjimit të mëparshëm, zonat e mëdha të lagta përgjatë bregdetit u thanë dhe u kthyen në toka bujqësore. Rrjedhimisht, u zhdukën disa nga zonat e vlefshme të lagta. Disa nga lagunat e mëdha përgjatë vijës bregdetare janë: laguna e Karavastasë, Nartës dhe Butrintit, të cilat përfaqësojnë zonat e lagta me rëndësi të madhe globale për biodiversitetin. Disa nga këto laguna janë pjesë e konventës Ramsar.

Këto ekosisteme natyrore ujore tepër të rëndësishme për vlerat e tyre të mëdha për biodiversitetin po kërcënohen nga ngarkesa të ndotjes dhe në shumë raste po përdoren për shkarkimin e ujërave të zeza të patrajtuara. Burimet nëntokësore gjithashtu janë të bollshme dhe përfaqësojnë rreth 23% të totalit të burimeve të rinovueshme¹⁰.

Këto burime janë të shpërndara mirë në të gjithë vendin dhe shfrytëzohen nga pusët (në lugina dhe fusha) dhe burime (në rajonet malore). Megjithatë, burimet rrezikojnë të thahen gjatë stinës së verës (Baseni i shtresës ujëmbajtëse në Mat). Burimet nëntokësore janë burimi kryesor i ujit të pijshëm. Afërsisht 70% e qyteteve kryesore të vendit furnizohen me ujë nga pusët nëntokësore. Gjithashtu, ato janë edhe burimi kryesor për ujitje dhe për bujqësinë në zonat e Shkodrës dhe Vlorës.

Si konkluzion. Duke qenë se potenciali hidroenergetik i lumenjve tanë është i konsiderueshëm dhe përbën një pasuri të madhe për vendin duhet të dalë një ligj i veçantë që të ndalojë ndërtimin e veprave të ndryshme në luginat e lumenjve nën kuotat e zonave që përmbyten nga ana e liqeneve të hidrocentraleve dhe të mos ndodhë si me lumenjtë Shkumbin, Mat, Fan dhe pjesërisht Vjosën ku janë ndërtuar rrugë, hekurudha, shtëpi banimi nën kuotat e liqeneve duke dëmtuar pasurinë ujore.

5. Përmbytjet

Në vendin tonë, vazhdimisht ka pasur përmbytje, thekson P. Qirjazi, madje edhe katastrofike, me pasoja të rënda ekonomike, sociale, ekologjike. Midis tyre dallohen: përmbytjet e mëdha në dimrin e viteve 1962-1963 në Ultësirën Perëndimore; përmbytjet e fundvitit 1970 dhe të fillimvitit 1971; të viteve 2009-2010, 2011, dhjetor 2017, mars 2018 në rajonin e Shkodrës; përmbytjet e shkurtit 2015 nga Vjosa dhe Drinosi, nga Semani, Zeza etj.; përmbytjet e janarit 2016 nga Shkumbini, dhjetor 2017, të shkurtit 2018 nga Vjosa dhe Semani¹¹.

Përmbytjet e nëntorit 1962 deri janarit të 1963 mbahen historikisht si më e madhja. Kështu fusha e Zadrimës së Shkodrës dhe Lezhës, Bregu i Bunës përmbytet në një sipërfaqe prej 18,575 ha me kohëzgjatje prej 22 ditësh, fusha midis Drinit të Lezhës e Matit në një sipërfaqe prej 3,122 ha me kohëzgjatje 10 ditë, fusha ndërmjet Matit e Ishmit 5,825 Ha me kohë zgjatje prej 7 ditësh, fusha e Rrogozhinës poshtë Shkumbinit

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

¹⁰ Si të mbrohem nga fatkeqësitë e natyrës dhe katastrofat humanitare. Fq.44deri 49

¹¹ Perikli Qirjazi: Gazeta Panorama 22.01. 2021

në një sipërfaqe prej 6,896 ha me kohëzgjatje prej 7 ditësh, fusha në të dy brigjet e Semanit 26,738 ha me kohëzgjatje prej 35 ditësh, fusha në të dy brigjet e lumit Vjosë poshtë urës së Mifolit në një sipërfaqe prej 3,538 ha me kohëzgjatje prej 20 ditësh.

Në qoftë se do të bënim një klasifikim të përmbytjeve ato do ti ndanim në përmbytje natyrale, përmbytje artificial ose antropike, që nuk janë gjë tjetër veçse ato që lindin nga çarja e digave dhe pritave që janë ndërtuar për mbledhjen e ujërave për ti përdorur ato si rezerva hidrike ose për prodhimin e energjisë elektrike. Për parandalimin e këtyre ndodhive është e domosdoshme të njihen karakteristikat e rrjedhjeve të ujit të hidrologjisë së ujëmbledhësve dhe sasisë së rënies së reshjeve.

Kostoja vjetore e përmbytjeve nuk dihet; qysh nga viti 1949 nuk është bërë asnjë monitorim i rregullt i përmbytjeve dhe regjistrimi që filloi që atëherë nuk i publikoi të dhënat e plota. Përmbytjet më të mëdha me dëme katastrofike i përkasin periudhës gjatë viteve 1962-63. Përmbytjet u konsideruan si ngjarje që ndodhin një herë në pesëdhjetë vjet.

Sistemi lumor përbën rrezikun më të madh për përmbytjet, ku këto përmbytje janë me prejardhje lumore dhe ndodhin në periudhën nëntor-mars, kohë kur në vend bien rreth 80 deri 85% të reshjeve vjetore. Rreziku i përmbytjeve në Shqipëri është i lidhur me potencialin e madh të përmbytjes së tokave të ulëta të ultësirës perëndimore dhe potencialin e përmbytjes të shoqëruar nga lumenjtë e vegjël e përrënjtë.

Pasojat e këtyre përmbytjeve mund të zvogëloheshin deri në një farë niveli nëpërmjet strategjive të parandalimit të tyre dhe kundërveprimit, por sot ato rëndohen për shkak të degradimit të kushteve të sistemit të digave, të kanaleve të kullimit, të instalimeve për largimin e ujërave të shtuara, të stacioneve të pompimit dhe të pajisjeve të tjera për mbajtjen në kontroll të përmbytjeve e të instalimeve që nuk kanë mirëmbajtje të rregullt.

Karakteristika kryesore e përmbytjeve në ultësirën perëndimore është se ujërat e përmbytjes nga lumenj të ndryshëm shpesh përmbytin të njëjtën sipërfaqe duke krijuar një grykë derdhje lumi të vetme të zgjeruar.

Në përmbytjet e mëdha të Shkodrës, në vitet 2009-2010, 2011, dhjetor 2017, mars 2018, përveç faktorit të përhershëm gjeomorfologjik, kanë vepruar fuqimisht reshjet intensive, të kombinuara me shkrirjen e shpejtë të dëborës, dhe nyja hidrografike liqeni i Shkodrës-Drin-Bunë. Roli i kësaj nyje shfaqet gjatë reshjeve intensive, kur rryma e fuqishme e Drinit pengon rrjedhjen normale të qetë të Bunës. Në këto raste, liqeni i Shkodrës kthehet në liqen pa rrjedhje. Për pasojë, ai zgjerohet dhe përmbyt hapësira të gjera përreth, madje edhe Shkodrën.

Lumenjtë Drini dhe Buna së bashku kanë përmbytur fushat e Shkodrës dhe të Zadrimës ato kanë çarë pendat në të majtë e të djathtë dhe kanë përmbytur fushat e Prushit, të Velipojës dhe të Bërdicës, si dhe kanë depërtuar në kënetën e Kakariqit e të Myrtenizës.

Shkumbini dhe Semani kanë përmbytur ultësirat rreth tyre. Ujërat nëntokësore në ultësirën perëndimore janë ngritur, në shumë vende kanë arritur sipërfaqen sidomos në fushat e Myzeqesë, të Lushnjës e të Thumanës. Në tërësi u përmbytën rreth 70 000 hektarë tokë bujqësore duke shkaktuar dëme të ndjeshme ekonomike. Gjithashtu u përmbytën pjesërisht edhe qytetet e Shkodrës, Beratit, Lezhës e të tjera. Në mjaft vende u ndërprejnë rrugët kombëtare. Sistemi i pendave mbrojtëse u dëmtua rëndë, madje në mjaft raste u shkatërrua.

Dëmet e shkaktuara nga përmbytjet e ndodhura në qytetin e Shkodrës kanë qenë të konsiderueshme dhe kanë pasur ndikimin e tyre të drejtpërdrejtë në jetën, pasurinë dhe

sigurinë në gjithë zonën e përfshirë nga këto përmbajtje. Pasojat e tyre qenë të drejtpërdrejta me subvencionimin e bërë nga qeveria dhe ajo që është më e rëndësishme eliminimi i pasojave të tyre kërkon kohë në rehabilitimin e dëmeve të krijuara, menaxhimi i këtyre përmbajtjeve do të bëhej shumë herë më i lehtë nëse do të kishim zbatuar një sërë masash parandaluese.

Shqipëria është një vend i prirë për katastrofa dhe i ekspozohet herë pas here rreziqeve që mund të ndahen sipas origjinës në dy kategori:

a) *me origjinë natyrore*: gjeologjike (tërmete, rënie shkëmbinjsh dhe rrëshqitje dheu); hidrometeorologjike (përmbajtje dhe shira të rrëmbyeshëm, thatësira, stuhi dëbore, reshje të mëdha dëbore dhe stuhi ere); biofizike (zjarre në pyje dhe epidemi); dhe ortekë¹²;

b) *me origjinë njerëzore*: shpërthimet e digave, përmbajtjet dhe rreziqet teknologjike¹³.

“Shqipëria ka mbi 300 diga të larta të regjistruara në regjistrin botëror të digave të larta. Jemi vendi i parë në botë për numrin e digave të larta për banor. Një rekord botëror është diga e Bovillës, e cila është ende diga më e lartë në botë me gjeomembranë. Për shkak të qasjes së ekonomisë së centralizuar, rezervuarët shqiptarë shërbejnë kryesisht për prodhim energjie dhe për ujtje. Për qëllimet e bujqësisë, gjatë periudhës së komunizmit u ndërtuan mbi 630 rezervuarë, me një kapacitet prej 5.6 miliardë metra kub ujë. Duke përjashtuar digat mbi lumin Mat, të gjitha të tjerat në Shqipëri janë diga me materiale vendi (dhé, gurë, argjilë). Këto diga janë shumë të qëndrueshme dhe më ekonomike në ndërtim. Sidoqoftë, digat kërkojnë inspektime dhe mirëmbajtje të vazhdueshme”¹⁴.

6. Cilësia e ujërave

Ujërat nëntokësore në gjithë botën janë minerali më jetik për popullatën, janë objekt shfrytëzimi i vazhdueshëm me intensitet të lartë rritje dhe rrezik të përhershëm ndotjeje nga veprimtaritë natyrore e humane (njerëzore). Regjimi i ujërave nëntokësore karakterizohet nga ndryshimi në kohë dhe hapësirë i sasisë dhe cilësisë së tyre dhe shprehet nëpërmjet tërësisë së treguesve të ndryshimeve sasiore e cilësore siç janë: niveli, temperatura, prurjet, pjerrësia hidraulike (gradienti), shpejtësia e rrjedhës dhe përbërja kimike.

Ruajtja e cilësisë së ujërave nëntokësore është e rëndësishme si për nga rezervat ujëmbajtëse që ata disponojnë ashtu dhe nga rëndësia praktike që kanë për furnizimin me ujë të pijshëm e teknologjik. Cilësia e ujërave nëntokësore duhet analizuar për të gjetur shkaqet e ndotjes së tyre. Këto ujëra kanë veti të mira fiziko-kimike, janë me mineralizim të ulët: të ëmbla, janë neutrale, plotësojnë normën e lejuar për ujë të pijshëm. Ndotja e tyre është rastësore, lokale dhe lidhet me moszbatimin e rrezeve të rreptësisë dhe mbrojtjes sanitare si dhe mbulesën e vogël të shtresës nënargjilore.

Është e domosdoshme të kryhen monitorime të vazhdueshme i ujërave nëntokësore në mënyrë që të jepen rekomandime të drejta për shfrytëzimin e tyre dhe të shmangët mundësia e aktivizimit të rrymave të ujërave të mineralizuara drejt ujërave të freskëta. Në përgjithësi ujërat nëntokësorë janë neutralë dhe alkaline. Nuk takohen ujëra acide

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

¹² Po aty, f. 5.

¹³ Po aty, f. 6.

¹⁴ Erjon Kalaja, *Tërmetet duhet të na bëjnë të shikojmë menjëherë sigurinë e digave*, (Tiranë: Exit.al, 26.9.2019).

në pellgjet dhe shpimet e monitoruara.

Është e detyrueshme zbatimi i zonave të rreptësisë dhe mbrojtjes sanitare rreth shpimeve të shfrytëzimit për mbrojtjen e ujërave nëntokësore nga ndotjet sipërfaqësore.

Rekomandohet që organet kompetente të ushtrojnë autoritetin e tyre për mbrojtjen e ujërave nëntokësore nga ndotjet masive të mundshme nga ato lokale që janë takuar gjatë monitorimit.

Ndalimin e shfrytëzimit të zhavorreve në shtretërit e lumenjve për mbrojtjen e shpimeve të shfrytëzimit në tarracat lumore dhe ruajtjen e ekuilibrave hidrodinamike e hidrokimike të ushqimit të akuifereve ujëmbajtëse.

Monitorimi i ujërave nëntokësore duhet të kryhet dhe në përputhje me kërkesat e Agjencisë Europiane të Mjedisit për *NH4*, *NO2*, *NO3*, dhe *përmbajtja e oksigjenit* në ujë.

Ujërat nëntokësorë kanë veti fiziko-kimike të mira, janë neutrale dhe alkaline, janë ujëra të ëmbla, me fortësi mesatare deri të fortë. Përmbajtja e mikroelementeve është brenda normave të lejuara.

Cilësia e ujërave të liqeneve. Liqeni i Prespës, sipas përmbajtjes së oksigjenit dhe të fosforit ndodhet në nivelin e mezotrofisë drejt eutrofisë, gjendje e qëndrueshme e këtij liqeni për një periudhë të gjatë kohe të monitorimit. Analiza e plotë e presioneve në këtë zonë do të jepte një pamje me të plotë të gjendjes ekologjike të këtij liqeni.

Për Liqenin e Shkodrës mund të veçojmë këto karakteristika: ujërat e tij janë relativisht të ngopura me oksigjen; vlerat e përmbajtjes së fosforit rezultojnë në nivele të ulëta por me një rritje në fund të liqenit; përcjellshmëria elektrike e ujërave ka tendencë rritjeje si pasojë e shkarkimeve të ndryshme në liqen.

Reduktim dhe ndryshim i regjimit të ujit të lagunave si rezultat i ndërtimit të pritave mbrojtëse përgjatë grykëderdhjes së lumenjve dhe reduktimit të burimeve të ujërave të ëmbla, bonifikimeve të kryera kohë më parë. Shtimi i investimeve në drejtim të mbajtjes hapur të kanaleve që lidhin lagunën me detin.

Reduktimi i derdhjes së ujërave të zeza të pasura me substanca ushqyese dhe kufizimi i përdorimit të plehrave organike apo kimike në zonat në afërsi të lagunave.

Në përpunimin e politikës së tij ekonomike, Shtetit i nevojiten të dhëna të plota dhe të sigurta për pasuritë natyrore, vlerësime dhe azhurnime të pasurive kombëtare, alternativa për hartimin e programeve ekonomike, opsione bashkëpunimi dhe integrimi me komunitetin ndërkombëtar, etj.

7. Përdorimi dhe administrimi i burimeve hidrike

Kohët e fundit është hartuar ligji “Për mbrojtjen e ujit”, i cili vazhdimisht duhet të rishikohet, ai trajton ekskluzivisht zbatimin e legjislationit ekzistues për mbrojtjen e cilësisë së trupave të ujit me qëllim mbrojtjen e shëndetit të njeriut. Nga ana institucionale, ai sqaron rolin e Këshillit Kombëtar të Ujit dhe i jep më shumë përgjegjësi Ministrisë së Mjedisit për mbrojtjen e burimeve ujore.

Në vitin 1997 u hartua “Strategjia kombëtare për ujin në Shqipëri”, me ndihmesën e Bashkimit Evropian. Ajo stimulon “konservimin e burimeve ujore dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve ujore në harmoni me mjedisin dhe burimet e tjera natyrore.” Strategjia evidenton qartë objektivat kombëtare për përdorimin dhe administrimin e ujit dhe sugjeron ndryshime në kuadrin institucional për zbatimin e strategjisë. Strategjia përcakton prioritetet institucionale radikale me qëllim vendosjen e linjave të qarta të

vendimeve të politikave brenda kuadrit institucional, duke përfshirë edhe Këshillin Kombëtar të Ujit dhe ministritë përkatëse të linjës, në veçanti ato që përgjigjen për Mbrojtjen e mjedisit, ujitjen dhe furnizimin me ujë të pijshëm.

Në fazën e saj përfundimtare, strategjia hasi në kundërshtime dhe rrjedhimisht nuk u zbatua asnjëherë. Një ligj i ri u adoptua në vitin 2002 mbi organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal. Ky ligj ua kalon përgjegjësinë e plotë për administrimin, shërbimin, investimet dhe rregullimin e furnizimit më ujë, sistemet e ujërave të zeza dhe kullimit, si edhe kanalet për mbrojtjen nga përmbytjet pushteteve lokale. Për zbatimin e këtij ligji, ka nevojë të përmirësohet kapaciteti i bashkive për administrimin e ujit dhe rregullimin e territorit.

Duke pasur parasysh numrin e madh të digave në vend dhe shqetësimet që lidhen me sigurinë e tyre, aktualisht qeveria shqiptare ka ndërmarrë një hap të parë drejt hartimit të një kuadri institucional dhe ligjor për sigurinë e digave. Për administrimin e burimeve ujore në Shqipëri ka disa instrumente që janë në dispozicion: tarifa administrative për nxjerrjen e licencës për abstraksionin e ujit, tarifat e abstraksionit për ujërat sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, tarifa për përdoruesit e ujit dhe ujitjes, tarifa për kanalizimet dhe gjoba në raste moszbatimi të rregullave.

Komiteti Kombëtar i Ujit ka marrë dy vendime të rëndësishme. I pari në lidhje me krijimin e një këshilli për basenet e ujit dhe një agjencie zbatimi për secilën nga gjashtë basenet. Vendimi i dytë përcakton përgjegjësitë e këshillave të baseneve të ujit dhe agjencive të ujit në lidhje me nxjerrjen e lejeve të abstraksionit. Pavarësisht nga përpjekjet e Komitetit Kombëtar të Ujit pak progres ka pasur në lidhje me zbatimin e ligjit të vitit 1996, provë për këtë është progresi i kufizuar në futjen e një strategjie për ujin, mungesa e një inventari për burimet ujore dhe mos nxjerrja e asnjë autorizimi apo lejeje për përdorimin dhe shkarkimin e ujit. Mungojnë mekanizmat e zbatimit dhe ajo që është më e rëndësishme vendimet që merren për sektorin e ujit nuk mbështeten nga burimet e nevojshme financiare.

Mungesa e një sistemi adekuat për monitorimin, ndryshimet e shpejta të aktiviteteve ekonomike dhe lëvizjet e shpeshta të popullsisë e bëjnë të vështirë vlerësimin e burimeve ujore. Të dhënat e disponueshme sugjerojnë se ujitja dhe minierat mbështeten kryesisht në ujin e sipërfaqes, ndërsa familjarët dhe industria tek burimet nëntokësore nga shtresat ujëmbajtëse.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ka në dhe varësinë e saj Komitetin Kombëtar të Digave të Mëdha (KKDM). Në një takim të bërë së fundi, ministrja Balluku theksoi se fokusi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë do të ishte tek ky komitet duke e ngritur atë në nivelin më të lartë profesional. Detyrat parësore që dalin përpara KKDM-së janë që nga skanimi i situatës së digave, i cili është një proces shumë i rëndësishëm që duhet ndjekur, e deri tek zhvillimi i të gjithë dokumentacioneve që duhet të ketë dosja e çdo dige.

“Në Republikën e Shqipërisë kemi diga të volumeve shumë të mëdha, siç janë digat e kaskadës së Drinit, apo kemi diga, të cilat ndodhen me shumicë në zona të banuara, siç është qyteti i Tiranës. Siguria e digave për ne është prioritet dhe misioni i komitetit tuaj është që kjo siguri të garantohet në çdo hap të administratës”, - nënvizoi ministrja Balluku¹⁵.

Kryetari i KKDM-së, në një pasqyrim të situatës së digave në Shqipëri, ndër të tjera

¹⁵ Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e RSH, Prezantohet Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha dhe Këshilli Teknik, (Tiranë: 22.9.2020).

do të theksonte se: “Në vendin tonë janë 650 diga në total, nga të cilat 362 janë diga të mëdha me lartësi mbi 15 metra. Diga e parë është ndërtuar në Shqipëri në vitin 1957. Sot jemi në këtë situatë: kemi shumë pak diga të reja, 5 apo 6 të tilla dhe shumica e digave janë mbi 30-40-vjeçare, të cilat kërkojnë patjetër mirëmbajtje, monitorim dhe një shfrytëzim me kujdes”¹⁶.

E sollëm këtë informacion për ta parë nën këndvështrimin e kryqëzimit të rrezikut nga tërmetet, rrezikut nga amortizimi i digave dhe rrezikut nga faktori njerëzor. Rreziku nga tërmeti është një kërcënim natyror i pashmangshëm. Vendi ynë ndodhet në një zonë gjeografike të kërcënuar nga tërmetet. Në rast tërmetesh, digat rrezikojnë të kenë dëmtime. Këto dëmtime mund të jenë më të rënda për shkak të amortizimit të digave. Të dy këto rreziqe, janë ekzistues. Vetëm faktori njerëzor mund të korrigjojë rrezikun e amortizimit, pasi rreziku sizmik nuk shmanget dot.

Faktori njerëzor shoqëror, mund të përkeqësojë situatën përmes veprimeve që ndërmerr, si p.sh.: ndërtime në zona të rrezikuara, ndërhyrje në infrastrukturën e digave, ndërtime të pasigurta, shpyllëzime në breza mbrojtës, shfrytëzimi i pa kriter i tokave pranë digave për qëllime përfitimi etj.

8. Përfundime dhe rekomandime

Konferenca Botërore e specialistëve të ndryshimeve klimatike (Montreal, 2005) theksoi se “... vitet që do të vijnë, do të kenë verë sahariane dhe dimra polarë”. Ky konkluzion i frikshëm po vërtetohet, po bëhen më të shpeshta ngjarjet e jashtëzakonshme meteorologjike, me pasoja katastrofike, si: thatësira dhe shira intensive e të zgjatura, që do të sjellin përmytje të mëdha. Kjo kërkon që të veprojmë qysh tani, madje jemi vonë.

Përmytjet janë shtuar si rezultat i shtimit të ngjarjeve jo të zakonshme meteorologjike, por në radhë të parë me veprimtarinë spontane, kaotike humane, si: dëmtimi i madh i bimësisë në pellgjet ujëmbledhëse; braktisja e sistemimeve malore antierozive; braktisja e mirëmbajtjes, madje dëmtimi i sistemit kullues (argjinaturave, kanaleve kulluese, hidrovorëve etj.), nuk mungojnë as rastet e privatizimit të disa kanaleve kulluese; dëmtimi i shtretërve të lumenjve nga marrja e materialeve inerte.

Në shkaqet e tjera njerëzore dallohen: ndërtimet kaotike në gjithë fushën, madje edhe në zonat e ulëta të ish-kënetave, të cilat prishën rrjetin e kanaleve kulluese; keqmenaxhimi i kaskadës së Drinit, duke hapur portat e hidrocentraleve të cilat rrisin përmasat e përmytjeve.

Për të evituar përmytjet ose të paktën uljen në minimum të pasojave negative të tyre duhet përafrim dhe zbatim i Direktivës Europiane të Përmytjeve; riorganizimin e institucioneve monitoruese të lumenjve e parashikuese të përmytjeve; mirëmbajtje të vazhdueshme dhe të përvitshme të sistemit kullues dhe të shtretërve të lumenjve, argjinaturave, hidrovorëve etj; bashkëpunim e bashkërendim i institucioneve dhe i grupeve të interesit,

Ujërat nëntokësore janë një pasuri e pazëvendësueshme kombëtare. Në këtë kuadër zgjerimi i studimeve hidrogjeologjike duhet të synojë në: Rivlerësimin e rezervave ekzistuese, menaxhimin shkencor dhe mbrojtjen e tyre, përgatitjen e projekteve për vlerësime të mëtejshme në përputhje me zhvillimet urbane, modelimin e strukturave

ujë-mbajtëse, gjetjen e burimeve të reja, kërkimin dhe vlerësimin e ujërave termale, vlerësimin e ujërave oligominerale, etj.

Përmbytjet e ndodhura në vitet e fundit, janë pasojë e rritjes së koeficientit rrjedhave ujore sipërfaqësore, dëmtimit dhe daljes jashtë funksionit të pritave malore dhe mos investimi për ndërtimin e tyre në tokat e pjerrëta.

Dëmtimet dhe nxjerrja jashtë funksionit e veprave të marrjes së ujit për ujitje janë rezultat i thellimit të shtretërve të lumenjve prej shfrytëzimit pa kriter të materialeve inerte. Gërryerjet e tokës në basenet e lumenjve janë me pasoja për tokën bujqësore dhe infrastrukturën e ndërtuar mbi të. Dukuria e këtij fenomeni është e pranishme në të gjithë segmentet lumore të vendit tonë.

Vërehen humbje të tokës nga 23 000 deri 26 000 m² çdo vit. Në përshpejtimin e erozionit, në brigjet lumore ndikim më të madh kanë: Devijimet shtretërve të lumenjve si rezultat i shfrytëzimit pa kriter të materialeve inerte, dëmtimi dhe mos funksionimi i veprave mbrojtëse, mungesa e investimeve të reja, dëmtimi i bimësisë në anët e shtretërve të lumenjve. Veprat mbrojtëse (argjinatura, panele tërthore, prita), kanë pësuar dëmtime të mëdha dhe fenomeni është i pranishëm në të gjithë shtretërit e lumenjve.

Kujdes do ti kushtohet edhe aspekteve, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e popullsisë dhe të ekonomisë në rastet katastrofike, që krijohen nga dalja e lumenjve jashtë shtratit të rrjedhjes. Janë të domosdoshme parashikimet hidrologjike dhe vlerësimin e ndikimit të ndryshimeve klimatike në potencialet ujore të territorit të Shqipërisë.

Përmirësim i mëtejshëm i bazës ligjore në fushën e ujit, plotësimi i saj me legjislacion të ri dhe përqasja e tij në përgjithësi me atë Europian.

Vlerësimi i regjimit hidrokimik, shkallës së ndotjes të ujërave lumorë, ato në zonat naftë-mbajtëse, evidentimi i burimeve ujore me cilësi të veçanta për industrializim të ujit të pijshëm. Vlerësimi kompleks i potencialeve të ujërave termale dhe kurative të Shqipërisë me teknologji inovative, në tërë ciklin, nga burimi tek konsumatori.

Studimi kadastral i ujërave të Shqipërisë dhe krijimi i Katalogut të Kadastrës të Ujërave të Shqipërisë, për shfrytëzim integral dhe kompleks të tyre nga degë të ndryshme të ekonomisë duke ruajtur ekuilibrin hidroekologjik në natyrë në përputhje me standardet dhe normat ndërkombëtare.

Shqipëria është një vend që nuk i mungojnë burimet me ujë të ëmbël. Aktualisht vendi nuk rrezikon të kalojë një krizë uji, por zhvillimi i shpejtë i sektorit privat, procesi i urbanizimit, rehabilitimi i skemave ujitëse dhe planet për zgjerimin e kapacitetit hidroenergjetik mund të jenë premisa për të shkaktuar mosmarrëveshje në lidhje me burimet ujore, në nivel lokal dhe kombëtar. Për të shmangur një fenomen të tillë nevojitet që institucionet përgjegjëse të ndërmarrin nisma ligjore dhe veprime konkrete për menaxhimin dhe mirë përdorimin e këtyre burimeve jetike për vendin.

Përqendrimi i investimeve afatshkurtra dhe afatgjata në fushat e mëposhtme: sigurinë e digave, mbrojtjen nga përmbytjet, mbrojtjen dhe restaurimin e zonave të lagëta dhe administrimin e ujëmbledhësve.

Ruajtja dhe mbrojtja e rrugëve ujore dhe rezervave të ujit të pijshëm nga sulmet terroriste.

Ndërgjegjësimi i opinionit publik për të mbrojtur konsumimin e ujit, në rritjen e ndërgjegjes së njerëzve, për burimet e kufizuara të ujit në natyrë.

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

Bibliografia

1. Qirjazi Perikli: Artikulli në gazetën "Panorama" 11.01.2021.
2. Si të mbrohem nga fatkeqësitë e natyrës dhe katastrofat humanitare. Fq.44deri 49
3. Strategjia e Sigurisë Kombëtare.
4. Instituti i studimeve e projektimieve hidrikoteknike. Tiranë
5. Hidroenergjitikë, 1949-1999 fq. 20.
6. Velu Përparim: Revista Mbrojtja nr. 2, viti 2009 faqe 18- 20
7. Digat dhe dambat në Shqipëri. Buletin teknik. Tiranë 2005
8. Raport i zhvillimit të Kombeve të Bashkuara. Vlerësimi i rreziqeve në Shqipëri fq 49 deri 63
9. Revista Mjedisit sot, Nr 127 2010
10. Pasha Myslim: Gjeografia ushtarake. Qendra e shtypit dhe botimeve ushtarake.
11. Konferenca e parë kombëtare. Uji pasuri e madhe kombëtare. Tiranë. Tetor 1996
12. Akademia e Shkencave, Instituti Hidrometeorologjik: Hidrologjia e Shqipërisë, Tiranë 1984
13. Akademia e shkencave Instituti Hidrometeorologjik: Veçori klimatike dhe hidrologjike të ultësirës perëndimore. Tiranë 1985
14. Administrimi i qëndrueshëm i ujrave të brendshëm dhe detare në Shqipëri. Nëntor 2002.
15. World Bank. 2003. Flood Profile for Albania. Prepared by Lucy Hancock from a report by Molnar Kolanec for the World Bank, 2000. Washington, DC, USA.
16. Konferenca Ndërkombëtare e Ujit. Stamboll 16 – 22 mars 2009
17. *Joap de Hoop Scheffer* NATO-JA: DEKADA E ARDHSHME në Agjendën e Sigurisë Dhe Mbrojtjes (SDA)
18. The Global Water Crisis and the Coming Battle for the Right to Water
19. Q&A: Water Crisis Could Affect Billions Thalif Deen interview GER BERGKAMP of the World Water Council, United Nations.
20. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e RSH, *Prezantohet Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha dhe Këshilli Teknik*, (Tiranë: 22.9.2020).
21. <https://www.infrastruktura.gov.al/prezantohet-komiteti-kombetar-i-digave-te-medha-dhe-keshilli-teknik>
22. Erjon Kalaja, *Tërmetet duhet të na bëjnë të shikojmë menjëherë sigurinë e digave*, (Tiranë: Exit.al, 26.9.2019).
23. Foto Duro, "Menaxhimi i emergjencave civile në Shqipëri", në: Konferenca kombëtare, Menaxhimi i Emergjencave Civile në Shqipëri (Tiranë: IDM, 2015).
24. Mihallaq Qirjo et al. Alternativa mjedisore e hec-eve të vegjël, Studim alternativ për ndikimin social, ekonomik dhe mjedisor të HEC-eve të vegjël në rrjedhjet ujore në Shqipëri. Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Tiranë, Shtator 2015.

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »



AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

Roli i forcave të sigurisë publike në situata të fatkeqësive natyrore



■ **Prof. asc. dr. Idriz HAXHIAJ**
*Drejtoria e Përgjithshme e
Zhvillimit për Rendin, Sigurinë
Publike dhe Çështjeve Vendore,
Ministria e Brendshme
Idriz.Haxhij@mb.gov.al*



■ **Dr. Dorlana PANO**
*Shef e Departamentit
të Shkencave
Politiko-Administrative,
Fakulteti i Shkencave Sociale,
Albanian University, Tiranë*



■ **MSc. Besjana LAZJA**
*Specialiste
Sektori i Kërkimit, Analizës
dhe Programet e Zhvillimit,
Ministria e Brendshme
Besjana.Lazja@mb.gov.al*

Abstrakt

Ndryshimet klimatike po shtojnë gjithnjë e më shumë fenomenet ekstreme të natyrës. Shqipëria renditet në listën e vendeve me rrezikshmëri të lartë në Evropë sa i takon fatkeqësive natyrore. Kryesisht, Shqipëria është e ekspozuar nga fenomenet natyrore, si tërmetet, zjarret, përmbytjet etj. Ndikimet e këtyre fatkeqësive natyrore kanë qenë të mëdha dhe kanë sjellë në vëmendje nevojën për një bashkëpunim e angazhim më të thelluar ndërinstitucional në menaxhimin e tyre. Policia e Shtetit është ndër institucionet shtetërore në Republikën e Shqipërisë që angazhohet që në momentet e para në raste të fatkeqësive natyrore. Nisur nga kjo qasje, qëllimi i këtij punimi është të paraqesë rolin e Policisë së Shtetit në menaxhimin e situatave të fatkeqësive natyrore. Punimi propozon një kornizë konceptore të integruar që merr parasysh ndërveprimin kompleks të attributeve mjedisore, sociale, qeverisjes, infrastrukturës dhe ekonomike që lidhen me qëndrueshmërinë e komunitetit. Gjithashtu, punimi paraqet rekomandimet e nevojshme për forcimin e angazhimit të Policisë së Shtetit në menaxhimin e emergjencave civile.

Fjalëkyçe:

fatkeqësi natyrore, siguri, siguria në komunitet, policia e shtetit, emergjencë civile, menaxhim, koordinim.

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në
komunitet në
kontekstin
e kërcënimeve
nga fenomenet
ekstreme
natyrore dhe
nevojave për
përballimin e
emergjencave
civile »

1. Hyrje

Ndryshimet klimatike kanë rritur shpeshësinë dhe ashpërsinë e ngjarjeve ekstreme të motit, të cilat paraqesin sfida të rëndësishme për aftësinë e qeverisë dhe agjencive të tjera të ndihmëse për të planifikuar, përballuar dhe reaguar ndaj fatkeqësive. Fatkeqësitë natyrore prekin në mënyrë të drejtpërdrejt çështjet e sigurisë njerëzore, mjedisore, ekonomike etj. Në legjislacionin shqiptar, konkretisht në ligjin nr. 45/ 2019, “Për Mbrojtjen Civile”, *Emergjencë civile ,sht , situata e papritur me pasoja negative për komunitetin dhe që cenon sigurinë e tij, e cila shkaktohet nga fatkeqësitë që sjellin dëme të menjëhershme e të rënda për jetën e njerëzve, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin*¹. Siç e përmendëm edhe më lart, Shqipëria listohet në vendet me rrezikshmëri të lartë nga fenomenet e katastrofave natyrore. Në 20 vitet e fundit më tepër se 690 000 persona janë prekur nga fatkeqësitë me një mesatare prej rreth 34 000 persona të prekur në vit. Duke iu referuar popullsisë së vitit 2011, kjo përfaqëson një mesatare prej 1.2 % të popullsisë totale të prekur çdo vit (më shumë se 1 person në 100 banorë). Shuma totale e humbjeve të regjistruara në 20 vitet e fundit është rreth 10.5 miliardë LEK (92 mln. dollarë USA) me një mesatare humbjesh prej më tepër se 500 mln. lek (0.026 % të PBB mesatar të 20 viteve të fundit)².

Zhvillimi i një sistemi efektiv në menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë në Shqipëri kërkon angazhimin e të gjithë aktorëve, sidomos atyre kryesorë në procesin e përmirësimit të kapaciteteve brenda sistemit. Për të garantuar një komunitet më të fortë dhe më të qëndrueshëm ndaj fatkeqësive natyrore është thelbësore që komuniteti të ketë një kuptim më të mirë të aftësive aktuale, duke vlerësuar rreziqet dhe dobësitë në mënyrë që pikat e forta të konsolidohen dhe rreziqet e cënueshmëria të adresohen përmes programeve të ndërtimit të kapaciteteve³ duke i minimizuar ato gjithnjë e më tepër. Rrjedhimisht, është e rëndësishme që komunitetet që jetojnë në zona me klimë të

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

¹ Ligji nr. 45/2019 “Për mbrojtjen Civile” neni 3, pika 6.

² https://www.preventionweb.net/files/36736_37422zppdmbledhjaetedhenavehistorik.pdf

³ Perez. A, 2018

ndjeshme dhe të prira ndaj fatkeqësive të mundshme të forcojnë qëndrueshmërinë e tyre ndaj fatkeqësive natyrore në mënyrë që të rikuperohen shpejt nga ndërprerjet e shërbimeve dhe dëmet e mundshme të shkaktuara nga fatkeqësitë. Garantimi i mbështetjes tek vetja dhe, veçanërisht në pasojat e menjëhershme të një fatkeqësie, mund të lehtësojë rimëkëmbjen afatshkurtër dhe afatgjatë të komunitetit.

2. Metodologjia

Punimi paraqet një model konceptor që përshkruan raportin kompleks ndërmjet fatkeqësive natyrore dhe rolit të forcave të sigurisë publike në mbështetje të komunitetit. Kjo synohet të realizohet nëpërmjet dy drejtimeve kryesore:

Së pari, nëpërmjet analizës mbi rëndësinë e qëndrueshmërisë së komunitetit në momente të fatkeqësisë natyrore dhe emergjencës civile.

Së dyti, nëpërmjet analizës së rolit të forcave të sigurisë në komunitet në menaxhimin e emergjencave civile.

Me termin *forcat e sigurisë në komunitet* nënkuptojmë të gjitha strukturat e angazhuara për ruajtjen dhe garantimin e sigurisë, mirëpo në qasjen tonë do të përqendrohemi në rolin dhe ndikimin e strukturave të policisë së shtetit, në reagimin e fatkeqësive natyrore dhe menaxhimin e tyre.

3. Një kornizë e integruar e qëndrueshmërisë së komunitetit ndaj një fatkeqësie natyrore dhe emergjence civile

Referuar studimeve të fundit të realizuara në këtë fushë, për të paraqitur kornizën e integruar të qëndrueshmërisë së komunitetit ndaj një katastrofe natyrore apo emergjence civile është e rëndësishme të pranohet se aktualisht ekzistojnë një sërë kornizash konceptore për të vlerësuar nivelin e qëndrueshmërisë së komuniteteve ndaj fatkeqësive. Qëndrueshmëria e komunitetit është një koncept kompleks që përfshin dimensione të ndryshme të tij. Në terma të gjerë, ekziston një konsensus i përgjithshëm në literaturën e sotme se qëndrueshmëria e komunitetit përbëhet nga pesë komponentë kryesor, të cilët në kuadrin e propozuar quhen fusha tematike. Ato janë dimensionin mjedisor, dimensionin social, dimensionin i qeverisjes, infrastrukturor dhe ai ekonomik. Prandaj, qëndrueshmëria e përgjithshme e komunitetit mund të konsiderohet si funksion i këtyre pesë fushave tematike.



Figura 1. Pesë dimensionet tematike të qëndrueshmërisë së komunitetit

Dimensioni mjedisor i referohet karakteristikave të lidhura me vendin dhe që kontribuojnë në mbijetesën apo dhe në rimëkëmbjen e shpejtë të komunitetit dhe mund të përmenden karakteristikat dhe qëndrueshmëria e tokës, niveli i ujit dhe prezenca e lumenjve, ndërtimi i masave mbrojtëse, pozicioni gjeografik, etj. Variabëliti brenda këtij dimensionit janë dy komponentë përbërës, përkatësisht mjedisi natyror dhe mjedisi i ndërtuar nga njeriu. Lidhja e këtyre variabëlve në të dy mjediset, lejon për një shqyrtim të ndërveprimeve të mundshme midis mjedisit natyror dhe atij të ndërtuar dhe implikimet e tyre për qëndrueshmërinë e komunitetit.

Qëndrueshmëria sociale i referohet karakteristikave që mbështesin përbërjen sociale dhe kulturore të një komuniteti. Variabëliti brenda fushave kyçe të demografisë, kapitalit social dhe karakteristikave kulturore ofrojnë një pasqyrë mbi tiparet përcaktuese të një komuniteti dhe shkallën në të cilën ai komunitet mund të përdor këto attribute për një qëndrueshmëri më të lartë sociale në rast të një fatkeqësie natyrore.

Kapaciteti qeverisës është element i rëndësishëm në ndihmën dhe ndërtimin e komuniteteve të qëndrueshme. Roli kyç i qeverisjes fokusohet në aftësinë e qeverisë për të përgatitur komunitetin dhe për t'i bërë ballë/kapërcyer/ rimëkëmbur atë nga fatkeqësitë natyrore dhe emergjencat civile por edhe në aftësinë e saj për të garantuar një kuadër të gjithanshëm qeverisës me role e përgjegjësi të ndara qartë në përballimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore.

Dimensioni infrastrukturor i referohet aftësive të infrastrukturës fizike e cila do t'i garantonte komunitetit aftësinë për tu zhvendosur në vende të sigurt dhe në mënyrë të shpejtë si dhe vazhdimësinë e shërbimeve komunitare siç janë garantimi i ujit të pijshëm, ushqimeve, shërbimit shëndetësor, strehim, komunikimin, etj. Garantimi i vazhdimësisë së shërbimeve komunitare është thelbësor për të ndihmuar në rimëkëmbjen pas katastrofës natyrore.

Dimensioni ekonomik është i një rëndësie parësore në aftësinë e një komuniteti për të përballuar katastrofat natyrore. Qëndrueshmëria ekonomike ose mungesa e saj kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në rimëkëmbjen e komunitetit pas katastrofës.

Të kuptuarit e rëndësisë së zhvillimit të shëndoshë dhe të mire organizuar të dimensioneve ekonomik, social, infrastrukturor dhe faktorëve të tjerë të lidhur, si komunikimi, kohezioni, etj mund të ndihmojë shumë në përmirësimin e qëndrueshmërisë së përgjithshme të komunitetit në të ardhmen.⁴

Në kontekstin e shoqërisë shqiptare, niveli i ekspozimit ndaj fatkeqësive natyrore rritet edhe më shumë për shkak të infrastrukturës së dobët dhe të pazhvilluar të shërbimeve, nivelit të pa mjaftueshëm të ndërgjegjësimit të popullsisë, kapaciteteve të pa mjaftueshme të pushtetit lokal dhe agjencive të tij apo përdorimit pa kriter të territorit dhe hapësirave urbane. Tematika mjedisore është përcaktuese në ekspozimin ndaj katastrofave natyrore. Nivelet më të larta të ekspozimit janë rezultat i një numri faktorësh, duke përfshirë planifikimin e papërshtatshëm të territorit dhe përdorimin e tokës, mungesën e integritetit të kriterëve të riskut ndaj fatkeqësisë në planifikimin e zhvillimit në përgjithësi dhe në të gjitha nivelet, si dhe mungesën e respektimit të normave dhe standardeve të sigurisë. Në Shqipëri, sjellja e popullsisë shpesh ka ndikuar në rritjen e efekteve të fatkeqësive në vend. Kjo evidentohet qartë në faktet e përmendura më lart për urbanizimin e pakontrolluar e kaotik të ndodhur në dy dekadat e fundit. Nga ana tjetër, mungon një kulturë solide vullnetarizmi. Të gjitha këto tipare kulturore

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

⁴ Parsons, M (2016) *Top-down assessment of disaster resilience: A conceptual framework using coping and adaptive capacities*, International Journal of Disaster Risk Reduction,

tregojnë nivelin e ulët të qëndrueshmërisë së përgjithshme shoqërore në rastet e katastrofave natyrore dhe emergjencave civile.

4. Forcat e sigurisë publike dhe përballja me situata të emergjencave civile

Fatkeqësitë natyrore, janë padyshim një tregues shumë i rëndësishëm i cenimit të sigurisë në komunitet. Menaxhimi i tyre lidhet me mënyrën se si organizmat qeveritare, shërbimet e posaçme emergjente dhe komunitetet mund t'i përgjigjen një krize në mënyrë efikase. Që të ndodhë menaxhimi i suksesshëm i fatkeqësive, planet, procedurat dhe politikat për trajtimin e krizave të pashmangshme duhet të hartohen dhe të testohen përpara një ndodhie të fatkeqësisë⁵. Kur bëhet fjalë për menaxhimin e emergjencës, zyrtarët e zbatimit të ligjit janë pjesë kyçe e përgjigjes fillestare. Forcat e policisë, si një strukturë e sigurisë publike kanë një rol të rëndësishëm në menaxhimin e fatkeqësive. Njohja dhe kuptimi i fenomeneve kërcënuese për sigurinë kombëtare është hapi i parë i përballimit, ndërsa forcat reaguese, neutralizuese dhe përballuese janë aspekti konkret dhe i prekshëm i reagimit.

4.1 Policia e Shtetit përballë fatkeqësive natyrore

Policia e Shtetit është e pranishme në të gjithë procesin e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional strukturor për planifikimin, menaxhimin dhe përballimin e emergjencave civile në çdo lloj fenomeni të ekstremit natyror⁶.

Natyrshëm lind pyetja: cilat janë detyrat me të cilat ngarkohen strukturat e Policisë së Shtetit në rastet e emergjencave civile?

Ndër arsyt kryesore që e bën Policinë e Shtetit një aktor të rëndësishëm në menaxhimin e katastrofave natyrore dhe i jep asaj rol kryesor në momentet e para të reagimit ndaj tyre janë njohuritë e plota që ajo ka për vendin në të cilin ndodh fatkeqësia dhe marrëdhëniet e konsoliduara me komunitetin në atë zonë. Ky rol i policisë së shtetit, i pazëvendësueshëm nga asnjë institucion tjetër shtetëror, sugjeron që policia duhet ta përshtatë veten gjithnjë e më shumë për role dhe përgjegjësi të shtuara në sistemin e menaxhimit të krizave.

Nëse funksionet e Policisë së Shtetit në situata të kërcënimit të rendit e të sigurisë publike janë të mirëpërcaktuara, dhe nga ana e saj ka një kuptim të qartë mbi aftësinë dhe organizimin për të vepruar, e njëjta gjë duhet të ndodhë edhe për veprimet dhe kuptueshmërinë e saj në rastet e emergjencave civile.

Menaxhimin e fatkeqësive natyrore, Policia e Shtetit duhet ta integrojë si pjesë të strukturuar të misionit të saj dhe si një udhërrëfyes, për ngritjen e kapaciteteve dhe përsosjen e procedurave të veprimit. Lind nevoja që policia të trajnohet, të pajiset me logjistikën e duhur, por edhe me kuadrin e plotë ligjor për të vepruar në mënyrë eficiente dhe ndoshta edhe e pavarur në situata të menaxhimit të krizave. Situatat e ndryshme në vendin tonë kanë treguar që forcat dhe strukturat e specializuara jo gjithmonë janë bërë pjesë e forcës reaguese, ose kanë reaguar me vonesë dhe Policia e Shtetit ka mbajtur rolin kryesor në menaxhimin e situatës. Për më tepër, kur këto forca të specializuara veprojnë në terren të huaj dhe në një komunitet të panjohur, roli i

⁵ Drennan, McConnell, & Stark, (2015) *Risk and crisis management in the public sector*, New York, NY: Routledge

⁶ Revista "Policimi dhe siguria", nr. 23, 2021.

policisë bëhet edhe më i rëndësishëm.

Avantazhe të tjera organizative dhe strukturore që e bëjnë policinë e shtetit aktorë të parë reagues janë prania e strukturave policore të përhershme, me një nivel të caktuar gatishmërie, e aftë për të ndërhyrë me kapacitete të konsiderueshme në çdo zonë e rajon të vendit. Familjarizimi i saj me terrenin dhe me komunitetin, sistemet e komunikimit në përdorim të policisë, të afta për të mbuluar të gjithë territorin, por edhe perceptimi që publiku ka për Policinë e Shtetit si “shpëtimtar” i tij në çdo situatë përbëjnë vektor force për policinë.

Pa u ndalur në detyrat konkrete që policia mund të angazhohet në raste të tilla, do të veçonim aspektet kryesore ku policia e shtetit angazhohet gjatë fazës përgatitore ndaj krizave, gjatë menaxhimit të tyre dhe pas ndodhjes së fatkeqësive.

Në kuadër të planit të përgjithshëm të përballimit të emergjencave, policia e shtetit duhet të ketë planet e saj për ato funksione që ajo i përmbush në çdo kohë. Gatishmëria e *planit të emergjencës për qarkullimin e automjeteve* dhe njerëzve, të bazuara në rrugë të sigurta për transport të personelit, të burimeve, dhe të mirave materiale për në zonën e goditur nga fatkeqësia. *Planet e detajuara të komunikimit* që në raste krizash do të ndihmonin komunikimin me publikun, do të përqendroheshin për paralajmërimin e rrezikut, apo do t'i vinin në ndihmë individëve të rrezikuar si dhe për të shpëtuar sa më shumë njerëz në nevojë. Një nevojë e tillë e bën të domosdoshme për policinë zhvillimin e protokolleve të qarta të komunikimit.

Identifikimi i godinave, i rrugëve për qasje në zonën e katastrofës, në interes të një reagimi sa më efektiv nga të gjitha forcat pjesëmarrëse, apo për të siguruar materiale dhe të mira në interes të operacionit. Në çdo incident, sado i vogël, organizimi i *Plani të sigurisë* së rajonit, të viktimave, të forcave pjesëmarrëse apo i rrugëve dhe materialeve është i pashmangshëm dhe një domosdoshmëri e dorës së parë.

Angazhimet kryesore të policisë gjatë menaxhimit të krizës përfshijnë pjesëmarrjen e saj aktive në operacionet e kërkim shpëtimit, mbrojtja e pronës dhe e pasurisë publike dhe asaj private, ardhja në ndihmë të kategorive të cënueshme të shoqërisë, siç janë: gratë, fëmijët, të moshuarit etj. Izolimi i zonave të caktuara, menaxhimi i kampeve të trajtimit të popullsisë dhe i veprimtarisë së organizatave të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare, koordinimi me agjenci të ndryshme, sigurimi i informacionit për të plagosurit, viktimat dhe të sëmurët, menaxhimi dhe koordinimi i medias janë po ashtu angazhime reale të Policisë së Shtetit në menaxhimin e krizës.

Ndërkohë, me kalimin e situatës kritike të emergjencës, roli i policisë do të përqendrohet në ruajtjen e rendit dhe të sigurisë, në akomodimin e njerëzve në nevojë, në sigurinë e shpërndarjes së ndihmave dhe ushqimeve dhe në rimëkëmbjen e infrastrukturës kritike.

4.2 Sistemi i mbrojtjes civile në Shqipëri

Sistemi i mbrojtjes civile në Shqipëri konsiston në struktura të përhershme e të përkohshme në nivel qendror, në nivel prefekturë dhe në atë vendor. Janë rreth 20 institucione e agjenci në nivel qendror dhe rreth 15 organizata në dy nivelet e tjera, të cilat aktivizohen në mënyrë të rregullt me çështjet e emergjencave civile⁷.

Bazuar në ligjin nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” strukturat operacionale të mbrojtjes civile, që angazhohen në përballimin e fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

⁷ IDM “Menaxhimi i Emergjencave Civile në Shqipëri”

të tjera, janë:

- Forcat e Armatosura;
- Policia e Shtetit;
- Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit;
- Shërbimi i Urgjencës Mjekësore dhe strukturat e tjera të shërbimit shëndetësor;
- Shërbimi i vullnetarëve për mbrojtjen civile.⁸

Në rolin e tyre operacional, këto struktura, kryejnë veprimtari veçmas ose në bashkëpunim me njëra-tjetrën, me qëllim menaxhimin e fatkeqësive. Konkretisht, veprimtaria e tyre lidhet me planifikimin, kërkim-shpëtimin, dhënien e ndihmës dhe të asistencës në raste fatkeqësish, sigurinë dhe mbrojtjen e zonës së emergjencës civile, rimëkëmbjen e zonave të dëmtuara, si dhe çdo veprimtari tjetër për përballimin e situatës së krijuar.

Strukturat e Policisë së Shtetit, krahas përmbushjes së detyrave të përditshme, janë përfshirë drejtpërsëdrejti edhe në përballimin dhe menaxhimin e emergjencave civile, konkretisht në situatat e krijuara nga tërmetet, nga përmbytjet, situatat e krijuara nga zjarret, rrëshqitjet e dheut. Në nenin 76 të ligjit “Për Policinë e Shtetit” përcaktohet përgjegjësia e policisë në bashkëpunim me komunitetin në garantimin e rendit dhe sigurisë publike për ushtrimin e plotë të lirive dhe të të drejtave të personave, për rreziqet që mund t’u kanosen nga situatat e fatkeqësive natyrore e atyre aksidentale⁹. Më tej, në pikën 3 të po atij neni, Policia e Shtetit, në bashkëpunim me komunitetin, organizon policimin vullnetar për përballimin e emergjencave civile.

Në situatën e krijuar pas tërmetit të datës 26 nëntor 2019, në qarkun e Tiranës dhe të Durrësit janë angazhuar 1000 punonjës policie, disa ditë radhazi, në operacionet e kërkim-shpëtimit. Në këto operacione u përfshinë Forcat e Lëvizshme Operacionale, FNSH-ja, Forcat e Posaçme “Shqiponja”, Patrullat e Përgjithshme, Policia Rrugore dhe ajo Kriminale, si dhe qentë e kërkimit të gjurmëve. Gjithashtu, struktura të Policisë janë angazhuar edhe në rastet e tjera të nevojave emergjente. Strukturat e Policisë së Shtetit janë përfshirë edhe në operacionet e kërkim-shpëtimit në situatën e përmbytjeve të shkaktuar nga moti i keq me reshje shiu, në Vlorë, Fier, Tiranë dhe disa fshatra të Shkodrës, gjatë vitit 2020 dhe vitit 2021. Në këto operacione janë përfshinë 500 punonjës policie të DVP Vlorë, Fier, Tiranë dhe Shkodër, si dhe një skuadër e specializuar e kërkim-shpëtimit, e përbërë nga 11 punonjës të FNSH-s Shkodër. Në situatat emergjente të krijuara si pasojë e motit të keq, në zonat malore në Korçë, Dibër, Shkodër, Kukës dhe Gjirokastrë, gjatë vitit 2020 dhe vitit 2021, janë përfshirë 200 punonjës policie, për t’iu ardhur në ndihmë banorëve dhe barinjve që kishin mbetur të bllokuar nga bora.

Angazhimi ka vijuar gjatë pandemisë COVID-19, në të gjitha qarqet e vendit, me pjesëmarrjen e të gjitha strukturave policore. Në operacionet kundër përhapjes së COVID-19, në periudhën 2020-2021, janë përfshirë rreth 6000 punonjës policie, me qëllim parandalimin e infektimit të popullatës me virusin COVID-19. Mund të themi se në luftimin e përhapjes së pandemisë, strukturat e policisë u angazhuan në detyra shtesë.

5. Përfundime dhe rekomandime

Në përfundim mund të evidentojmë rëndësinë e qëndrueshmërisë së komunitetit

⁸ Ligji nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 32.

⁹ Ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit (i ndryshuar), neni 76

në reagimin dhe përballimin e emergjencave civile. Qëndrueshmëria e komunitetit lidhet ngushtë me pesë komponentë, që studimet e ndryshme i kanë përcaktuar si fusha tematike të qëndrueshmërisë së komunitetit, të cilat janë: mjedisi, ana sociale, qeverisja, infrastruktura dhe qëndrueshmëria ekonomike. Funksionimi (ose jo) i duhur, ndërmjet këtyre fushave tematike përcakton nivelin e reagimit të një komuniteti ndaj një fatkeqësie natyrore apo emergjence civile. Të dhënat dhe konteksti historik në Shqipëri dëshmojnë për një nivel të ulët të qëndrueshmërisë e komunitetit në reagimin ndaj emergjencave civile.

Komponent tjetër i rëndësishëm që e ndërtoi këtë punim është roli i forcave të sigurisë në komunitet në reagimin dhe menaxhimin e emergjencave civile. Konkretisht, fokusi i punimit ishte roli i forcave të policisë së menaxhimin e emergjencave civile. Në përfundim mund të themi se forcat e policisë janë një ndër strukturat e para reaguese në raste të emergjencave civile. Të dhënat statistikore tregojnë angazhimin e forcave të policisë së shtetit në të gjitha rastet e emergjencave civile që kanë ndodhur në Shqipëri, duke nisur me përmbytjet, situatat e krijuara nga zjarret, rrëshqitjet e dheut, tërmetet dhe angazhimin e të gjithë strukturave policore në parandalimin e pandemisë COVID-19.

Rekomandime

1. Ky punim rekomandon përshtatjen dhe zhvillimin e Policisë së Shtetit gjithnjë e më shumë për role dhe përgjegjësi të shtuara në sistemin e menaxhimit të krizave. Menaxhimin e fatkeqësive natyrore, policia e shtetit duhet ta integrojë si pjesë të strukturuar të misionit të saj dhe si një udhërrëfyes për ngritjen e kapaciteteve dhe përsosjen e procedurave të veprimit.

2. Gjithashtu, rekomandojmë dhe evidentojmë nevojën që policia e shtetit të trajnohet, të pajiset me logjistikën e duhur por edhe me kuadrin e plotë ligjor për të vepruar në mënyrë eficiente, pse jo, edhe në mënyrë të pavarura në menaxhimin e fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile.

Bibliografia

1. Drennan, L. T., McConnell, A., & Stark, A. (2015). *Risk and crisis management in the public sector*. New York, NY: Routledge.
2. IDM "Menaxhimi i Emergjencave Civile në Shqipëri", Tiranë.
3. Ligji nr. 45/2019 "Për mbrojtjen Civile"
4. Ligji nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit (i ndryshuar),
5. Melissa M Teo., & Ashantha, Goonetilleke., & Abdul M Ziyath. (2015). *An integrated framework for assessing community resilience in disaster management*. Queensland University of Technology
6. Parsons, M., Glavac, S., Hastings, P., Marshall, G., McGregor, J., McNeill, J., Stayner, R. (2016). *Top-down assessment of disaster resilience: A conceptual framework using coping and adaptive capacities*. International Journal of Disaster Risk Reduction,
7. Perez, Amanda. (2018). *The Role of Law Enforcement-Community Communication in Disaster Readiness*. Walden Univrsity.
8. Revista "Policimi dhe Siguria", Nr. 23, 2021.
9. https://www.preventionweb.net/files/36736_37422zppdmbledhjaetedhenavehistorik.pdf

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

Sistemi i sigurisë publike dhe alternativa të zhvillimit



■Prof. asc. dr. Barjam YZEIRAJ

Universiteti "Barleti"

barjamyzeiraj@umb.edu.al

Abstrakt

Siguria në kohën e sotme, për shkak të problematikës që paraqet, ka ngjallur interes të veçantë dhe është shndërruar në një prioritet për politikën ndërkombëtare e atë kombëtare. Historikisht ajo është konceptuar e trajtuar si një funksion apo atribut i shtetit, por gjatë globalizmit me zbehjen e autoritetit të shtetit për kufijtë, kuptimi rreth saj dhe rolin e shtetit janë zgjeruar. Siguria publike, si një komponent i rëndësishëm i sigurisë kombëtare, është e lidhur ngushtësisht me mbrojtjen e të drejtave e lirive themelore të njeriut dhe qasje të tjera të sigurisë. Vlerësimi i saj duke e identifikuar me kriminalitetin (viktimitetin nga krimi) dhe anashkaluar pasojat që shkaktojnë bartësit e tjerë të rrezikut; të cilat trajtohen si fatkeqësi që i takojnë mbrojtjes civile, është shndërruar në objekt diskutimi midis aktorëve shtetërorë e shoqërorë dhe njëherësh një problem për zgjidhje. Duke vlerësuar politikën e qeverisjes për sigurinë publike dhe efektivitetin e mekanizmit shtetëror, të cilët vazhdojnë të kërkojnë përgjegjësinë tek organi i vetëm (Policia e shtetit); si dhe vlerësimet e aktorëve të ndryshëm; rezulton se ka problem të natyrës konceptore, politike, institucionale, profesionale dhe aftësive menaxhuese që duhen konsideruar e korrigjuar.

Objekti i kumtesës është, ndriçimi i kuptimit mbi sigurinë publike dhe politikat e qeverisjes; vlerësimi i mekanizmit (sistemit) shtetëror përgjegjës dhe reagimit shtetëror e shoqëror, si dhe shtrimi i disa rekomandimeve për të zhvilluar më tej sistemin e politikave të qeverisjes. Qëllimi i trajtimit të kësaj teme është; së pari të sjellim në vëmendje kuptimin mbi sigurinë publike dhe politikat e qeverisjes, për të nxitur debatin në mjedisin akademik, organet shtetërore përgjegjëse dhe opinionin publik dhe së dyti të evidentojmë disa alternative për ndryshim të politikës, unifikim të sistemit e aktorëve përgjegjës dhe përforsim të menaxhimit e bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe sipërmarrjen private.

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

Fjalëkyçe:

siguria publike, sistemi i sigurisë publike, mbrojtja civile, politika e qeverisjes, organe, institucione, autoritete, administratë, shërbime të sigurisë, analizë, strategji, menaxhim.

Hyrje

Sot, ne jetojmë në një botë, ku njerëzit dhe siguria e tyre janë të lidhura ngushtë midis tyre. Për sigurinë publike e cila ndërthur atë individuale, komunitare e qasje të tjera, konceptimi dhe vlerësimet janë të ndryshme.

Arsyet që më nxisin të trajtoj këtë temë, lidhen me defektet në sistemin e sigurisë publike dhe keqimplementimin e filozofisë së qeverisjes në këtë fushë; e cila edhe pse programon bashkëqeverisjen me aktorë të tjerë shtetërorë, të sipërmarrjes e shoqërisë dhe deklaron prioritet politikën e shërbimit ndaj qytetarëve dhe parandalimit social; në veprimtarinë praktike promovon forcimin e fuqisë shtrënguese dhe kërkon përgjegjësinë për sigurinë vetëm tek organi i Policisë së shtetit.

1. Kuptimi mbi sigurinë publike

1.1. Siguria publike dhe interpretimet rreth saj

Siguria si term ka kuptime e interpretime të ndryshme; për rrjedhojë në vartësi të përmbajtjes, objektit të trajtimit e qëllimit, ajo merr emërtime e cilësime të ndryshme. Vetë siguria është një nevojë (kërkesë) themelore dhe e përhershme e individit e shoqërisë njerëzore. Sa më shumë zgjerohet aktiviteti i tyre, aq më shumë shtohen kërcënimet e rreziqet, ndaj dhe paralelisht rriten edhe kërkesat për siguri, çka sjell edhe zgjerimin e kuptimeve të konceptit.

Siguria individuale trajtohet e merr kuptim në raport me mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave e lirive themelore të individit në një shoqëri demokratike, pra të jetës, shëndetit, sigurisë, pronës, lëvizjes, organizimit etj, të cilat sipas kushtetutës, ” janë të

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të gjithë rendit juridik”¹.

Për sigurinë publike nuk ka ndonjë përcaktim ligjor, ndaj dhe kuptimi, interpretimi e vlerësimi rreth saj është i ndryshëm. Gjendja e sigurisë publike, është e lidhur me vlerësimin e burimeve (bartësve) të rrezikut dhe pasojat që sjellin ato; të cilat shkaktohen nga veprimet e njeriut ose fuqitë e natyrës.

Referuar krimit, si burimi kryesor i rrezikut dhe pasojave të tij (të dëmtuarit), përdoret kriteri i klasifikimit juridiko-penal të veprave me rrezikshmëri shoqërore, bazuar në:

a) Objektin e marrëdhënieve shoqërore që mbrohen. Në *Kodin penal*, tek “Veprat penale kundër rendit e sigurisë publike” përfshihen; organizimi dhe pjesëmarrja e kundërligjshme në tubime, pjesëmarrja me armë, largimi nga vendi i aksidentit, aktet e dhunshme në veprimtari sportive, veprat për prodhim e mbajtje armësh, ato kundër drogës, shkeljen e rregullave në punë, aksidentet në qarkullimin rrugor etj.”²

b) Anën objektive, (mekanizmin e kryerjes, mënyrat e mjetet e përdorura dhe pasojat e shkaktuara). Sipas këtij kriteri, vëllimi i përgjithshëm i veprave penale dhe pasojave të tyre (viktimitetit), identifikohet me treguesit e sigurisë.

Referuar burimeve (bartësve) të ndryshëm të rrezikut (në kuptimin e gjerë), që ndikojnë në gjendjen e sigurisë, pavarësisht nga klasifikimi ligjor që u bëhet; përveç veprimeve të njeriut (kriminalitetit), duhet të vlerësohen edhe bartësit e tjerë të rrezikut që kanë të bëjnë me fatkeqësitë natyrore e ekologjike (tërmete, përmytje, shembje, ngrica, thatësira etj); ngjarjet aksidentale (ndërtime, zjarre, qarkullim rrugor, teknologji, prodhim, armët e dëmtimit masiv etj); epidemitë, drogat, AIDS etj.

Duke qenë faktorët dhe shkaqet që ndikojnë tek siguria të ndryshme e komplekse, edhe përgjegjësitë për përballimin e tyre janë komplekse, që do të thotë se duhet të organizohet e përgjigjet i gjithë sistemi i organeve shtetërore e shoqërore.

Vlerësimi jashtë kriterëve shkencore e indikatorëve të matshëm i nivelit të sigurisë publike; çon në diagnostikim të njëanshëm të gjendjes dhe shkaqeve, e për rrjedhojë krijon konfuzion e pasiguri në komunitet, ndikon negativisht në planifikimin dhe zhvillimin e politikave të qeverisjes për garantimin e sigurisë individuale e asaj publike.

2. Sistemi dhe politikat për sigurinë publike

Sistemi i sigurisë publike, përbën një mekanizëm të gjerë, ku përfshihen disa organe e institucione shtetërore, sipërmarrja e lirë, shoqëria dhe qytetarët; me përgjegjësi e kompetenca ligjore, raporte të caktuara midis tyre dhe procedura standarde; për të afruar shërbime të ndryshme për qytetarët, shtetin dhe shoqërinë. Qëllimi i ngritjes e funksionimit të këtij sistemi është të mbrojë individin, shtetin e komunitetin, duke mbajtur nën kontroll e shmangur pasojat që mund të vijnë nga burimet (bartësit) e rrezikut ku përfshihen përveç kriminalitetit edhe fatkeqësitë natyrore e ngjarje të tjera.

Sistemi i sigurisë publike

Aktorët që përbëjnë këtë sistem mund ti grupojmë, në:

1. organe të zgjedhura të pushtetit shtetëror,
2. organe të administratës shtetërore,
3. sipërmarrja private, shoqëria civile dhe qytetarët,
4. sistemi i drejtësisë.

Sistemi, mund të paraqitet në formën e rrathëve të lidhur midis tyre, si më poshtë:

I pari : organet e zgjedhura të pushtetit shtetëror³

Ndër to, duhen veçuar në nivelin qendror, Kuvendi, me komisionet përkatëse; Presidenti i Republikës, si kryetar shteti, drejtues i Këshillit të Sigurisë dhe në nivelin vendor, këshillat e qarqeve e ato bashkiake⁴.

I dyti: organet e pushtetit ekzekutiv

Këshilli i Ministrave e Kryeministri, që kanë përgjegjësinë e qeverisjes edhe në fushën e sigurisë⁵; administrata shtetërore⁶, me ministritë përkatëse dhe institucionet shtetërore e prefekturat⁷.

Një rol të rëndësishëm ka Ministria e Brendshme, e cila merret me projektimin, zhvillimin, koordinimin dhe realizimin e politikave për garantimin e sigurisë publike. Në këtë grupim përfshihen edhe organet kushtetuese të pavarura si Avokati i Popullit⁸ (8), Kontrolli i Lartë i Shtetit etj.⁹

Organet e specializuara të administratës shtetërore. Këto organe, janë pjesë e administratës shtetërore dhe kanë përgjegjësi për zbatimin, ekzekutimin dhe mbrojtjen e ligjit. Nisur nga statusi, përgjegjësitë dhe pushteti (kompetencat) që ushtrojnë, ato veças dhe së bashku, prodhojnë siguri, e cila ndikon në nivelin dhe standardet e jetesës së komunitetit. Në organet e specializuara, rendisim:

Organet e policimit, ku përfshihen Policia e Shtetit¹⁰, ajo Bashkiake¹¹, Policia e Burgjeve¹², Policia Ushtarake¹³, Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit¹⁴, Shërbimi Informativ Shtetëror¹⁵, të cilët rregullohen me ligje të veçanta dhe kanë përgjegjësi e kompetenca për zbatimin e ligjit dhe garantimin e sigurisë.

Agjenci të ndryshme ligjzbatuese, ku përfshihen, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile¹⁶, që përgjigjet për shërbimet e mbrojtjes civile në raste të fatkeqësive natyrore dhe ngjarjeve të tjera që sjellin pasoja të rënda për popullsinë, ekonominë, mjedisin etj; agjenci e mbrojtjes së konsumatorit, të fëmijëve, të dhënave personale, sigurinë kibernetike, të bregdetit, turizmit, pyjeve etj.

Inspektoratet shtetërore, janë institucione të specializuara, të ngritura me ligj, në vartësi të administratës shtetërore, ku përfshihen Inspektorati i përgjithshëm¹⁷; ai i mjedisit, ushqimit, urbanistikës e ndërtimit, sanitar, të punës, përkujdesjes shoqërore, pajisjeve nën presion etj.

Tiparet e veçanta të Policisë së Shtetit, në raport me institucionet e tjera të ekzekutimit të ligjit konsistojnë në përgjegjësitë e ruajtjes së rendit publik në gjithë territorin e vendit; ushtrimin e autoritetit të Policisë gjyqësore¹⁸ për investigimin e krimit, si dhe të fuqisë esenciale që lidhet me përdorimin e forcës në emër të ligjit e pushtetit.

I treti: sipërmarrja private, shoqëria dhe qytetarët

Sipërmarrja private prodhon të mirat material dhe afron shërbime të ndryshme, ndaj dhe është e interesuar për sigurimin dhe mbarëvajtjen e veprimtarisë së vetë. Këtu përfshihen edhe shoqëritë private të sigurisë¹⁹ që afrojnë siguri duke shitur shërbimet e tyre për personat fizik, objektet e pronat e ndryshme, vlerat monetare etj. Edhe media, përbën një sistem (pushtet) të fuqishëm, që informon opinionin publik mbi problemet e ndryshme të jetës shoqërore, përfshi edhe ato në fushën e sigurisë, mbrojtur të drejtat e individit e shoqërisë dhe bërë oponencë ndaj strukturave përgjegjëse. Shoqëria civile, përfshin në gjirin e saj organizma të ndryshme si institute, organizata, shoqata, klube etj të pavarura nga shteti që punojnë me projekte konkrete në fusha të ndryshme për të drejtat e liritë e njeriut, problemet ekonomike, kulturore etj.

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

I katërti: sistemi i drejtësisë

Sistemi i drejtësisë përbëhet nga organet e ndjekjes penale, sistemi gjyqësor dhe shërbimet e tjera në funksion të drejtësisë^{20 21 22 23 24}. Ai realizon dhënien e drejtësisë nëpërmjet vendimeve për zgjidhjen e konflikteve të ndryshme civile, shkeljeve administrative; dënimin e autorëve të veprave penale dhe rivendosjen e të drejtave të shkelura. Reforma e zgjatur në sistemin e drejtësisë, ka ulur ndjeshëm jo vetëm kapacitetet por dhe cilësinë e hetimit e sistemit gjyqësor; për rrjedhojë janë krijuar vonesa në gjykimin e çështjeve të ndryshme, përfshirë korrupsionin në nivelet e larta.

Në sistemin e sigurisë publike, një rol të veçantë luajnë autoritetet drejtuese, të cilët përgjigjen për drejtimin e mbarëvajtjen e punëve në institucione. Në autoritete e larta shtetërore, përfshihen Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit dhe Kryetari i Këshillit të Ministrave, ministrat, që ushtrojnë detyrat e kompetencat dhe mbajnë përgjegjësi sipas kushtetutës e ligjeve përkatëse.

Në pushtetin ekzekutiv, një rol të veçantë kanë, ministri i Brendshëm, i cili është autoriteti më i lartë politik dhe administrativ, që ka përgjegjësinë për sigurinë publike; hartimin dhe zbatimin e politikave të veprimtarisë të Policisë së Shtetit dhe strukturave të tjera në vartësi; drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit²⁵, i cili është autoriteti më i lartë ekzekutiv, administrativ e operacional i policisë që përgjigjet drejtpërdrejt para ministrit të Brendshëm për realizimin e politikave, performancës dhe objektivave të përcaktuar; si dhe drejtuesit e agjencive e shërbimeve të tjera. Në nivelin vendor, autoritetet përgjegjëse të sigurisë publike janë kryetari i këshillit të qarkut, ai i këshillit bashkiak, kryetari i bashkisë²⁶ dhe prefekti i qarkut²⁷; ndërsa për organet e specializuara të sigurisë, janë drejtori i policisë së qarkut dhe shefi i komisaritit të policisë.

Raporti i sistemit të sigurisë publike me atë të mbrojtjes civile²⁸

Sistemi i sigurisë publike përbën një mekanizëm të gjerë, me organe e institucione shtetërore, sipërmarrjen e lirë, shoqërinë e qytetarët; përgjegjësi e kompetenca ligjore, raporte të caktuara midis tyre për t'u shërbyer qytetarëve, shtetit dhe shoqërisë. Si i tillë, ai përfshin edhe atë të mbrojtjes civile. Në ndryshim nga sistemi i mbrojtjes civile, për sistemin e sigurisë publike nuk ka një ligj të veçantë, ku të jenë përcaktuar organet, institucionet e autoritetet përgjegjëse dhe raportet midis tyre. Çdo organ është ndërtuar e funksionon mbi bazën e ligjit të veçantë. Boshllëku ligjor, përbën shkak për njëanshmëri dhe mangësi në procesin e bashkëpunimit të veprimtarisë e shërbimeve në zbatimin e ligjit e luftën kundër krimit; gjë që ndihet edhe në rastet e fatkeqësive madhore, ku angazhohen të gjithë aktorët e sigurisë.

2.2 Politikat e qeverisjes për sigurinë publike

Politika për sigurinë publike, është pjesë përbërëse e politikës qeverisëse dhe përfshin tre elementë të lidhur ngushtë, përkatësisht: a) kuadri ligjor (legjislacioni), b) organet dhe strukturat përgjegjëse, c) programet dhe strategjitë e veprimit.

Ky sistem është i organizuar aktualisht dhe vlerësohet i plotë e funksional, me tregues përgjithësisht pozitivë për sigurinë individuale e atë publike. Në pamundësi për t'i trajtuar të gjithë elementët e mësipërm, do të ndalemi te tre pikat e mëposhtme.

a) Funksionimi i organeve/organizmave kolegjiale për sigurinë publike

Nga ngjarjet e ndodhura dhe analizat, rezulton se sistemi i organeve që kanë përgjegjësi në fushën e sigurisë, vuan nga njëanshmëria dhe mungesa e bashkëpunimit. Roli i organizmave pranë organeve, si komitete apo këshilla; përfshi edhe komitetet

ndërministrorë të ngritura për luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit e drejtime të tjera, përgjithësisht është pasiv dhe jo produktiv.

Më problematike paraqitet gjendja në nivelin vendor, ku nuk ka organizma kolegjiale për të vlerësuar dhe koordinuar punët e mbajtur përgjegjësi për sigurinë, e cila u ka ngjatur vetëm strukturave të Policisë së shtetit. Roli i autoriteteve drejtuese të organeve të vetëqeverisjes dhe prefektit është minimal dhe përpjekjet për të ngritur Këshillat e sigurisë vendore (KSV) nuk kanë dhënë rezultatin e pritshëm.

Në aspektin institucional, defekti qëndron tek mungesa e organeve e autoriteteve përgjegjëse në nivelin qendror e atë vendor, për të vlerësuar kërcënimet e rrezikun, programuar veprimet dhe koordinuar reagimin shtetëror; si dhe aftësitë menaxhuese në të gjitha nivelet e organeve shtetërore.

b) Strategjia e rendit publik dhe sigurisë në komunitet²⁹

Është një dokument i nivelit strategjik ndërministror, që ridimensionon konceptin dhe sistemin e sigurisë së komunitetit; identifikon përparësitë dhe objektivat strategjike, aktorët shtetërorë e shoqërorë përgjegjës. Strategjia parashikon ngritjen në nivelin vendor të këshillave të sigurisë publike (KVSP) si organizëm këshillimi, por nuk e zgjidh problemin e shtruar; gjë që u duke dhe gjatë pilotimit të bërë në disa bashki (pohim i shkruar në strategji).

Krahas këtij dokumenti, ekzistojnë dhe shumë programe e strategji të tjera shtetërore që përcaktojnë politikat për veprimtari e shërbime të ndryshme publike, të cilat ndikojnë direkt apo indirekt, në zbutjen e faktorëve dhe shmangien e kërcënimeve të ndryshme për sigurinë individuale, atë publike e shtetërore³⁰⁻⁴².

Duke analizuar këto dokumente të nivelit strategjik dhe veçanërisht ato të organeve të specializuara për sigurinë publike e drejtime të veçanta të saj, gjen disharmoni në vizionin dhe prioritetet e përcaktuara, harmonizimin e planifikimit vertikal e horizontal, të burimeve të nevojshme etj.

Më shumë defektet janë në procesin e implementimit të programeve e planeve të veprimit, për shkak të mosmbështetjes me burimet e duhura, aftësisë menaxhuese nga ekipet e drejtimit, deformimit nga vendimmarrja politike etj. Për ilustrim sjell në vëmendje urdhrin e titullarit të Ministrisë së Brendshme në vitin 2005 për mbylljen e Akademisë së Policisë, duke shkelur ligjin e abuzuar me pushtetin; ç'ka solli dhe pasoja të rënda për arsimin dhe kualifikimin e policisë.

c) Strategjia për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë natyrore⁴³

Është një dokument i nivelit strategjik që evidenton burimet e rrezikut, sistemin e mbrojtjes civile dhe politikat e qeverisjes në këtë fushë, ku ndërthuren përgjegjësitë e detyrimet e shumë aktorëve shtetërorë.

Parë me kujdes sistemin e ngritur për tu përballur me burimet (bartësit) e rrezikut, rezultojnë dy të tillë. I pari është Policia e shtetit me organe e agjenci të tjera, të organizuar në mënyrë të centralizuar, që shërbejnë për të afruar siguri, duke u marrë me zbatimin e ligjit, parandalimin dhe luftën kundër krimit. I dyti është Agjencia kombëtare e mbrojtjes civile, e organizuar dhe kjo në mënyrë të centralizuar nga niveli qendror deri në atë vendor, pranë qarqeve e bashkive, që përgjigjet për emergjencat civile të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore e ngjarje të tjera aksidentale.

Ky format organizimi, ku funksionojnë dy sisteme organesh shtetërore, në një vënd me popullsi të vogël, krijon vështirësi për funksionimin dhe realizimin e misionit të

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

ngarkuar.

3. Disa alternativa zhvillimi për sigurinë publike

Vështruar në tërësi, sistemi dhe politikat për sigurinë publike, janë formatuar e zhvillohen mbi bazën e legjislacionit, i cili është i përqasur me atë europerëndimor dhe është funksional në shërbim të qytetarëve e komunitetit. Megjithatë janë zhvilluar reforma të vazhdueshme, ende sistemi i organeve dhe infrastruktura ligjore e institucionale kanë defekte, për shkak të modeleve të ndryshme të aplikuara, filozofisë së përdorur, veprimtari në mënyrë sektoriale dhe bashkëpunimit ndërinstitucional.

Për rrjedhojë, faktorët dhe shkaqet e nivelit të sigurisë publike, duhen kërkuar në radhë

të pare tek sistemi i sigurisë publike dhe funksionimi i tij; mënyra e qeverisjes dhe politikat që ndiqen; burimet e pamjaftueshme dhe përdorimi i tyre; e së dyti tek standardet dhe efienca organeve të specializuara (Policia e Shtetit, organet e tjera të policimit dhe agjencitë ligjzbatuese).

3.1 Çfarë duhet ndryshuar në politikën e qeverisjes për sigurinë?

Në ndryshim nga politika ekzistuese, ku përgjegjësia për sigurinë i është lënë po thuaj një organi të vetëm (Policisë së shtetit); duhet organizuar i gjithë sistemi i organeve e mekanizmave të përcaktuara në ligj, duke ndërtuar një proces gjithëpërfshirës dhe angazhuar të gjithë aktorët shtetërorë e shoqërore që kanë mundësi e kapacitete për të kontribuar.

Ndër alternativat e zhvillimit, evidentojmë:

a) Vlerësimi i sigurisë në nivel kombëtar (të unifikuar) duke konsideruar të gjitha burimet e rrezikut e pasojat dhe harmonizuar planifikimin.

Kjo do të thotë të vlerësohen në unitet të gjithë bartësit e rrezikut e pasojat që sjellin, pavarësisht nga klasifikimi ligjor që u bëhet dhe zgjidhet që jepen. Ndryshimi do të japë efektet e veta në diagnostikimin e gjendjes së faktorëve, planifikimin e punëve e burimeve; menaxhimin e veprimtarisë së përditshme dhe patjetër edhe në nivelin e sigurisë.

b) Riorganizimi i sistemit të organeve e autoriteteve përgjegjëse

Për të qenë sa më funksional e eficient, sistemi duhet të riformatohet:

- duke kaluar Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, nën vartësinë e Ministrisë së Brendshme ose të Këshillit të Ministrave; me të cilët bashkëpunon natyrshëm në veprimtarinë e përditshme;

- duke riorganizuar organizmat kolegiale për sigurinë, nga niveli qendror deri në atë vendor, (këshilla, komitete), përfshi dhe komitetet në nivelin vendor, të cilat të kenë e mbajnë përgjegjësi,

- ngritur Komitetin (agjencinë) e Sigurisë Kombëtare, për të organizuar veprimtarinë nga një qendër e unifikuar, e cila do të vlerësojë informacionin e kërcënimeve; peshojë skenarët e vendimmarrjes si dhe kapacitetet operacionale e ato të koordinimit midis agjencive, do t'i sigurojë, ekzekutivit / kryeministrit dhe autoriteteve të larta shtetërore, "pamje në kohë reale dhe të integruar për peshën e kërcënimeve dhe vendimmarrjet që duhen marrë".

c) Zhvillimi i mëtejshëm i organizatës dhe standardeve të Policisë së Shtetit

Me qëllim që të kthehet besimi e siguria tek punonjësit e Policisë, shmanget

korupsioni e pasiviteti e rriten treguesit e punës; sidomos në parandalimin e goditjen e krimit, është e nevojshme të zhvillohen më tej standardet e organizatës:

Duke përfunduar vetingun dhe duke riformatuar organizimin, e përforcuar strukturat vendore; ato të policimit në komunitet dhe luftës kundër krimit. Kjo kërkon shtim të burimeve njerëzore për luftën kundër krimit; dhënie prioritet përdorimit të inteligjencës kriminale.

Duke ndryshuar filozofinë e menaxhimit, duke shmangur ndikimin politik dhe ndërtuar raporte institucionale me organet drejtuese e mekanizmat e tjerë të sigurisë; plotësuar e mbrojtur të drejtat e punonjësve, korrigjuar sistemin e vlerësimi të punonjësve; drejtuar strukturat me logjikën e kostos dhe zhvilluar pa frikë transparencën me opinionin publik.

d) *Dhënia prioritet, politikave të parandalimit social*

Në zbatim të filozofisë së bashkëqeverisjes e gjithë përfshirjes, të përshtaten e thjeshtohen programet (strategjitë) dhe zhvillohen politikat qeverisëse në fushën e sigurisë, duke i'u përgjigjur veçorive dhe nevojave që ka mjedisi; vendosur si prioritet rritjen e shërbimeve parandaluse dhe jetësimin e policimit në komunitet; në vend të rritjes së shifrave të ndëshkimeve administrative e penale.

Alternativat e mësipërme, duhen materializuar në akte të reja ligjore për: a) organet dhe autoritetet e sigurisë publike, i cili do të plotësojë boshllëkun që ekziston në këtë drejtim nga niveli qendror e deri tek ai vendor, unifikojë sistemin dhe bëjë atë të përgjegjshëm e kontrollueshëm, b) Agjencinë e Sigurisë kombëtare, e cila nuk ekziston aktualisht; c) ndryshime e plotësime, do të duhet të bëhen edhe në disa ligje ekzistuese, siç është ai për vetëqeverisjen vendore, prefektin, Policinë e Shtetit, Policinë Bashkiake e policitë e agjencitë e tjera ligjzbatuese, administratën shtetërore dhe ligjet e tjera që do të ndikohen nga ndryshimet, si për mbrojtjen civile, armët, lëndët e substancat e tjera të rrezikshme, ligjin penal, biznesin etj.

Bibliografia

1. Kushtetuta e RSH e ndryshuar,
2. Kodi penal i RSh i ndryshuar, (kreu VIII, sek.3)
3. Kushtetuta e RSh e ndryshuar, (pjesa III, IV, V, VI)
4. Ligji nr. 139/2015 për organet e Vetëqeverisjes vendore
5. Ligji nr. 900 date 30.1.2000 për organizimin dhe funksionimin e këshillit të ministrave,
6. Ligji nr. 90/ 2012 për organizimin e funksionimin e administratës shtetërore,
7. Ligji nr. 107/ 2016 për Prefekturat i ndryshuar,
8. Ligji nr. 155/2014 për Avokatin e popullit,
9. Ligji nr. 154/2014 për Kontrollin e larte të shtetit,
10. Ligji nr. 108/ 2014 për Policinë e shtetit i ndryshuar,
11. Ligji nr. 8835/ 23.04.1998 për Policinë Bashkiake i ndryshuar,
12. Ligji nr. 80/2020 për Policinë e burgjeve,
13. Ligji nr. 13/2015 për Policinë ushtarake,
14. Ligji nr. 152/2015 për Shërbimin e mbrojtjes dhe shpëtimit nga zjarri,
15. Ligji nr. 9357/2005 për Shërbimin Informativ shtetëror, i ndryshuar;
16. Ligji nr. nr. 45/ 2019 për Mbrojtjen civile,
17. Ligji nr. 10433 date 16.6.2011 për Inspektoratin e përgjithshëm e ligjet për inspektoratet e veçanta,
18. Ligji nr. 25/2022 për Policinë gjyqësore,
19. Ligji nr. 75/2014 për Shërbimin e sigurisë fizike, i ndryshuar,
20. Ligji nr. 76/2016 për disa shtesa e ndryshime ne Kushtetutën e RSH;
21. Ligji nr. 98/2016 për organizimin e pushtetit gjyqësor,
22. Ligji nr. 115/2016 për organet e qeverisjes te sistemit te drejtesise;
23. Ligji nr. 97/2016 për organizimin e funksionimin e prokurorisë në RSH;
24. Ligji nr. 95/2016 për organizimin e funksionimin e institucioneve k/korupsionit e krimit te organizuar;

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

- 25. Ligji nr. 108/ 2014 për Policinë e shtetit i ndryshua,
- 26. Ligji për nr. 139/2015 për organet e Vetëqeverisjes vendore,
- 27. Ligji nr. 107/ 2016 për prefekturat i ndryshuar,
- 28. Ligji nr. 45/ 2019 për Mbrojtjen civile,

Programe dhe strategji:

- 29. VKM nr. 1139, datë 24.12.2020 për Rendin Publik dhe sigurinë në komunitet,
- 30. VKM nr. 691, datë 29.7.2015 për Decentralizimin dhe vetëqeverisjen vendore;
- 31. Ligji nr. 103/2014 për Sigurinë kombëtare,
- 32. VKM nr. 1139, datë 24.12.2020 për Rendin Publik dhe sigurinë në komunitet,
- 33. VKM nr. 50 datë 6.2.2019 për Kontrollin e Armëve,
- 34. VKM nr. 33 datë 22.1.2020 për Kontrollin e armeve të dëmtimit në masë,
- 35. VKM nr. 1117 datë 16.12.2020 për Menaxhimin e integruar të kufirit,
- 36. VKM nr. 125, datë 23.2.2011 për Sigurinë Rrugore,
- 37. VKM nr. 541 datë 19.9.2018 për Mbrojtjen e fëmijëve,
- 38. VKM nr. 1140 datë 24.12.2020, Luftën k/krimit të organizuar, terrorizmit e trafikeve të paligjshme,
- 39. VKM nr. 930, datë 18.11.2015 kundër Ekstremizimit të Dhunshëm,
- 40. VKM nr. 313, datë 31.5.2018 kundër Kultivimit të Trafikimit të Kanabisit,
- 41. VKM nr. 400 datë 19.6.2019 kundër Migracionit,
- 42. VKM nr. 1084 datë 24.12.2020. për Sigurinë kibernetike,
- 43. Strategji për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë natyrore.



AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

Kërcënimi nuklear, si katastrofë mjedisore



■ **Dr. Albert HITOALIAJ**
Qendra Kërkimore Shkencore
Akademia e Sigurisë
albert.hitoaliaj@asp.gov.al

Abstrakt

Kërcënimi nuklear ka dalë përsëri si skenar i mundshëm në botën e sotme. Lufta e Ukrainës është shkaku që përdorimi i armëve nukleare të hyjë në rendin e ditës së diskutimeve të fushës së sigurisë botërore. Duke u mbështetur në këtë realitet të ri kërcënues, ky material synon që të sjellë disa koncepte themelore të cilat lidhen me kërcënimin nuklear si katastrofë mjedisore. Përdorimi i armëve nukleare sjell një dëmtim të madh për jetën e planetit tonë, të ndarë në dy faza. Dëmi i fazës së parë do të ishte dëmi që do të sillnin armët nukleare në momentin e përdorimit. Dëmi i fazës së dytë, është ai i periudhës pas konfliktit nuklear. Në fazën e dytë do të kishte shkatërrim të mjedisit tokësor dhe planeti do të përballej me të ashtuquajturin “dimër nuklear”, me shkatërrimin e bimësisë, të ujërave etj., duke e përballur njerëzimin me katastrofën mjedisore më të tmerrshme. Përlogaritja e kësaj katastrofe natyrore pasnukleare, ka dekada që i ka vënë shkencëtarët në punë. Krahas burimeve të ndryshme që trajtojnë këtë çështje, do të sillen edhe pamje e të dhëna nga një prej simulatorëve kompjuterikë më të mirë në botë që llogarisin pasojat e përdorimit të armëve nukleare. Pozicioni gjeografik i vendit tonë është në rrathët e më të afërt nis do të ndodhte një konflikt rajonal nuklear me epiqendër Ukrainën. Punimi synon të krijojë një ide më të qartë në lidhje me katastrofën më të frikshme mjedisore me të cilën mund të përballët njerëzimi dhe planeti ynë, e cila do të ndodhte për shkak të faktorit njerëzor.

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

Fjalëkyçe:

konflikt nuklear, katastrofë mjedisore, dimër nuklear, simulatori “Nukemap”.

1. Hyrje

Kohët e fundit ka dalë në mënyrë te thekshme në skenën botërore një prej kërcënimeve që mendohej se ishte harruar. Ky është kërcënimi nuklear. Rusia ka deklaruar në mënyrë të vazhdueshme se një përshkallëzim i situatës që mund të vinte si pasojë e luftës së saj me Ukrainën, do të mund të përfundonte edhe me përdorimin e armëve nukleare. Por nuk është vetëm Rusia ajo që shihet e lidhur me skenarë të tillë nuklearë në botë. Pasojat e një lufte bërthamore ka dekada që janë shtjelluar mirë nga komuniteti shkencor botëror. Përtej vdekjes dhe shkatërrimit të menjëhershëm që sjell një luftë nukleare, më tutje, do të na priste një katastrofë klimatike dhe urie.

Në dekadat e fundit, bota duket se e kishte harruar frikën nga një kërcënim i tillë global, dhe krahasuar me periudhën kulmuese të Luftës së Ftohtë, kërcënimi nuklear ngjante i tjekaluar. Falë iniciativave të ndryshme, stoku i armëve bërthamore në botë ka rënë në një rreth një të pestën¹ e sasisë që vendet nukleare zotëronin në vitin 1990². Megjithatë, edhe pse kërcënimi nuklear nuk është shuar plotësisht, ai ka qenë zakonisht ekzistues dhe i mbajtur gjallë te shtete të cilët konsiderohen se luajnë blofin (Irani apo Koreja e Veriut) dhe këto shtete e kishin të pamundur të përshkallëzonin një konflikt në nivel global.

Muajt e fundit ka ndodhur një ndryshim shumë rrënjësor në këtë drejtim. Janë rrizgjuar frikët e konfliktit nuklear nga qasja dhe qëndrimi bërthamor i Rusisë. Presidenti rus, Vladimir Putin, i vendosi forcat bërthamore kombëtare në gjendje gatishmërie të lartë gjatë pushtimit të Ukrainës. Në këtë mënyrë ai shënoi një pikë kthese, një ndryshim drejtimi që rrezikon një kthim në kohën kur gjatë Luftës së Ftohtë, superfuqitë bërthamore botërore ndodheshin në prag të konfliktit.

Ngjan se konflikti i Ukrainës po shkon drejt zbehjes, por askush nuk mund të thotë

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

se sa pranë përshkallëzimit drejt një konflikti nuklear mund të gjendemi. Nëse marrim si të mirëqenë një skenar të largët ku konflikti në Ukrainë mund të përshkallëzohet në përdorim armësh bërthamore, atëherë pasojat do të ishin të tmerrshme. Këto pasoja nuk janë të jashtëzakonshme vetëm për shkak të numrit të madh dhe të tmerrshëm të vdekjeve, por më së shumti për efektet e tejzgjatura që do të sillnin me vete, në periudhën kohore pasuese. Edhe një konflikt i kufizuar bërthamor në Ukrainë apo diku tjetër në glob, i cili sheh do të shihte të përdorur vetëm një për qind të stokut bërthamor botëror të shkëmbyer, i ka të gjitha gjasat që të sjellë një shkatërrim klimatik të jashtëzakonshëm. Ky efekt shkatërrues do të përhapte vuajtje dhe vdekje në mbarë botën për vite e dekada të tëra.

Në Luftën e Ftohtë komuniteti shkencor është marrë me studimin e atij që quhet “dimri nuklear”, ose “dimri bërthamor”. Shkenca është përdorur edhe për qëllime propagandistike në këtë drejtim, madje ka pasur përplasje idesh të kundërta lidhur me këtë koncept.

Por as pasojat e tmerrshme të një dimri bërthamor nuk e ndaluan Putinin që të bënte kërcënime e as nuk është parë që të forcohen përpjekjet për çarmatimin bërthamor botëror. Është fakt se vitet e fundit, udhëheqësit botërorë kanë bërë të kundërtën. Si Putin, ashtu edhe ish-presidenti i SHBA-së, Donald Trump, kanë investuar në zhvillimin më modern të armëve bërthamore të vendeve të tyre; ata nxitën fundin e Traktatit të Forcave Bërthamore me Rreze të Mesme (INF), i cili ishte një nga shtyllat e rëndësishme të çarmatimit bërthamor. Ky traktat, që nga momenti kur u nënshkrua për herë të parë, më 1987, ka qenë një instrument i rëndësishëm i parandalimit të përshkallëzimit bërthamor, duke kufizuar përdorimin e pajisjeve të mesme dhe të ndërmjetme³.

Kujtesa historike duket se është zbehur disi, pasi shumë politikanë dhe brezat e sotëm, ngjan se e kanë harruar apokalipsin nuklear të Hiroshima-Nagasaki dhe kërcënimet shqetësuese nukleare të Luftës së Ftohtë.

2. “Dimri bërthamor”, katastrofa mjedisore e nivelit më të lartë për njerëzimin

Dimri bërthamor sipas studiuesit Alan Robock nuk është aspak një teori e kapërcyer apo që nuk mund të ndodhë. Ai bën pjesë te ata studiues që e shohin dimrin bërthamor si kërcënim të vërtetë.

Dimri bërthamor është termi për një teori që përshkruan efektet klimatike të luftës bërthamore. Tymi nga zjarret e shkaktuara nga armët bërthamore, veçanërisht tymi i zi, i blözës nga qytetet dhe objektet industriale, do të nxeht prej diellit, do të ngrihet në stratosferën e sipërme dhe do të përhapet globalisht, duke ekzistuar me vite të tëra në këtë gjendje. Kushtet e ftohta, të errëta dhe të thata të sipërfaqes së Tokës do të pengonin rritjen e të korrave për të paktën një sezon në rritje, duke sjellë si rezultat urinë masive në pjesën më të madhe të botës. Përveç kësaj, do të kishte një sosje masive të ozonit, duke lejuar kështu shtimin e rrezatimit me rreze ultraviolett. Kjo gjendje do të bënte, që për shkak të këtyre efekteve indirekte, të mund të vdisnin më shumë njerëz në vendet e papërfshira në luftë se sa në ato ku u hodhën bombat. Përhapja bërthamore tashmë e

¹ <https://fas.org/issues/nuclear-weapons/status-world-nuclear-forces/>

² <https://journals.sagepub.com/doi/full/10.2968/066004008>

³ Të dhëna më të gjera mbi armëkontrollin dhe Traktatin INF, mund të lexohen në: <https://www.armscontrol.org/factsheets/INFtreaty>

ka zgjeruar kërcënimin bërthamor. Një luftë bërthamore midis Indisë dhe Pakistanit do të mund të prodhonte aq shumë tym sa të krijonte ndryshime mjedisore globale të pahasura me parë në historinë e shkruar njerëzore. Edhe pse numri i armëve bërthamore në botë është ulur: nga 70 000 në kulmin e tij, në vitet 1980, në më pak se 10 000 armë të dislokuara aktualisht, një luftë bërthamore midis SHBA-së dhe Rusisë mund të prodhonte sërish dimër bërthamor. Kjo teori nuk mund të testohet në botën reale. Megjithatë, analogjitë mund të na informojnë mbi pjesë të caktuara të kësaj teorie; dhe janë të shumtë ata që e mbështesin këtë teori. Këto analogji përfshijnë ciklin stinor, ciklin ditor, pyjet, zjarret, shpërthimet vullkanike dhe stuhitë e pluhurit në planetin Mars. Mënyra e vetme për të qenë të sigurt për parandalimin e efekteve klimatike të luftës bërthamore është çlirimi i botën nga armët bërthamore.⁴

Efektet klimatike i prituri që do të vinte si pasojë e një lufte bërthamore, u studiua për herë të parë në vitin 1982, nga shkencëtari holandez Paul Crutzen, i cili merrej me studimin e atmosferës, dhe nga kolegu i tij britanik, studiuesi John Birks. Shqetësimi i tyre kryesor ishte se një shkëmbim goditjesh bërthamore mes shteteve mund të prodhonte shumë zjarre, me tym aq të trashë, sa që ai do të prodhonte një shtresë që do të mbushte atmosferën e që do të pakësonte depërtimin e dritës së diellit. Këtë koncept ata e quajtën “muzg bërthamor”⁵.

Në më pak se një vit pas këtij studimi, një grup shkencëtarësh nga SHBA-ja [nga NASA etj.], në të cilin bënin pjesë edhe shkencëtari që merrej me studimet atmosferike, Richard Turco si dhe astronomi i njohur Carl Sagan, u përpoqën që t'i kuptonin e zbërthenin më mirë këto parashikime, duke përmes modelimit kompjuterik. Përfundimet e tyre shkonin edhe më tej. Ata sugjeruan se efektet klimatike shkatërruese që do të shkakttoheshin nga armët bërthamore të përdorura do të zgjasin akoma më gjatë se sa parashikohej në fillim. Këto efekte të tejzgjatura do të sillnin atë që ata e quajtën një *dimër bërthamor*.⁶

Kësisoj rrezet e nevojshme të diellit nuk do të mund të depërtonin nën shtresën e errët të tymit, duke mos arritur që të krijojnë temperatura të larta në tokë, dhe duke shkaktuar dimra të ashpër në çdo stinë; do të kishim një dimër të tejzgjatur kudo, një ftohje globale. Koncepti i dimrit bërthamor tronditi shumë njerëz kur u publikua për herë të parë, duke nxitur lëvizje e protesta antibërthamore, të cilat përfshinë Europën dhe SHBA-në. Por ky koncept parashikues, arriti të fusë një lloj ndarje edhe mes komunitetit shkencor botëror, pasi për disa klimatologë ai ishte thjesht një koncept i ekzagjeruar në parashikimet e tij. Këtë efekt shkencor mbi marrëdhëniet ndërkombëtare e vlerësoi me seriozitet dhe shfrytëzoi edhe NATO-ja për diplomacinë e saj shkencore.⁷

Ndërkohë, në momente të ndryshme, ka pasur mendime të cilat e konsideronin

⁴ Alan Robock, “Nuclear winter”, John Wiley & Sons, Ltd. *WIREs Clim Change*, Volume 1, May/June 2010, f. 418-427.

Versioni elektronik:

<https://climate.envsci.rutgers.edu/pdf/WiresClimateChangeNW.pdf>

⁵ Paul Crutzen, John Birks. “The Atmosphere after a Nuclear War: Twilight at Noon”, *Ambio* Vol. 11, No. 2/3, *Nuclear War: The Aftermath* (1982), f. 114-125.

Versioni elektronik:

<https://www.jstor.org/stable/4312777?refreqid=excelsior%3A8bd092083e1f02218b1e45b79988ccb7>

⁶ Richard P. Turco, Carl Sagan et. al. “Nuclear winter”, *Science*, 23 dec. 1983, Vol 222, Issue 4630, f. 1283-1292

Versioni elektronik:

<https://www.science.org/doi/epdf/10.1126/science.222.4630.1283>

⁷ Simone Turchetti. “Trading Global Catastrophes: NATO’s Science Diplomacy and Nuclear Winter”, *Journal of Contemporary History*, Vol. 56m Issue 3, April 23, 2001, f. 543-562.

<https://www.science.org/doi/epdf/10.1126/science.222.4630.1283>

konceptin parashikues për dimrin bërthamor si në propagandë të frymëzuar nga sovjetikët. Interesi sovjetik ishte që të kishte kufizim të shpërndarjes së armëve bërthamore në Europë ose në Bllokun Perëndimor, si dhe të shtoheshin lëvizjet kundër këtyre armëve; kjo gjë është e vërtetuar dhe e kuptueshme. Por, nga ana tjetër, dimri bërthamor në të vërtetë nxit bashkëpunimin shkencor përtej “Perdes së Hekurt”, pasi edhe shkencëtarët rusë konfirmuan dhe i shtjelluan në detaje parashikimet e modelimit kompjuterik të amerikanëve. Njëri, prej tyre, Vladimir Aleksandrov, u zhduk në mënyrë misterioze pak më vonë. Më 31 mars 1985, ai po merrte pjesë në aktivitetin ndërkombëtar shkencor “La Movida” në Madrid, pasi kishte ndjekur një tjetër konferencë të qyteteve antibërthamore, në Kordoba të Spanjës⁸.

Çarmatimi bërthamor që filloi në vitet 1990 bëri që koncepti i dimrit bërthamor të zbehej e të harrohej nga opinioni publik, por shkencëtarët e studimeve atmosferike dhe klimatologët e kanë vijuar punën kërkimore në modelimet kompjuterike, duke mos lënë pas dore edhe llogaritjen e kërcënimeve aktuale, që shpesh janë fuqizuar nga kërcënimet dhe teknologjitë e reja bërthamore.

3. “Dimri bërthamor”, mes kërkimit shkencor dhe dezinformimit publik

Siç u përmend më sipër ka pasur një luftë të ethshme informacioni në periudhën e Luftës së Ftohtë, lidhur me konceptin e dimrit nuklear. Sovjetikët ishin të interesuar që të kishte frenime të mundshme të projekteve që lidheshin me armatimin bërthamor. Në raste të caktuara ata mund të kenë shtyrë zgjerimin e efekteve frikësuese në shoqëritë Perëndimore, me qëllim që ato të ushtronin presion frenues mbi shtetet e tyre. Një prej botimeve më të gjera që ka lidhje me këto prapaskena të mëdha të informacioni lidhur me dimrin nuklear dhe lojën sovjetike e amerikane të inteligjencës është “Comrade J” (Earley 2008)⁹.

Njësia e Aleancës Strategjike të Kundërinteligjencës të FBI-së, në një raport¹⁰ të hapur, të publikuar, merr në analizë pikërisht këtë lloj lufte informacioni që shtyhej nga qëllime propaganduese. Raporti i FBI-së citon deklaratat e një ish-punonjësi të inteligjencës ruse (KGB/SVR) që merrej me sabotimin, Sergei Tretjakov. Aktivitetin e tij e analizon edhe Earley në librin e sipërcituar. Edhe pse pa argumentuar bindshëm, Tretjakov deklaronte se teoria e dimrit bërthamor ishte fabrikuar nga KGB-ja me qëllim që të frenonte shpërhapjen e raketave balistike “Pershing” në Europë¹¹. Pavarësisht natyrës së pabesueshme që ka ky pohim, edhe raporti i FBI-së e citon si detaj¹².

Sipas këtij burimi (Sergei Tretyakov), KGB-ja urdhëroi Akademinë Sovjetike të Shkencave që të lëshonte një raport i cili të mund të frikësonte shoqëritë evropiane dhe ta ndalonte e pengonte NATO-n që të vendoste raketat e veta balistike “Pershing” në

⁸ Manuel Ansedo, Maria R. Sahuquillo, “The Soviet scientist who disappeared in 1980s Madrid”, *El Pais*, Jan 17, 2019.

Versioni elektronik:

https://english.elpais.com/elpais/2019/01/14/inenglish/1547469011_790445.html

⁹ Pete Earley, *Comrade J*, Putnam Adult, 2008.

¹⁰ The Counterintelligence Strategic Partnership Unit of the FBI. *Higher Education and National Security: The Targeting of Sensitive, Proprietary, and Classified Information on Campuses of Higher Education* (April 2011).

Versioni elektronik:

<http://www.fbi.gov/about-us/investigate/counterintelligence/higher-education-national-security>

¹¹ Earley, *Comrade J*, 2008, f. 169-177.

¹² The Counterintelligence Strategic Partnership Unit of the FBI. *Higher Education and National Security*, 2011, f. 6.

Europën Perëndimore: “Historia e cila u miratua nga propagandistët e KGB-së, përshkruante eksperimentet në shkretëtirën Karakum, në Azinë Jugqendrore, të cilat ishin kryer nga shkencëtarët sovjetikë, për fizikën atmosferike. . . shkencëtarët të tjerë sovjetikë deklarorin se kishin përdorur modelet matematikore për të vlerësuar se sa pluhur e tym mund të hidhej në atmosferë gjatë një sulmi nuklear në Gjermani”¹³.

Por, si në rastin e librit “Comrade J” edhe në rastin e raportit të FBI-së, kemi pasaktësi. Teoria e dimrit nuklear nuk është sajese. Historia e informimit dhe dezinformimit lidhur me këtë teori është e komplikuar. Këto përplasje vijnë edhe aktualisht prej dekadash por duke u zhvendosur të diskutimet lidhur me ngrohjen globale dhe me ndryshimet klimatike aktuale, ku ka studiues të cilët i konsiderojnë si kërcënime të sajara nga grupe interesash; përballë tyre vendoset mendimi i një komunitetit shkencor botëror që analizon të dhënat e ndryshimeve dhe që mbron më vendosmëri të kundërtën.

Në mjegullnajën e dezinformimit lidhur me “zanafillën” e teorisë së dimrit nuklear, qëndron në prapaskenë një operacion të supozuar të KGB-së. Pete Earley-i në librin e tij e shtjellon edhe këtë gjë. Këtë operacion, Trejakovi thotë se e drejtonte vetë Juri Andropov, i cili asokohe ishte kreu i KGB-së. Sipas deklaratave (të pavërtetuara) të Treyakov-it, shkencëtarët Perëndimorë u ndikuan nga KGB-ja për punën e tyre dhe e gjitha kishte filluar diku në vitet 1979-1982 në institutin e agjenturës ruse. Po sipas këtyre pohimeve, KGB-ja u bazua në punën kërkimore të disa shkencëtarëve të njohur sovjetikë. Më i njohuri ishte Kiril Kondratiev, kurse të tjerët ishin fizikani Georgi Golitsin dhe matematikanët Nikita Moisejev e Vladimir Aleksandrov. Megjithatë, këto deklarim nuk mund të vërtetohen dot nga Trejakovi, përderisa krahas asaj që ai thotë ka edhe një aktivitet të vazhduar shkencor nga këta emra¹⁴. Madje në vitin 1976 (para operacionit të supozuar nga Trejakovi), shkencëtari i Akademisë Sovjetike të Shkencave, Kirill Kondratiev, në bashkëautorësi me shkencëtarin amerikan R. M. Welch, boton në “Colorado State University” një studim¹⁵.

Në versionin që ndërton Trejakovi ka pika të errëta, të cilat ai nuk i argumenton bindshëm. Debatet janë të shpërndara në komunitetin shkencor dhe nuk vërtetohet dot nëse i gjithë ky ka qenë një operacion i sofistikuar inteligjence. Nuk përjashtohet mundësia që të jenë përdorur arrijtet shkencore lidhur me efektet e një lufte bërthamore, për të trembur shoqëri e grupe të caktuara, por është thuajse e pamundur që të jenë manipuluar komunitetet shkencore anekënd Perëndimit. Pavarësisht zërave kundër teorisë së dimrit nuklear (p.sh.: Sparks¹⁶, 1985; Seitz, 1986¹⁷), mbeten të fuqishëm zërat që e mbrojnë këtë teori. Nga ana tjetër, është e paqartë se deri në ç’nivel, ish-agjentët të tillë të KGB-së, si Trejakovi, mund të kryenin veprimtarinë e tyre dezinformuese; ai si dhe shumë të tjerë, edhe pse kanë dhënë informacione për Perëndimin mund të kenë vijuar misionin e tyre, por këtë herë nën petkun e të penduarit, duke synuar përçarjen

¹³ Earley, *Comrade J*, 2008, f. 170-171.

¹⁴ Alexandrov and Moisejev, “Model ‘Klimata i global’ naya ekologiya”, *Nature*, 9, 1981 (an exposition of climate model and global ecology).

Alexandrov, Moisejev, et. al., *Global models, the biospheric approach* (1981)

Alexandrov and Stenchikov, *On the modelling of the climatic consequences of the nuclear war* (1983)

Moisejev, Alexandrov, et. al., *Global models, the biospheric approach: Theory of the Noosphere* (1983)

Alexandrov and Stenchikov, *Numerical modeling of climatic consequences of nuclear war* (1984)

Golitsyn, *Consequences of Nuclear War for the Atmosphere* (1985)

¹⁵ Kirill Kondratyev, R. M. Welch, O. B. Vasiliev, V. F. Zhalev, L. S. Ivlev dhe V.F. Radionov. “Comparison between the measured and calculated spectral characteristics of shortwave radiation in the free atmosphere over the desert”, *Atmospheric Science Paper No.261*, Colorado State University, Fort Collins, 1976.

¹⁶ Brad Sparks. “The Scandal of Nuclear Winter”, *National Review*, November 15, 1985.

¹⁷ Russell Seitz “The Melting of “Nuclear Winter”, *Wall Street Journal*, December 12, 1986.

dhe diskreditimin e shkencës Perëndimore.

Në vitet 1980, diskutimet e debatet lidhur me mundësinë e një “dimri nuklear” ndihmuan që të përfundonte gara e armatimit mes SHBA-së dhe Bashkimit Sovjetik. Ish-presidenti sovjetik i kohës, Mikhail Gorbaçev, do të deklaronte publikisht në një intervistë të vitit 2000: “Modelimet e bëra nga shkencëtarët rusë dhe nga ata amerikanë, treguan se një luftë nukleare, do të përfundonte me një dimër nuklear që do të ishte skajshmërisht shkatërrues për çdo formë jete në tokë; mësimi i kësaj ishte një shtysë e madhe për ne, njerëzit e moralit e të nderit, që të vepronim”¹⁸.

4. Përlllogaritja kompjuterike e një lufte bërthamore nga “Programi i Universitetit të Princeton-it për Shkencën dhe Sigurinë Globale” (SGS)¹⁹

Turco dhe dy autorët e studimit të hershëm të “dimrit bërthamor”, Alan Robock dhe Owen Toon, vazhduan në vite të hulumtonin në mënyrë aktive pasojat e mundshme globale të konflikteve lokale të luftuara me armë bërthamore. Ata u fokusuan veçanërisht në rastin e Indisë dhe Pakistanit, duke arritur në përfundimin se edhe një shkëmbim i kufizuar bërthamor në të cilin u do të shpërthenin 50 bomba bërthamore të madhësisë së Hiroshimës do të kishte pasoja globale. Duke përdorur shpërthimet vullkanike si një tregues për të kuptuar se si tymi do të përhapej në të gjithë globin, ata e përmirësuan më tej atë parashikim të hershëm për shkëmbimin e kufizuar të goditjeve bërthamore. Përfundimet që kanë arritur së fundi janë shqetësuese: në veçanti, ata parashikojnë që zvogëlimi i dritës së diellit për një periudhë të konsiderueshme kohore do të ndikonte në prodhimin bujqësor dhe do të zvogëlonte ndjeshëm aftësinë tonë për t’i mbijetuar një lufte bërthamore. “Edhe më shumë njerëz mund të vdisnin jashtë zonave të goditura për shkak të urisë”, – parashikon Robock²⁰.

Ata nuk janë të vetmit shkencëtarë që sjellin para shoqërive detajet shqetësuese të një lufte bërthamore. Një parashikimi i detajuar i quajtur “Plani A” është bërë nga “Programi i Universitetit të Princeton-it për Shkencën dhe Sigurinë Globale” (SGS).

4.1 Programi i Universitetit të Princeton-it për Shkencën dhe Sigurinë Globale²¹

Programi i Universitetit të Princeton-it për Shkencën dhe Sigurinë Globale (SGS), në Shkollën e Marrëdhënieve Publike dhe Ndërkombëtare, kryen kërkime shkencore, teknike dhe mbi politikat; analiza për të çuar para politikat kombëtare dhe ndërkombëtare për një botë më të sigurt dhe më paqësore. Programi u themelua në vitin 1974 nga fizikanët e Shkollën e Inxhinierisë dhe Shkencave të Aplikuara të Princeton si pjesë e Qendrës për Studime të Energjisë dhe Mjedisit dhe u zhvendos në Shkollën e Marrëdhënieve Publike dhe Ndërkombëtare të Princetonit në 2001. Harold Feiveson dhe Frank von Hippel themeluan dhe bashkëdrejtuan Programi nga viti 1974 deri në

¹⁸ Mikhail Gorbachev. “Interview with Gorbachev”, *Salon* (9.7.2000).

Versioni elektronik:

<http://dir.salon.com/news/feature/2000/09/07/gorbachev/>

¹⁹ <https://sgs.princeton.edu/the-lab/plan-a>

²⁰ Alan Robock, Owen B. Toon. “Local nuklear war”, *Scientific American*, 2009, f. 74-81.

<http://climate.envsci.rutgers.edu/pdf/RobockToonSciAmJan2010.pdf>

²¹ Princeton University’s Program on Science and Global Security (SGS), School of Public and International Affairs, Princeton University.

<https://sgs.princeton.edu/about>

vitin 2006. Nga viti 2006 deri në vitin 2016, programi u drejtua nga Christopher Chyba. Që nga viti 2016, SGS drejtohet nga Aleksander Glaser dhe Zia Mian.

SGS-ja zhvilloi një simulim për një luftë të mundshme aktuale, përshkallëzuese, midis SHBA-së dhe Rusisë duke përdorur pozicionet e vërteta të forcave bërthamore, objektivat dhe vlerësimet e vdekshmërisë dhe lëndimeve që do të shkaktoheshin nga një luftë e tillë. Vlerësohet se do të kishte më shumë se 90 milionë njerëz të vdekur dhe të plagosur brenda orëve të para të konfliktit. Ky projekt u motivua nga nevoja për të nxjerrë në pah pasojat potencialisht katastrofike që mund të shkaktoheshin, sipas planeve aktuale të luftës bërthamore që ka sot, SHBA-ja dhe Rusia. Rreziku i luftës bërthamore është rritur në mënyrë dramatike në dy vitet e fundit pasi SHBA-ja dhe Rusia kanë braktisur traktatet e vjetra të kontrollit të armëve bërthamore, kanë filluar të zhvillojnë lloje të reja të armëve bërthamore dhe kanë zgjeruar rrethanat në të cilat ato mund të përdorin armë bërthamore.

4.2 "Plani A"

Plani A është një pjesë audio-vizuale modeluar me kompjuter, e cila bazohet te vlerësimet e pavarura të pozicionimeve aktuale të forcave amerikane dhe ruse, te planet e luftës bërthamore dhe te objektivat e armëve bërthamore [shih foto shoqëruese në fund të artikullit]. Kjo përlllogaritje përdor grupe të gjera të dhënash të armëve bërthamore të dislokuara aktualisht, fuqinë e armëve dhe objektivat e mundshme për armë të veçanta, si dhe planin që do të ndiqte beteja, i cili do të vlerësonte se cilat armë shkojnë në cilat objektiva, në cilin hap e në cilën fazë të luftës, për të treguar evolucionin e konfliktit bërthamor nga fazat taktike, strategjike e deri në fazën e shënjimtit të qyteteve.

Vdekjet dhe viktimat e menjëhershme që rezultojnë se do të ndodhnin në secilën fazë të konfliktit përcaktohen duke përdorur të dhënat nga simulatori kompjuterik i quajtur NUKEMAP. Të gjitha vlerësimet e katastrofës kufizohen te vdekjet akute nga shpërthimet bërthamore dhe do të rriteshin ndjeshëm nga vdekjet që ndodhin nga pasojat bërthamore dhe efektet e tjera afatgjata. Ky simulim u ndërtua dhe u zhvillua nga ekipi i këtyre studiuesve: Alex Wellerstein, Tamara Patton, Moritz Kütt dhe Alex Glaser nën ndihmën e Bruce Blair, Sharon Eëiner dhe Zia Mian. Këta janë emra të njohur për kërkime shkencore të shumta, që kanë lidhje me luftën nukleare etj.

- *Goditjet nukleare paralajmëruese.*

Simulimi fillon të zhvillohet në kontekstin e një konflikti konvencional. Me synimin për të ndaluar një avancim të SHBA-së dhe NATO-s, Rusia lëshon një goditje bërthamore paralajmëruese, nga një bazë e saj pranë qytetit Kaliningrad. NATO-ja kundërpërgjigjet me një sulm të vetëm taktik bërthamor.

- *Plani taktik.*

Meqë pragu nuklear është kapërcyer, luftimi përshkallëzohet në një luftë taktike nukleare në Europë. Rusia dërgon 300 mbushje bërthamore me avionë dhe raketa me rreze të shkurtër për të goditur bazat e NATO-s dhe trupat që përparojnë. NATO përgjigjet me një fuqi të përafërt prej 180 mbushjesh bërthamore, me forcat ajrore.

Viktimat e menjëhershme janë **2.6 milionë individë për tre orë luftë.**

- *Plani i kundërforsës.*

Me Europën e shkatërruar, NATO-ja lëshon një sulm strategjik bërthamor me 600 mbushje bërthamore, nga territori i SHBA-së dhe me raketat e nëndetëseve, që synon goditjen e bazave bërthamore ruse. Para se të humbë sistemin e vet të armatimit, Rusia bën disa paralajmërime, duke u përgjigjur me raketa të lëshuara mjete raketahedhëse të

**AKADEMIA
E SIGURISË**

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

lëvizhme në terren dhe nga nëndetëset.

Viktimat e menjëhershme janë **3.4 milionë individë, për 45 minuta.**

- *Plani i kundërvlerësimit.*

Me synimin që të frenohet rikuperimi i kundërshtarit, si Rusia edhe NATO-ja, vënë në shënjestër 30 qytetet më të populluara dhe qendrat më të fuqishme ekonomike të secilës palë, duke hedhur 5 deri në 10 mbushje bërthamore mbi secilin qytet, në varësi të numrit të popullsisë.

Vdekjet e menjëhershme janë **85.3 milionë individë, për 45 minuta.**

- **91.5 milionë,**

është numri i vdekjeve të menjëhershme që përfshin **34.1 milionë vdekje dhe 57.4 milionë të plagosur**, që janë rezultat i serisë së ndryshimeve bërthamore. Vdekjet nga mbetjet radioaktive dhe efektet e tjera afatgjata do ta shtonin në mënyrë të madhe këtë numër të përlogaritur.

4.3 “Dimri bërthamor” dhe “detet e errëta”²²

Pas këtyre dëmeve do të pasonte dimri nuklear të cilin “Plani A”, e përmend kalimthi në fund. Një ndër përlogaritjet e reja të komunitetit të shkencëtarëve është edhe ai që ka të bëjë me zhvillimin e oqeaneve në periudhën e dimrit nuklear. Ndërsa debatet vazhdojnë, grupi i shkencëtarëve të Robock-ut ka publikuar rezultate që tregojnë një shumëllojshmëri të gjerë të ndikimeve nga shpërthimet bërthamore. Kjo përfshijnë edhe ekzaminimin e ndikimeve të oqeanet, gjë që është bërë për herë të parë (Nicole Lovenduski, është shkencëtarja oqeanografe e këtij ekipi që u mor me këtë). Studimet e saj kanë qenë kryesisht mbi ndryshimin e oqeaneve në një botë që ngrohet gradualisht, e jo mbi ftohjen e shpejtë në një dimër bërthamor. Lovenduski dhe kolegët e saj përdorën një modelim klimatik për të testuar skenarin e luftës SHBA-Rusi. Në një periudhë nga një deri në dy vjet pas luftës bërthamore, ftohja globale do të ndikonte në aftësinë e oqeaneve për të thithur karbonin, duke bërë që pH e tyre të rritet në ekstrem. Kjo është e kundërta me atë që po ndodh sot, pasi oqeanet thithin dioksid karboni atmosferik dhe ujërat bëhen më acide.

Lovenduski studioi gjithashtu se çfarë do të ndodhte me aragonitin, një mineral në ujën e detit për të cilin organizmat detarë kanë nevojë për të ndërtuar guaska rreth vetes së tyre. Nga dy deri në pesë vjet pas konfliktit bërthamor, oqeanet e ftohtë, të errët, do të fillonin të përmbanin më pak aragonit, duke i vënë organizmat detarë në rrezik. Dhe këto nuk do të ishin efektet e vetme të oqeanit.

Brenda pak vitesh të një lufte bërthamore, një ndryshim i brendshëm do të trondiste Oqeanin Paqësor. Në rastin e një lufte bërthamore SHBA-Rusi, qielli i errët do të bënte që erërat të ndryshonin drejtimin dhe uji të grumbullohej në Oqeanin Paqësor lindor. Thatësira dhe shirat e dendur mund të rrënonin shumë pjesë të botës për deri në shtatë vjet. Bujqësia dhe rezervat ushqimore do të shkatërroheshin, si në tokë edhe në ujëra. Sipas llogaritjeve të ekipeve të shkencëtarëve gjatë pesë viteve, prodhimi i misrit do të binte në 13%, prodhimi i grurit në 11% dhe prodhimi i sojës në 17%. Rezervat e grurit do të zhdukeshin brenda një apo dy vitesh. Shumica e vendeve nuk do të ishin në gjendje të importonin ushqim nga rajone të tjera sepse edhe ata do të përjetonin dështime të korrat. Pasojat e një lufte bërthamore do të ndikonin në furnizimet ushqimore, në

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

²² Alexandra Witze. *Nature*. 579, 2020, f. 485-487.

Versioni elektronik:


<https://www.nature.com/articles/d41586-020-00794-y>

mënyrë katastrofike. Studiuesit nuk llogaritën në mënyrë eksplicite se sa njerëz do të vdisnin nga uria, por thonë se uria që do të pasonte do të ishte më e keqe se çdo tjetër në historinë e dokumentuar të njerëzimit.

5. Përfundime

Në mbyllje të këtij artikulli të shkurtër lidhur me përfundimet shkencore të grupeve të ndryshme të shkencëtarëve në zë, mund të themi pa mëdyshje se kërcënimi më i madh mjedisor mund t'i shkaktohet planetit tonë nga njerëzimi. Në këtë rast kemi të bëjmë me një model të kundërt: ndihemi të kërcënuar nga katastrofat mjedisore e klimatike, por në fakt ekziston një katastrofë mjedisor e cila është në krye të listës dhe kjo mund të shkaktohet nga njeriu, jo nga natyra. Dëmet që do të pasonin nga një konflikt bërthamor do të ishin të jashtëzakonshme. Lidhur me këto dëme ka dekada që shkenca përpaket që të ndërjegjësoje komunitetet politike e shoqërore të vendeve të zhvilluara me qëllim që të reduktohen armët bërthamore dhe të shkohet drejt një zhvillimi të qëndrueshëm botëror, bazuar të vlerat, te emancipimi dhe te shpërndarja e drejtë e burimeve. Vlen të përgëzohet puna e palodhur e komuniteteve shkencore në gjithë botën, të cilët sot po arrijnë rezultate të mëdha duke përdorur mundësinë që jep intelijenca artificiale dhe kompjuterët në realizimin e përlogaritjeve dhe të modeleve që lidhen me natyrën, klimën dhe luftën. Mbetete për t'u parë nëse kemi arritur atë shkallë përgjegjshmëri sa të mos bëhemi asnjëherë dëshmitarë si njerëzim të një katastrofe të tillë mjedisore e cila quhet “dimër bërthamor”.

Foto: Pamje nga “Plani A”, simulimi i luftës bërthamore SHBA-Rusi



AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

Bibliografi

1. Armëkontrolli dhe *Traktati IMF*, <https://www.armscontrol.org/factsheets/INFtreaty>
2. Alan Robock, "Nuclear winter", *John Wiley & Sons, Ltd. WIREs Clim Change, Volume 1*, May/June 2010, f. 418-427.
Versioni elektronik:
<https://climate.envsci.rutgers.edu/pdf/WiresClimateChangeNW.pdf>
3. Paul Crutzen, John Birks. "The Atmosphere after a Nuclear War: Twilight at Noon", *Ambio Vol. 11, No. 2/3, Nuclear War: The Aftermath* (1982), f. 114-125.
Versioni elektronik:
<https://www.jstor.org/stable/4312777?refreqid=excelsior%3A8bd092083e1f02218b1e45b79988ccb7>
4. Richard P. Turco, Carl Sagan et. al. "Nuclear winter", *Science*, 23 dec. 1983, Vol 222, Issue 4630, f. 1283-1292
Versioni elektronik:
<https://www.science.org/doi/epdf/10.1126/science.222.4630.1283>
5. Simone Turchetti. "Trading Global Catastrophes: NATO's Science Diplomacy and Nuclear Winter", *Journal of Contemporary History*, Vol. 56m Issue 3, April 23, 2001, f. 543-562.
<https://www.science.org/doi/epdf/10.1126/science.222.4630.1283>
6. Manuel Ansedo, Maria R. Sahuquillo, "The Soviet scientist who disappeared in 1980s Madrid", *El Pais*, Jan 17, 2019.
Versioni elektronik:
https://english.elpais.com/elpais/2019/01/14/inenglish/1547469011_790445.html
7. Pete Earley. *Comrade J*, Putnam Adult, 2008.
8. The Counterintelligence Strategic Partnership Unit of the FBI. *Higher Education and National Security: The Targeting of Sensitive, Proprietary, and Classified Information on Campuses of Higher Education* (April 2011).
Versioni elektronik:
<http://www.fbi.gov/about-us/investigate/counterintelligence/higher-education-national-security>
9. Alexandrov and Moiseyev, "Model 'klimata i global' naya ekologiya", *Nature*, 9, 1981 (an exposition of climate model and global ecology).
10. Alexandrov, Moiseyev, et. al., *Global models, the biospheric approach* (1981)
11. Alexandrov and Stenichikov, *On the modelling of the climatic consequences of the nuclear war* (1983)
12. Moiseyev, Alexandrov, et. al., *Global models, the biospheric approach: Theory of the Noosphere* (1983)
13. Alexandrov and Stenichikov, *Numerical modeling of climatic consequences of nuclear war* (1984)
14. Golitsyn, *Consequences of Nuclear War for the Atmosphere* (1985)
15. Kirill Kondratyev, R. M. Welch, O. B. Vasiliev, V. F. Zhalev, L. S. Ivlev dhe V.F.Radionov. "Comparison between the measured and calculated spectral characteristics of shortwave radiation in the free atmosphere over the desert", *Atmospheric Science Paper No.261*, Colorado State University, Fort Collins, 1976.
16. Brad Sparks. "The Scandal of Nuclear Winter", *National Review*, November 15, 1985.
17. Russell Seitz "The Melting of "Nuclear Winter", *Wall Street Journal*, December 12, 1986.
18. Mikhail Gorbachev. "Interview with Gorbachev", *Salon* (9.7.2000).
Versioni elektronik:
<http://dir.salon.com/news/feature/2000/09/07/gorbachev/>
19. "Plan A", <https://sgs.princeton.edu/the-lab/plan-a>
20. Alan Robock, Owen B. Toon. "Local nuklear war", *Scientific American*, 2009, f. 74-81.
<http://climate.envsci.rutgers.edu/pdf/RobockToonSciAmJan2010.pdf>
21. Princeton University's Program on Science and Global Security (SGS), School of Public and International Affairs, Princeton University.
<https://sgs.princeton.edu/about>
22. Alexandra Witze. *Nature*. 579, 2020, f. 485-487.
Versioni elektronik:
<https://www.nature.com/articles/d41586-020-00794-y>



AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

Menaxhimi i operacioneve të emergjencave, përgjegjësia e FSK-së në Republikën e Kosovës



■ **Dr. Enver GËRGURI**
Garda Kombëtare,
Forca e Sigurisë së Kosovës
enveri_8@hotmail.com



■ **MP Albana DEMA**
Studente, Fakulteti i Sigurisë dhe
Hetimit, Akademia e Sigurisë
demaanabla@gmail.com

Abstrakt

Objektivi kryesor i këtij punimi është roli i Forcave të Sigurisë së Kosovës në menaxhimin e operacioneve emergjente. Forcat e Sigurisë së Kosovës janë të lidhura me operacionet e emergjencave. Sukseset, sfidat dhe dështimet që e kanë përcjellë FSK-në gjatë ndërmarrjes së operacioneve të emergjencave do të jenë objekt tjetër shqyrtues në këtë punim, por edhe konkluzionet e nxjerra gjithashtu do të shihen si objekt shqyrtimi. Qëllimi i këtij punimi është përgjegjësia e FSK-së në menaxhimin e operacioneve emergjente, duke përfshirë këtu mënyrën e organizimit, mjetet që ajo përdor, detyrat sipas strukturave të saj dhe nevojat e vazhdueshme për konsolidimin e mëtejshëm dhe trajnimin e vazhdueshëm. Operacionet e emergjencave të cilat janë realizuar nga FSK-ja, vlerat e këtyre operacioneve, analizimi rreth tyre, përbën një qëllim tjetër në këtë punim. Në përgjithësi, misioni i FSK-së dhe zhvillimi i kapaciteteve të saj rreth operacionit të emergjencave dhe domosdoshmërisë së krijimit të një force të vërtetë mbrojtëse për Kosovën, shihen si sfidat kryesore të Republikës së Kosovës.

Metoda e punës me të cilën kam punuar është metoda kërkimore dhe analitike, duke u mbështetur në metodologjinë bashkëkohore për punën kërkimore. Nëpërmjet anës kërkimore, analizës, krahasimit dhe vlerësimit, kam dashur të përmbush qëllimet kryesore të këtij punimi, të cilat kanë të bëjnë me vet misionin e FSK-së, që si instrument i sigurisë, ka për qëllim të mbështesë qeverinë e Republikës së Kosovës dhe t'u ndihmojë autoriteteve civile ndaj katastrofave natyrore dhe emergjencave tjera.

Fjalëkyçe:

FSK, qeveria e Republikës së Kosovës, operacionet emergjente, menaxhimi.

1. FSK në bashkëpunim me institucionet e tjera për menaxhimin e situatave emergjente dhe mënyrat e organizimit

Forca e Sigurisë së Kosovës bashkëpunon me të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës për organizimin dhe menaxhimin e situatave emergjente në bazë të një dokumenti të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës në vitin 2010. Dokumenti i tillë është Sistemi i Integruar në Menaxhimin e Emergjencave (SIME), i cili e parasheh qartë bashkëpunimin institucional në menaxhimin e emergjencave në rrafshin lokal dhe kombëtar. Sistemi i integruar i menaxhimit të emergjencave përafron ndarjen e përgjegjësisë dhe detyrave në nivelin strategjik e operacional, duke siguruar një komunikim dhe informim të ndërsjellë ndërkombëtar.

Sistemi kërkon menaxhim të standardizuar të së gjitha resurseve të cilat mundësojnë koordinim midis juridiksioneve dhe organizmave të ndryshme shtetërorë. Përmes sistemit të integruar të menaxhimit të emergjencave duhet të arrijmë të integrojmë praktikën më të mira ekzistuese dhe të qëndrueshme e sistematike në menaxhimin e operacioneve të emergjencave, si në ato vendore po ashtu edhe ndërkombëtare.¹ Koordinimi ndërinstitutional është proces i cili i mundëson të gjitha niveleve të qeverisjes dhe të gjitha disiplinave të punojnë së bashku, në mënyrë më efektive dhe më efikase në menaxhimin e incidentit.

¹ Lama, Kudusi, Menaxhimi i Emergjencave Ndërkombëtare, Ligjërata të autorizuara, Kolegji "Biznesi", Prishtinë 2013

2. Organizimi i operacioneve të emergjencave nga FSK-ja

Forca e Sigurisë së Kosovës organizimin e operacioneve emergjente e zhvillohen në bazë të rregullave të cilat janë të caktuara sipas procedurave në fuqi. Për të realizuar një operacion të tillë duhet ndjekur këta hapa:

- *Situata*: të jemi të njoftuar me situatën e cila duhet të jetë e qartë me të gjitha parametrat se ku dhe çka duhet të bëhet.

- *Misioni*: sqarohet misioni të cilën do ta ndërmarrë FSK-ja në këtë operacion të emergjencave.

- *Detyrat e FSK-së gjatë operacionit*: detyrat dhe veprimet që do të kryen FSK në operacion emergjent duhet të jenë të qarta dhe të specifikuar për çdo njësi.

- *Planifikimi dhe përgatitja*: fillimisht kihet parasysh një planifikim i mirëfilltë në thirrjen e pjesëtarëve me alarmim, më pastaj përgatitja dhe pajisja e pjesëtarëve me mjetet e nevojshme, rregullimi i materialeve përcjellëse etj.

- *Komanda dhe kontrolli*: komanda dhe kontrolli i njësisë në operacion duhet të jenë të përcaktuara me urdhër të veçantë, brenda të cilit caktohet edhe komandanti i incidentit.

- *Operacionet e kërkim-shpëtimit*: që të jenë të suksesshme operacionet e tilla, ekipi ndërhyrës duhet që të ketë planin e veprimit dhe plani alternativ, çka nënkupton ndjekjen me përpikëri të procedurave të punës dhe të sigurisë në punë; bashkëpunimi dhe koordinimi i veprimeve në mes të gjithë pjesëmarrësve në operacion duhet të jetë i shkëlqyer, duhet të disiplinë dhe motivimi i lartë gjatë dhe pas operacioneve.

- *Mirëmbajtja e përparësive*: stërvitjet dhe trajnimet e përbashkëta të njësisë të ndryshme të FSK-së, bëjnë që sukseset në operacione të jenë të larta.

- *Mbështetja logjistike*: për ta bërë misionin e suksesshëm duhet mbështetja e mirë me të gjitha llojet e pajisjeve dhe të ketë pajisje rezervë.

- *Komunikimi, bashkëpunimi dhe bashkërendimi me njësinë mbështetëse dhe autoritetet lokale*: komunikimi i njësisë në operacion duhet të jetë i vazhdueshëm me të gjitha njësitë që marrin pjesë në operacion (kur është mision jashtë vendit me njësitë përkatëse të shteteve).

3. Detyrat e FSK-së në operacionin e emergjencave

Forca e Sigurisë së Kosovë për të menaxhuar me suksese operacionet emergjente ka veçoritë specifike të vetat të cilat asnjëherë nuk bëhen të publikuara për shkak të ruajtjes së sekreteve brenda për brenda organizatës.

3.1 Trajnimet e organizuara dhe zhvilluara në FSK për menaxhimin e situatave

Me qëllim që FSK të jetë sa më e përgatitur në planin operativ për të menaxhuar me sukses operacionet emergjente, duhet që vazhdimisht të rifreskoj trupat e veta me trajnime rifreskuese qoftë në planin operativ qoftë në vendkomandë. Të gjitha trajnimet që mbahen në FSK për përballimin e situatave emergjente bëhen duke u bazuar në objektivat e ministrit të Mbrojtjes dhe direktivat e komandantit të FSK-së, dhe të gjitha kanë për qëllim ruajtjen dhe mbajtjen e gatishmërisë së FSK-së në menaxhimin e situatave si dhe kanë për qëllim verifikimin e aftësive dhe kapaciteteve operative. Të gjitha stërvitjet e zhvilluara bëhen në baza ditore, javore, mujore dhe vjetore, të planifikuara nga shtabi.

Disa nga stërvitjet që mund të përmenden janë: “Shqiponja” 1, 2, pastaj “Ujku 2”, etj.² Trajnimet bazike speciale që kanë të bëjnë me ngritjen e nivelin e njësish, janë:

- trajnimet për zjarrfikje në Komandën e KFOR-it, “Film Cyti”, Prishtinë;
 - trajnimet për ndihmë mjekësore që janë zhvilluar nga instruktor anglezë;
 - trajnimi i kërkim-shpëtimit (KSH) në mjedise urbane, male, ujëra, për logjistikë, për aksidente dhe zjarre, nga instruktorë amerikanë;
 - trajnimi i KSH në ujëra, nga instruktor holandezë;
 - trajnimi KSH në Maqedoni;
 - trajnimi në Turqi “Mbajtës i qenve kërkues”;
 - trajnimi për NOF, komunikim, kategoritë e drejtimit të automjetit: B, C, D;
 - trajnimi i gjuhës turke, angleze, në KDS, Ferizaj, etj.³
- Trajnimet që kanë ndikuar në ruajtjen e kapaciteteve operacionale të njësish, janë:
- trajnimet rifreskuese për çminim të mbajtura në KDS, Ferizaj nga KFOR-i amerikan;
 - trajnimi për ndihmë mjekësore nga instruktorët anglezë dhe ata amerikanë.

*Figura nr. 1*⁴ demonstroi një trajnim kërkim-shpëtimi në zonat urbane, ndërsa *Figura nr. 2*⁵ tregon një trajnim të realizuar kërkim-shpëtimi në ujëra. Këto pamje të japin një pasqyrë të qartë se si realizohet një trajnim nga FSK-ja.



Figura nr. 1



Figura nr. 2

Figura nr. 3, demonstroi një trajnim të realizuar në terren malor (KSH-Male) dhe *Figura nr. 4* një trajnim të realizuar nga skuadra e zjarrfikësve të FSK-së. Paraqitja e këtyre trajnimeve të lë të kuptosh më qartë mënyrën se si realizohen këto trajnime.

² Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Raporti Vjetor 2013, f. 14

³ Brigada e Mbështetjes Operacionale / Regjimenti i Mbrojtjes Civile, Dokument Prezantues, dhjetor 2013, f. 8

⁴ Po aty, f. 9.

⁵ Po aty, f. 9.

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »



Figura nr. 3⁶



Figura nr. 4⁷

Trajnimet e MKAB-së: trajnimet që kanë ndikuar në ruajtjen e kapaciteteve operacionale të njësisë janë:

- trajnimet për mirëmbajtjen e pajisjeve të detektimit të zhvilluar në Vushtri nga Ambasada Amerikane;
- trajnimi për lëndët e rrezikshme, që është zhvilluar në Bullgari;
- trajnimet rifreskuese në KDS, Ferizaj dhe të brendshme rifreskuese, në RMC.

3.2 Trajnimet jashtë vendit ⁸

Që FSK-ja të jetë e gatshme që të jetë pjesë e menaxhimit dhe ndërhyrjes në emergjencë të ndryshme si brenda, ashtu edhe jashtë vendit, ajo duhet të trajnohet. FSK-ja krahas trajnimeve profesionale dhe rifreskuese në vend, duhet që patjetër të trajnohet edhe jashtë vendit në aspektin profesional në mënyrë që të jetë e përgatitur. Duhet të kihet parasysh se trajnimet jashtë vendit do na japin mundësinë që të jemi sa më profesionalë dhe sa më të qasshëm në terrene të ndryshme.

4. Operacionet e emergjencave të realizuara dhe përvojat që janë fituar nga FSK-ja

Që të mbahen dhe të forcohen përvojat e fituara në menaxhimin e emergjencave është me rëndësi që të krijohen marrëdhënie ndërkombëtare në të gjitha fushat. Por një bashkëpunim i tillë, në fushën e emergjencave, ka rëndësi shumë të madhe sepse ato janë momente të vështira dhe kërkojnë një kujdes dhe përkushtim shumë të madh. Për këtë kërkohej që për forcat e emergjencave të Kosovës të krijohen parakushte dhe mbështetje e fuqishme, që ato të jenë të gatshme në çdo kohë dhe në çdo rast⁹.

Forca e Sigurisë së Kosovës ka realizuar operacione të ndryshme të emergjencave, duke filluar nga operacionet e thjeshta deri te ato të vështirat, si brenda Kosovës ashtu edhe jashtë saj. Gjatë të gjitha operacioneve ku FSK-ja ka marrë pjesë, është vërejtur një përkushtim dhe përpjekje serioze e pjesëtarëve të sajë në përmbushjen me sukses të detyrave.

FSK-ja është dalluar për seriozitetin me të cilën i është qasur operacionit dhe

⁶ Brigada e Mbështetjes Operacionale / Regjimenti i Mbrojtjes Civile, Dokument Prezantues, dhjetor 2013, f. 9

⁷ Po aty, f. 10

⁸ Brigada e Mbështetjes Operacionale / Regjimenti i Mbrojtjes Civile, Dokument Prezantues, dhjetor 2013, f. 20

⁹ Lama, Kudusi, Vendi dhe roli i Forcave të Emergjencave të Kosovës në procesin e menaxhimit të emergjencave ndërkombëtare, Ligjërata të autorizuara, Kolegji "Biznesi", Prishtinë 2013.

vendosmërisë për përmbushjen e detyrave të saj. Pas çdo operacioni të emergjencave, personat përgjegjës në FSK kanë bërë një përmbledhje të punës së tyre duke përshkruar me hollësi të gjithë rrjedhshmërinë e operacionit por edhe duke potencuar mangësitë dhe problemet që janë hasur në të. Nëpërmjet pjesëmarrjes në këto operacione, FSK-ja ka fituar përvoja përmes të cilave është bërë më e aftë dhe më e përgatitur për operacionet e radhës.

4.1 FSK dhe vlerat e përvojës në menaxhimin e emergjencave

FSK ka krijuar dhe mbanë përvoja dhe vlera të mira në menaxhimin e emergjencave, e gjithë kjo thuhet duke u bazuar në pjesëmarrjen e trupave të saja në shumë vende si në vend po ashtu edhe jashtë vendit. Duke u bazuar në pjesëmarrje në operacione strukturat bëhen më të profesionalizuara dhe e kuptojmë më mirë rolin dhe rëndësinë që ato bartin në këto operacione¹⁰.

Gjithashtu, përvoja e fituar i bën strukturat e FSK-së të jenë më të kujdesshme në përgatitjen dhe planifikimin e ardhshëm të operacioneve të emergjencave.

4.2 Realizimi i operacioneve të emergjencave

Realizimi i operacioneve të emergjencave zakonisht është i njëjtë në formë, por dallon nga përmbajtja sipas llojit të operacionit. Prandaj po paraqesim një operacion të kërkim-shpëtimit, i cili paraqitet në mënyrë të tillë:

planifikimi dhe përgatitja; komandimi dhe kontrolli; operacionet e KSH, siguria dhe kontrolli i trafikut dhe vendngjarjes; mbështetja logjistike; komunikimi, bashkëpunimi dhe bashkërendimi me njësinë mbështetëse dhe autoritetet lokale

4.3 Operacionet e emergjencave që ka udhëhequr FSK-ja dhe mënyrat e realizimit të tyre

FSK-ja është formuar në vitin 2009 dhe misioni i saj ka qenë menaxhimi dhe planifikimi i operacioneve të emergjencave, mirëpo me hyrjen në fuqi të ligjeve për FSK-në, më 14.12.2018, FSK-ja ka për mision ruajtjen e sovranitetit dhe të integritetit territorial të Republikës së Kosovës. Përgjegjësitë e menaxhimit të emergjencave janë bartur tek Garda Kombëtare e cila në strukturën e saj ka RMC, RXH, NJA. Gjatë kohës së FSK-së si organizatë për menaxhimin dhe planifikimin e pjesëmarrjes në operacionet emergjente janë zhvilluar operacione reale të shumta si në vend po ashtu edhe jashtë vendit, nga të cilat operacione janë marrë përvoja të shkëlqyera. Ndër operacionet të cilat mund të përmenden janë, ai i përmbytyjeve në Republikën e Shqipërisë, në vitin 2010; pjesëmarrja në operacionin e Restellicës, 2011-2012; operacioni i tërmetit, në vitin 2019; operacione të ndryshme të çminimit; inspektime të ndryshme të MKAB-së; operacione zjarrfikjeje etj.

4.4 Bashkëpunimet në operacionet e emergjencave ku FSK-ja ka qenë pjesë, ose drejtuese

Bashkëpunimet në operacionet e emergjencave ku FSK-ja ka qenë pjesë ose drejtuese e këtyre operacioneve, janë vlera të patjetërsueshme. FSK në të gjitha operacionet ku

¹⁰ Lama, Kudusi, Vendi dhe roli i Forcave të Emergjencave të Kosovës në procesin e menaxhimit të emergjencave ndërkombëtare, Ligjërata të autorizuar, Kolegji "Biznesi", Prishtinë 2013.

ka marrë pjesë deri më tani, vlerësohet mjaft lartë nga të gjithë aktorët, ngaqë ka kryer të gjitha detyrat e parapara në aktet ligjore në fuqi. Përveçse, bashkëpunimi ndërmjet të gjitha organizatave me të cilat FSK merr pjesë në operacione, për FSK është e rëndësishme bashkëpunimi sepse fiton përvoja, nxjerr rekomandime dhe mësim për të ardhmen që të bëhet një forcë e kompletuar dhe e aftë të përballojë situata edhe më të vështira që mund ti vijnë.

5. Përmbledhje dhe rekomandime

Kosova, si vend në zhvillim e sipër, ka nevojë për kapacitete më të përgatitura për të qenë në gjendje të reagojë në situatë krizash e që të mund të jenë të natyrës së ndryshme. Rrezikimi i shoqërisë shikohet në mënyrë konkrete, jo vetëm si një kërcënim i zakonshëm që lidhet me llojet e ndryshme të incidenteve të rrezikshme, por deri tek fatkeqësitë e mëdha, si përmytjet, tërmetet apo katastrofat nga shpërthimet, përfshirë këtu edhe pasojat që vijnë nga aksidentet teknologjike apo veprimet terroriste.

Me rëndësi është përpilimi dhe ndërtimi i një sistemi të integruar i menaxhimit të emergjencave. Ky sistem afion kornizë të qëndrueshme gjithëkombëtare për të mundësuar që qeveritë e të gjitha niveleve, organizatat joqeveritare dhe sektori privat, të punojnë së bashku për parandalimin, mbrojtjen, reagimin, rimëkëmbjen dhe zvogëlimin e efekteve të rreziqeve e kërcënimeve që mund të paraqesin fatkeqësi për jetën e njerëzve, pasurinë e tyre dhe mjedisin, pa marrë parasysh shkakun, madhësinë, vendndodhjen apo kompleksitetin e tyre. Kjo qëndrueshmëri ofron bazament për përdorimin e sistemit për të gjitha incidentet duke filluar nga ndodhitë e përditshme deri tek incidentet që kërkojnë reagim të koordinuar qeveritar¹¹.

Meqenëse roli i Forcave të Sigurisë së Kosovës në operacionet e emergjencave është mjaft i madh dhe përbën misionin kryesor të saj, atëherë duhet t'i kushtohet vëmendje e posaçme ngritjes dhe fuqizimit të kapaciteteve të saj si forcë mbrojtëse, dhe si forcë kryesore dhe mbështetëse në operacionet e emergjencave.

Nisur nga të gjitha këto problematika dhe vështirësi që i dalin përpara kësaj force, po paraqesim disa sugjerime dhe rekomandime, për vet FSK-në dhe institucionet relevante që merren me menaxhimin e emergjencave. Për FSK-në japim rekomandimet, si më poshtë:

- rëndësia e pajisjeve individuale dhe e përdorimit të tyre;
- organizimi i stërvitjeve fushore;
- demonstrimi real i kapaciteteve për ndihmë autoriteteve civile;
- roli i koordinatorëve në terren;
- nxjerrja e planeve të mëhershme për fatkeqësitë natyrore;
- të organizohen ushtrime të përbashkëta me institucionet e tjera të sigurisë, PK-në, institucionet e tjera përgjegjëse për emergjencë si AME, autoritetet lokale;
- t'i kushtohet rëndësi pajisjeve individuale, mungesës dhe vjetërsisë së tyre;
- të respektohen parametrat e parapara për pastërtinë nëpër baza, mjekësinë, ushqimin, etj.;
- më shumë pajisje fikse HARRIS në QB (të mos përdoret telefoni mobil); funksionimi i CIMIC në QBO, kontaktet me autoritetet civile;
- hartimi i planeve operacionale për fatkeqësitë që i kanosen Kosovës (ortekë, vërshime, tërmete, shtrëngata, erëra të forta, etj.); PSO – caktimi i rolit të koordinatorit

¹¹ Lama, Kudusi, "Mundësitë dhe mënyrat e intergimit të Forcave të Emergjencave të Kosovës në menaxhimin e emergjencave ndërkombëtare", Ligjërata të autorizuar, Kolegji "Biznesi", Prishtinë, 2013.

të incidentit;

- ngritja e nivelit në të gjitha trajnimet speciale; ngritja e strukturës së K-9; krijimi i një dhome dekompressive për zhytje; pajisja me kompresor për mbushjen e bombolave me oksigjen; plotësimi me pajisje speciale;

- zbatimi në mënyrë të plotë i ligjit mbi fatkeqësitë natyrore, dhe i dokumenteve strategjike: SIME dhe PRK;

- trajnimi i zyrtarëve përgjegjës për reagime në situata emergjente, sidomos në aspektin e koordinimit, si në nivel lokal po ashtu edhe në nivel qendror;

- rritja e buxhetit për institucionet relevante dhe njësive që merren direkt me situata emergjente;

- qartësimi i kompetencave të nivelit lokal dhe qendror;

- kompletimi i forcës ajrore, duhet të jetë prioritet i institucioneve të Kosovës, respektivisht i qeverisë së Kosovës;

- blerja e mjeteve të nevojshme dhe pajisja e trupave që janë përgjegjës për ndërhyrje në situata emergjente me këto mjete;

- rritja e rezervave ushqimore shtetërore, për raste emergjencash;

- institucionet relevante duhet të bëjnë skenarë të supozimit dhe veprimit.

Bibliografia

1. Lama, Kudusi, Menaxhimi i Prishtinë, 1 mars 2014.
2. Lama, Kudusi, Analiza dhe vlerësimi i rrezikut, Kolegji "Biznesi", Prishtinë 2013.
3. Lama, Kudusi, Menaxhimi i Emergjencave Ndërkombëtare, Ligjërata të autorizuara, Kolegji "Biznesi", Prishtinë 2013.
4. Lama, Kudusi, Vendi dhe roli i Forcave të Emergjencave të Kosovës në procesin e menaxhimit të emergjencave ndërkombëtare, Ligjërata të autorizuara, Kolegji "Biznesi", Prishtinë 2013.
5. DeRosa, John, Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes së Republikës së Kosovë, GAP – Instituti për Studime të Avancuara, Prishtinë,
6. Cana, Sami / Oficer Shtabi (MP-3-1-2) - Qendra e Shtypit e Botimeve dhe Përkthimeve Ushtarake, Tiranë 2007.
7. Forumi për Siguri, Sektori i Sigurisë në Kosovë pas Pavarësisë, Prishtinë, tetor 2010,
8. Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave, Raporti Kosovar, Botim i veçantë, KIPRED, qershor 2005.
9. Qeveria e Kosovës, Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave, Prishtinë, maj 2010.
10. Forca e Sigurisë së Kosovës/Komanda e Forcës Tokësore, "Mësimet e Mësuara nga Vërshimet dhe Ushtrimet", Prishtinë, janar 2014.
11. Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Raporti Vjetor 2013, Prishtinë dhjetor 2013.
12. Qeveria e Kosovës, Plani i Reagimit Kombëtar, Prishtinë, dhjetor 2010.
13. Kushtetuta e Republikës së Kosovës.
14. Ligji për Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës nr. 2008/03-L045.
15. Kuvendi i Kosovë, Ligji nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës.
16. Republika e Kosovës/Kuvendi, Ligji nr. 04/L-177 për Dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës Jashtë Vendit, Prishtinë 28 maj 2013.
17. Republika e Kosovës, Ligji Nr. 03/L-050 për Themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës.
18. Ligji Nr. 02/L-68 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera.
19. Ligji nr. 04/L-012 për Mbrojtjen nga Zjarri.
20. Ligji nr. 04/L-230 për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent,
21. Ligji për Kujdesin Shëndetësor Emergjent nr. 2006/02-L50,
22. Udhëzim Administrativ për metodologjinë e hartimit të vlerësimit të rrezikut dhe planeve për mbrojtje dhe shpëtim nr. 19.2008.
23. Rregullorja e Punës së Këshillit të Sigurisë së Kosovës.
24. Rregullorja për Punën e Qendrës së Situatave.
Ueb-faqe interneti:
25. www.mksf-ks.org,
26. www.mpb-ks.org,
27. www.rks-gov.net,
28. www.kuvendikosoves.org,
29. www.forumipersiguri.org.

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »



Academy of Security

Eighth International Scientific Conference

«Community Safety in the Context of Extreme Natural Phenomena and Civil Emergencies»

**AKADEMIA
E SIGURISË**

«Siguria në
komunitet në
kontekstin
e kërcënimeve
nga fenomenet
ekstreme
natyrore dhe
nevojave për
përballimin e
emergjencave
civile»

21 November, 2022
Tirana, Albania

**The VIII International Scientific Conference
"Community Safety in the Context of Extreme Natural Phenomena and Civil Emergencies"**

Leadership and safety in the community in the context of extreme natural phenomena and civil emergencies

PhD. Bajram IBRAJ

Abstract

